

Revistë edukative-kulturore

ETIKA

Shqipëri: 150 Lek
Kosovë: 1 Euro
Maqedoni: 60 Den
Europa: 2 Euro

Tetor 2010 • Numri: 31 • E përmuajshme



NATA E MYSLIMANIT

EDITORIAL

*N*oha e natës, e cila fillon me Darkën dhe mbaron me Mëngjesin, përfshin në vetvete tre kohë namazi farz. Nëse përfshijmë këtu edhe kohën e Vitrit e të Tehexhudit, atëherë rezulton se myslimani ka me të vërtetë një jetë nate të ngarkuar me adhurim.

Kur i Dërguari i Allahut donte të flinte, ai e vendoste dorën poshtë faqes dhe lutej: - *Zoti im! Me emrin tënd vdes dhe po me emrin tënd ringjalle, ndërsa kur zgjohej, thoshte: - Falënderimet i qofshin Allahut, i Cili na ringjall pas vdekjes. Ringjallja është një punë që i takon vetëm Atij.* (Buhari, Muslim)

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut na këshillon të bëjmë edhe një lutje për gjumin: Sipas një transmetimi të Ebu Umare Bera bin Azib, i Dërguari i Allahut ka thënë:

- O ti njeri! Kur të shtrihesh bëj këtë lutje:

Zoti im! Ty Të jam dorëzuar. Fytyrën drejt Teje e kam kthyer. Puna të qoftë falë. Ty të besova në punën time. Ty t'u mbështeta, duke të kërkuar pëlqimin Tënd, i frikësuar nga dënimi. Nuk kam mbështetje tjetër veç Teje. I besova librit që zbritte dhe peygamberit që dërgove.

Njeriu që bën një lutje të tillë dhe gjatë po asaj nate ndërron jetë, ai vdes si besimtar, por nëse jo, ngrihet në mëngjes si njeri me shumë mirësi. (Buhari, Muslim)

I Dërguari i Allahut na ka këshilluar të bëjmë një lutje kur të ngrihemi për tehexhud, lutje e cila ka parime edukative për gradat shpirtërore:


Falënderimet të qofshin Ty o Zot! Ti je Ai që i mban në këmbë ç'ka në qiell dhe në tokë. Falënderimi të përket vetëm Ty o Zoti im! Ti je drita e gjithçka ka në qiell dhe në tokë. Falënderimi të përket Ty o Zoti im! Ti je mbreti i gjithë ç'ka në qiell dhe në tokë. Falënderimet qofshin vetëm për Ty, pasi Ti je e Vërteta, edhe premtimi Yt është i vërtetë. Arritja tek Ti është e vërtetë, fjala Jote është e vërtetë, xheneti është i vërtetë, xhehenemi është i vërtetë, peygamberët janë të vërtetë, Muhamedi (a.s.) është i vërtetë dhe vetë ora e ditës së gjykimit është një e vërtetë. Tek Ti u dorëzova, o Zoti im! Ty të besova. Tek Ti u mbështeta dhe tek Ti u drejtova. Në mbështetjen Tënde luftova shumë ndaj mosbesimtarëve. Ty të pranova si gjykues. M'i fal gjynahet e mëparshme, ato të mëvonshmet, ato që kam bërë fshehtas dhe ato të dukshmet. S'ka Zot tjetër përveç Teje. Forcën e vërtetë e gjejmë vetëm kur mbështetemi tek Allahu.

Do të lexoni:



4

Hasan Kamil Jëllmaz /
Muzgu i mëngjesit, shkëlqimi i natës



10

William C. Cittick /
Qëllimi i arsimit Islam



19

Ahmet Tashgetiren /
Jeta e natës për një mysliman



- Hasan Kamil Jëllmaz / 4** Muzgu i mëngjesit, shkëlqimi në errësirë
- Nexhat Ibrahimimi / 8** Refleksione të shkurtra rreth perceptimit të Allahut në Islam
- William C. Cittick / 10** Qëllimi i arsimit Islam
- Mr. Zymer Ramadani / 13** Namazi i natës udhëtim shpirtëror
- Dr. Muzemmil Siddik / 16** Etika e biznesit në Islam
- Ahmet Tashgetiren / 19** Jeta e natës për një mysliman
- / 22** Këshilla të arta nga Kurani Famëlartë
- Mexhid Yvejsi / 26** Hafiz Ymer Shemsiu
- Mr. Abdulkadër Durguti / 28** Dobitë e të medituarit mbi vdekjen
- /30** Një ajet

Viti: V | Numri: 31 | Tetor 2010

Administrator i Progresi botime:
Shuaqip Bashhan
bashan43@hotmail.com
+355 69 20 76768

Drejtor & Kryeredaktor:
Alban Kali
albankali@yahoo.com
+355 69 24 23989

Përkthyesit:
Alban Kali / Elvira Puka
Elona Sytari / Evans Drishti
Fatmir Sulaj / Ilir Hoxha / Tasim Darsi
Redaktor letrar:
Shpëtim Kelmendi
Redaktor gjuhësor:
Ma. Irida Hoti

Dizajn - Grafik:
Bledar Xama
bledar_xama@hotmail.com
Për artikuj
e-mail: revistaetika@progresibotime.com
e-mail: kosova@progresibotime.com
e-mail: maqedoni@progresibotime.com

Letor 2010

32

Osman Nuri Topbash /
Hazreti Ebu Bekri (r.a.)



44

Mr. sci. Flamur Sofiu /
Furnizimi dhe mirëmbajtja



52

Sadik Dana /
Përmendja e Allahut në një të tretën e natës



/31 Një Hadith

Osman Nuri Topbash /32 Hazreti Ebu Bekri (r.a.)

Mr. sci. Flamur Sofiu /40 Furnizimi dhe mirëmbajtja sipas të drejtës së shariatit

Sadik Dana /44 Përmendja e Allahut në një të tretën e natës

/46 Parabola sufi:
Njeriu që ecte përmbi ujë
Uji i parajsës

Hutbe të zgjedhura /48 Islami mes dijes dhe praktikës

Mr. Artur Tagani /50 Astronomia në Islam

Mag. Ermal Nurja /52 Koçi Beu: Monteskieu osman me origjinë shqiptare

Familja /54 Hz. Rukija (r.a.)

Shëndeti /56 Sëmundja e sheqerit:
Tashmë do të përcaktohet
10 vjet më parë

Teknologji /58 Tashmë myslimanët kanë
"facebook"-un e tyre

PROGRESI
BOTIME
www.progresibotime.com

Adresa:

L: Vasil Shanto / Rr: Çajupi
Shkodër / Albania
Tel: +355 22 254 634
Fax: +355 22 254 633

Zyra e përfaqësimit Maqedoni

Rr. Stiv Naumov / nr. 9 / lokal 25
Shkup / Maqedoni
+389 71 956 271

Zyra e përfaqësimit Kosovë:

Rr. Ardian Zurnaxhiu / pn. Ralin
Prizren / Kosovë
Tel: +381 29 222 795
Fax: +381 29 222 797
+377 441 63 651

Çmimi:

Shqipëri: 150 Lekë

Abonim (një vjetor): 1500 Lekë
Kosovë: 1 Euro

Abonim (një vjetor): 10 Euro
Maqedoni: 60 DEN

Abonim (një vjetor): 720 DEN
Europë: 2 Euro

Abonim (një vjetor): 24 Euro



Muzgu i mëngjesit, shkëlqimi në errësirë

Hasan Kamil Jëllmaz

Muzg quhet koha pas perëndimit dhe para lindjes së diellit, koha kur errësira me dritën janë të ndërthurura me njëra-tjetrën.

Megjithëse Kurani Kerim e ka caktuar “natën” si kohë pushimi (shih. Nebe, 10), ka shumë ajete që e nxitin dhe e lavdërojnë adhurimin gjatë natës. Disa nga këto ajete janë si më poshtë:

“O ti i mbuluar (o Muhamed)! Çohu (të falesh) gjithë natën, përveç një pjese të saj, që është gjysma ose diçka më pak a diçka më shumë se ajo dhe lexoje Kurani ngadalë dhe qartë, sepse Ne do të të dërgojmë vërtet një fjalë me peshë të rëndë. Natyrisht, adhurimi natën vepron më fuqishëm dhe fjala është më shprehëse, ngaqë ti ditën je vërtet shumë i zënë. Prandaj, përmende emrin e Zotit tënd dhe përkushtoj krejtësisht Atij!” (El-Muzzemmil, 1-8)

Në këtë ajet të nderuar, përveçse e nxit të Dërguarin e Tij që ta gjallërojë natën, Allahu Teala na njofton se edhe kur lexohet natën, Kurani ndikon më shumë në zemër dhe është më i qëndrueshëm në mendje. Në një farë mënyre, kjo do të thotë se gjatë natës vëmendja është më e gjallë, zemra më e pastër dhe mendja më e ndritur. Nata është koha, kur dhikri (përmendja e Allahut) është krejtësisht i zhveshur nga gjërat boshe dhe është plotësisht i orientuar tek Allahu.

“Natyrisht, Zoti yt e di se ti (o Muhamed) falesh më pak se dy të tretat e natës, ndonjëherë gjysmën ose një

të tretën e saj, si edhe disa prej atyre që janë me ty. Allahu e përcakton gjatësinë e ditës dhe të natës dhe e di se ju nuk mund ta llogarisni atë saktësisht, prandaj kthehet tek ju me mëshirë...” (El-Muzzemmil, 20)

Në këtë ajet janë lavdëruar dhe barazuar me punët e Profetit (a.s.), punët e atyre që i gjallërojnë netët e tyre. Gjithashtu është theksuar se ngritja gjatë natës për adhurim është një cilësi hyjnore dhe profetike.

“Shpalljet Tona i besojnë vetëm ata të cilët, kur u përmenden, bien në sexhde, dhe të cilët e madhërojnë Zotin e tyre, e lavdërojnë dhe nuk bëhen mendjemëdhenj. Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë...” (Es-Sexhde, 15-16)

Përmbajtja e këtyre ajeteve është edhe më interesante, sepse ata që ngrihen natën për hir të Allahut, nuk duhet të bëhen asnjëherë mendjemëdhenj dhe duhet të ruajnë ekuilibrin midis frikës dhe shpresës.

“A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij (me jobsimtarin)?!...” (Ez-Zumer, 9)

Nga ky ajet kuptohet qartë se ai që ngrihet natën dhe adhuron Allahun nuk mund të jetë i njëjtë me atë që fle gjithë natën.

“...Ata që e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë.” (El-Furkan, 64)

Rruga për të arritur mëshirën e Rrahmanit qëndron në kapjen e momentit kur Ai do të jetë më afër, duke iu lutur Atij gjatë natës në këmbë dhe në sexhde.

“Kaloje një pjesë të natës, si falje shtesë për ty (Muhamed)! Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë në një vend të lavdëruar.” (El-Isra, 79). Sipas këtij ajeti, për Profetin (a.s.) namazi i natës ishte i njëjtë me namazet e detyrueshëm, ndërsa për umetin e tij është të paktën “sunneti muekkede” (sunet i fortë).

“(Ata) që thonë: ‘Zoti ynë! Me të vërtetë kemi besuar, andaj na i fal gjynahet tona dhe na ruaj nga dënimi i zjarrit!’; që janë të durueshëm, të singjertë, të devotshëm në adhurimin e Allahut; që japin lëmoshë dhe që kërkojnë faljen e gjynaheve para agimit.” (Ali Imran, 16-17)


Një nga mënyrat më të mira për t’u ruajtur nga dënimi i xhehenemit, është istigfari (kërkimi i faljes) në kohën e muzgut të mëngjesit.

“Pa dyshim, ata që i frikësohen Allahut do të jenë në kopshte dhe burime, duke marrë atë që ua ka dhuruar Zoti i tyre, meqë më parë kanë qenë punëmbarë. Ata flinin pak natën, ndërsa në agim kërkonin falje (nga Allahu). Në pasuritë e tyre ka pasur pjesë për lypësit dhe nevojtaret.” (Edh-Dharijat, 15-19)

Në këtë ajet theksohet përsëri se për të arritur xheneitin duhet të flesh pak dhe t’i japësh nga pasuria jote atij që kërkon dhe atij që nuk kërkon dot.

Në komentimin e ajetit **“Kërkoni ndihmën e Allahut me durim e me namaz!...”** (El-Bekare, 45), shpjegohet se me fjalën “namaz” nënkuptohet namazi i natës. Pra, Allahu Teala na urdhëron, që në luftë me nefsin (egon), të kërkojmë ndihmë me durim dhe namaz, sepse namazi i natës është një adhurim i vështirë, të cilin mund ta kryejnë vetëm njerëzit modestë, pra ata që e ndjejnë në shpirt Allahun e Madhëruar. Për arsye të vështirësisë që ka ky namaz, ata që e praktikojnë duhet të kenë shumë kujdes në ruajtjen e ekuilibrit midis frikës dhe shpresës.

Përveçse na tërheq vëmendjen në begatinë shpirtërore të natës, Allahu Teala fton Profetin (a.s.), në emër të tij fton popullin, pastaj në mënyrë të përgjithshme të gjithë Myslimanët, që t’i gjallërojnë netët e tyre, ndërsa në muzgun e mëngjesit të merren me istigfar (kërkim



faljeje). Duke iu bindur këtij urdhri, Profeti ynë (a.s.) ngrihej në namazin e natës dhe qëndronte në kijam (qëndrimi në këmbë gjatë namazit) derisa i ënjteshin këmbët. Kur u pyet “Përse e lodhë kaq shumë veten kur ti je një profet që të janë falur gabimet e shkuara dhe të ardhme?”, ai u përgjigj: **“A të mos jem falënderues?”** (Buhari, Tefsiru sure(48), 2; Muslim, Munafikin, 81; Buhari, Tehexhjud, 6, Rikak, 20; Tirmidhi, Salat, 187)

Gjallërimi i natës me adhurim është një vepër që shpreh në mënyrë të qartë falënderim. Përveç këtij hadithi, ka edhe shumë hadithe të tjera që e lavdërojnë Profetin (a.s.) për adhurimin e natës dhe që e këshillojnë atë të merret me istigfar gjatë kohës së muzgut të mëngjesit. Këto janë disa prej tyre:

“Gjatë natës është një kohë të cilën nëse Myslimani e arrin (duke bërë adhurim) dhe duke iu lutur Allahut, Ai do t’i japë atë që dëshiron.” (Buhari, Talak, 24; Muslim, Musafirin, 166)

“Dy rekate namaz që i fal njeriu në mes të natës janë më të vlefshme se e gjithë bota me gjithë ç’ka në të. Nëse nuk



do të frikësohesha se do t'i vinte rëndë popullit tim, këto dy rekate namaz do t'i bëja farz (të obligueshme)." (Buharî, Tehexhahud, 10)

"Vazhdojeni namazin e natës, sepse ai është suneti i të devotshmëve para jush. Adhurimi i natës është afrim tek Allahu dhe shpagim për gjynahet. Njeriu e ruan trupin nga sëmundjet dhe e largon nga gjynahet." (Tirmidhi, Deavat, 101; Ibën Hanbel, VI, 126)

"Një njeri, i cili e ka zakon të ngrihet në namazin e natës, kur nuk arrin të zgjohet, fiton sevap sikur e ka falur namazin e natës dhe gjumi i tij është sadaka." (Ebu Davud, Tatavvu', 30)

"Pas namazeve farz, namazi më i vlefshëm është namazi i natës." (Muslim, sijam, 203)

Ndërsa në disa hadithe të tjera, i Dërguari i Allahut kërkon falje dhe i quan prej dhakirinëve (ata që përmendin shumë Allahun) ata bashkëshortë që ngrihen në namazin e natës dhe ngrenë edhe bashkshortet e tyre. (Shih. Ebu Davud Tatavvu', 18 ve Nesai Kijamu'l lejl, 5, 17)

Në një hadith tjetër të transmetuar nga Muslimi thuhet se, ai që nuk arrin të ngrihet natën për të kryer adhurimin, nëse e kryen atë në kohën midis mëngjesit dhe të drekës, do të shpërblehet sikur ta ketë kryer gjatë natës.

Nata është konsideruar gjithmonë si një thesar për shkak se thellësia dhe ndjesia e saj mistike e mbështjell njeriun si një jorgan dhe vë në lëvizje botën e shpirtit e të ndjenjave njerëzore. Prandaj dhe dijetarët e tasavvufit i kanë dhënë një rëndësi të veçantë çështjes së natës. Autori i veprës klasike të tasavvufit "Kutu'l-Kulub", Ebu Talib Mekki, në veprën e tij, për çështjen e natës ka folur në kapitujt 12-14. Në veprën e tij "Ihja ulumi'd-Din", Gazzaliu ka folur në lidhje me natën në kapitullin e fundit të vëllimit të parë, ndërsa Suhreverdi, në veprën e tij "Avarifu'l-Maarif" e ka trajtuar çështjen e natës në kapitujt 45-48.

Me qëllim që trupi i njeriut të prehet, në përgjithësi këshillohet që një e treta e 24 orëve të ditës të kalohet në gjumë dhe pushim. Është e përshtatshme që nga këto tetë orë, gjashtë orë të përdoren natën dhe dy orë ditën. Mirëpo, në varësi të gjatësisë së netëve mund të bëhen edhe ndryshime. Në botëkuptimin e tasavvufit, në sajë të vullnetit të fortë, njeriu duhet t'i pakësojë edhe më shumë orët e gjumit.

Sipas një pjese të sufive, nëse flihet më pak se tetë orë gjumë, truri dëmtohet e kështu vështirësohen funksionet trupore, por nëse vendin e gjumit e zë ndjenja e dashurisë për Allahun, pagjumësia nuk sjell dëm. Netët e gjata duken të shkurtra për ata që në zemrat e tyre kanë gëzim hyjnor dhe shpirtëror. Poeti thotë:

*Një vit i kaluar me Mikun, duket si një sekondë
Një sekondë që kalon pa të, duket si një vit.*

Një dijetar tasavvufi thotë: "Allahu Teala shikon në zemrën e atyre që janë të zgjuar në muzgun e mëngjesit dhe i mbush me dritë. Këto zemra ndriçohen dhe bëhen burim urtësie. Më pas, kjo dritë dhe urtësi përhapet në zemrat e gafilëve (njerëzve të pakujdesshëm)."

Për shkak të adhurimit të natës dhe vlerës që i jepnin urisë, Sufitë e Shamit quheshin "ehlu'l-leyl ue'l-xhuijje" (njerëzit e natës dhe urisë). Një nga të parët e kësaj shkolle, Ebu Sulejman Darani thotë: "**Kënaqësia që ndjejnë ata që e kalojnë natën me adhurim është më e**

madhe se kënaqësia që ndjejnë njerëzit që luajnë dhe argëtohen.

Një sufi ka thënë: “Shpërblimi i atyre që i luten Allahut dhe i përgjërohen kokëulur natën, është si shpërblimi i njerëzve të xhenetit, sepse ëmbëlsia e lutjeve të atyre që bëjnë adhurim natën është një shpërblim që jepet menjëherë.”

Sipas një transmetimi, Allahu Teala, i ka shpallur dhe i ka treguar njërit prej profetëve të mëparshëm cilësitë e robërve që Ai do më shumë: “...Ata e dëshirojnë ardhjen e natës ashtu siç e dëshiron zogu kthimin në folenë e vet. Kur çdo i dashuruar ngelet vetëm për vetëm me të dashuruarin në errësirën e natës, ata i ulin fytyrat e tyre në tokë për të më adhuruar Mua. Duke mu përgjëruar kujtojnë mirësitë e Mia. E gjallërojnë natën duke u lutur dhe duke qarë. Ndërsa Unë ju jap tre mirësi:

1- Ndriçoj zemrat e tyre. Në sajë të kësaj drite ata më njohin Mua ashtu siç jua kam treguar Unë veten time.

2- E quaj të pakët edhe sikur në peshoren e tyre të vihen shtatë qiejt dhe toka.

3- I drejtohem atyre me Dhatin (veten) Time. E kush mund ta dijë se ç'mund t'i jap mikut Tim kur i drejtohem me Dhatin Tim?


Drita hyjnore që fiton besimtari kur i përgjërohet Allahut gjatë natës, përhapet gjatë gjithë orëve të ditës. Me një fjalë, dita e tij ruhet nga nata, sepse zemra e tij është mbushur me dritën hyjnore. Punët e ditës ushqehen me dritën hyjnore që ai ka fituar gjatë natës. Në një hadith urdhërohet: “*Fytyra e atij që fal namaz nate është e shndritur gjatë ditës.*” (Ibën Maxhe, Ikame, 174)

Për shkak se namazin e natës e konsiderojnë si një aktivizues i rëndësishëm të botës shpirtërore, njerëzit e tasavvufit i japin rëndësi të veçantë edhe mënyrave që e lehtësojnë ngritjen në namazin e natës. Autori i “Avarifu’l-Maarif”, në veprën e tij i radhit kështu mënyrat që lehtësojnë ngritjen në namazin e natës:

1- Të ripërtërihet abdesi pas perëndimit të diellit, ndërsa koha midis namazit të akshamit e jasisë të kalohet duke lexuar Kuran e duke bërë dhikër.

2- Largimi nga fjalët që konsiderohen të kota dhe bosh pas namazit të jasisë.

3- Të ndërrohen zakonet të cilat i pëlqejnë nefsit dhe e bëjnë gjumin të rehatshëm.



4- Të pakësohet ushqimi në mbrëmje, me qëllim që stomaku të mos jetë i ngopur.

5- Të flet me abdes dhe me nijetin (qëllimin) për t'u ngritur në namazin e natës.

Për shkak se koha e muzgut të mëngjesit është një hapsirë kohore ku Allahu Teala shfaqet me mëshirën dhe faljen e Tij në qiellin e dynjasë (Shih. Ibën Maxhe, Ikame, 191; Ibën Hanbel, II, 423), kjo kohë është pranuar si kohë adhurimi, përkujtimi, dhe meditimi. Por, në të njëjtën kohë, kjo hapsirë kohore është edhe ajo në të cilën gjejnë frymëzimin e tyre poetët dhe shkrimtarët. Ajo është koha të cilën poetët e zgjedhin për poezitë e tyre, të dashuruarit për serenatat e tyre dhe të penduarit për pendimin e tyre. Mbi të gjitha, ajo është koha kur bilbilat janë në dashuri, shpirtrat në përgjërime dhe koha kur ndahet risku.

Pra, nëse një besimtar i braktis adhurimet, lutjet dhe përgjërimet ndaj Allahut në kohën e muzgut të mëngjesit dhe në zemrën e tij zë vend dashuria për dynjanë, në një farë kuptimi ai i ka kthyer shpinën Allahut të Madhëruar.



Nexhat Ibrahim

REFLEKSIONE TË SHKURTRA RRETH PERCEPTIMIT TË ALLAHUT NË ISLAM

Është fakt i njohur se çdo gjuhë ka një apo më shumë emërtime në lidhje me Zotin. Një nga këto emërtime për Zotin është fjala **Allah** (الله), i cili është emër i përveçëm për Zotin Një, të Vetëm. Asgjë tjetër nuk mund të quhet **Allah**. Sipas gjuhëtarëve, fjala **Allah** nuk ka as numër shumës as gjini dhe paraqet rast unikal nëse krahasohet me fjalët Zot, Perëndi, Hyjni, nga të cilat fjalë mund të përftohet shumësia: zota, perëndi, hyjni, ose gjinia: perëndeshë, hyjneshë etj.¹

Për myslimanin, Allahu është i Gjithëmundshëm, i Gjithëfuqishëm, Krijues dhe Mbajtës i Universit. Asgjë nuk i ngjason Atij dhe askush nuk mund të krahasohet me Të. I pyetur nga bashkëkohësit e tij për Zotin, Muhamedi (a.s.) u përgjigj me suren El-Ihlas:

Thuaj: "Ai është Allahu, Një dhe i Vetëm! Allahu është Absoluti, të Cilit i përgjërohet gjithçka në amshim. Ai as nuk lind, as nuk është i lindur. Dhe askush nuk është i barabartë (a i krahasueshëm) me Atë!"

Disa fe të tjera e imponojnë mendimin para auditorit të tyre se Zoti në Islam është rigoroz dhe i vrazhdë, sepse Ai kërkon nga krijesat e sidomos nga njeriu nënshtrim, dorëzim të plotë, sepse Zoti ekskluzivitetin e Njëshit ia lë vetvetes, se Ai nuk është i mëshirshëm, falës, i butë etj. Mirëpo, nëse u hedhim edhe një vështrim emrave të sureve kuranore, sho-

1. Është interesant të theksohet se edhe në gjuhën e Isait (a.s.), në gjuhën arameike, fjala Zot thuhet Allah. Kjo për më tepër sepse gjuha arameike, bashkë me gjuhën hebraike dhe arabe, janë gjuhë semite, gjuhë motra.

him se çdo sure fillon me Bismil-lahirr-rrahmanirr-rrahim, që do të thotë: "Në emër të Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit".

Allahu nuk ngelet vetëm në cilësitë e mësipërme, por Ai është edhe *I Drejtë*. Si rezultat i drejtësisë së Tij, njerëzit e virtutshëm do të shpërblehen me xhenet, kurse të ligët e mëkatarët do të ndëshkohen. Është e qartë se nuk mund të kenë të njëjtin trajtim ata që gjithë jetën e tyre shkaktojnë dhembje dhe dëme tek të tjerët me ata që punojnë me ndershmëri dhe përjetojnë dhembje nga shfrytëzuesit e njeriut dhe dhunuesit e të drejtave njerëzore. Nëse për shkak të kësaj drejtësie Allahu konsiderohet prej kundërshtarëve me cilësi shëmtuese, atëherë këtu kemi të bëjmë me njerëz apo grupe tendencioze.

Ajeti vijues kuranor është i qartë dhe kuptimplotë:

"Për ata që ruhen (nga gjynahet), tek Allahu do të ketë kopshite të kënaqësive. Vallë, a t'i trajtojmë ata që Na nënshtrohen njësoj si keqbërësit?! Çfarë keni ju (jobesimtarë)? Si po gjykoni kështu?!" (El-Kalem: 34-36).

Idetë dhe insinuatat e mësipërme janë rezultat ndër të tjera edhe të koncepteve vetjake të Zotit, siç është perceptimi hebraik dhe kristian sipas të cilit Zoti ka krijuar gjashtë ditë, kurse ditën e shtatë, për shkak të lodhjes, e ka zgjedhur për ditë pushimi (shabati), apo perceptimi se Zoti ka bërë pehllivanllëk me Davidin, të cilin e ngadhënjeu vetëm pas shumë përpjekjesh etj. Islami i konsideron blasfemi këto bindje dhe

pjellë të imagjinatës së sëmure.² Vetëm emri Allah, unikal në përdorim dhe kuptim, tregon pastërtinë e perceptimit islam të Zotit. Për këtë arsye, çdo ngatërrim krijesash ose hyjnish me Zotin absolut, nuk është i pranuar dhe madje do të konsiderohet mëkat i pafalshëm dhe i ndëshkueshëm me xehenem:

“Vërtet, Allahu nuk fal që të adhurohet dikush apo diçka tjetër veç Atij, por gjynahet e tjera më të vogla ia fal kujt të dojë. Kushdo që i bën shok Allahut (në adhurim), ka bërë gjynah të tmerrshëm.” (En-Nisa: 48).

Zoti është ndryshe nga të gjitha krijesat, nga të gjitha botët, sepse po të ishte i njëjtë apo i ngjashëm, Ai nuk do të ishte zot, por vetëm një nga krijesat me pamje tjetër. Ai është Një, i Vetmi, i Vetëmjaftueshëm, pa kohë dhe hapësirë dhe çdo perceptim për të është vetëm një imagjinatë dhe asgjë tjetër. Allahu i mëshirshëm thotë për vetveten:

“Asgjë nuk i ngjason Atij.”

Zoti është shkaku përfundimtar i çdo gjëje:

“Allahu është Krijuesi i çdo gjëje dhe Ai është Mbikëqyrës i çdo gjëje. Të Tij janë çelësat e qiejve e të Tokës! Sa për ata që i mohojnë shpalljet e Allahut, ata janë të humbur!” (Ez-Zumer: 62-63).

“S’ka asnjë gjallesë në Tokë që të mos i ketë mjetet e jetesës prej Tij. Ai di vendbanimin e saj dhe vendin e vdekjes. Të gjitha këto janë (të shënuara) në Librin e qartë.” (Hud:6)

Allahu është i Ngahershëm dhe i Përhershëm, i Pari dhe i Fundit, dhe cilësitë e Tij janë absolute e jo të kufizuara. Cilësitë e Tij janë gjithnjë dhe do të jenë gjithnjë. Këto cilësi nuk janë të ndashme në dy e më shumë zota, por e drejtë ekskluzive i Një, të Vetmit Allah. Muhamedi (a.s.) ka porositur:

“Mendoni për krijimin e Allahut, por mos mendoni për Zotin.”

“Allahu nuk ka zgjedhur për Vete ndonjë bir dhe përveç Atij s’ka asnjë zot tjetër, përndryshe çdo zot do të merrte atë që ka krijuar dhe do të ngriheshin njëri mbi tjetrin. Qoftë i lartësuar Ai nga shpifjet e tyre!” (El-Mu’minun: 91).

“Sikur në qiej dhe në Tokë të kishte zota të tjerë, përveç Allahut, si qiejt, ashtu edhe Toka do të shkatërroheshin. Qoftë i lavdëruar Allahu, Zoti i Fronit dhe i lartësuar mbi çka ia veshin Atij!” (El-Enbija: 22).

Në anën tjetër, Allahu i Lartëmadhërishtëm na përkujton zotët e rrejshëm dhe karakteristikat e tyre dhe Zotin e mirëfilltë dhe pastërtinë e besimit:

Ai u tha: “Vallë, ju adhuroni ato që i keni gdhendur vetë...?” (Es-Saffat: 95).

“...Thuaj: “Allahu!” Thuaj: “A keni pranuar përveç Tij zota që nuk kanë mundësi t’i sjellin as dobi as dëm vetvetes?” (Er-Ra’d:16).

“Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim), Njohësi i së dukshmes dhe i së padukshmes, Ai është i Gjithëmëshirshmi, Mëshirëploti! Ai është Allahu, përveç të Cilit nuk ka Zot tjetër (të denjë për adhurim). Ai është Sunduesi, i Shenjti (i pastër nga çdo e metë), Paqedhënësi, Dhënësi i sigurisë, Mbikëqyrësi mbi gjithçka, i Plotfuqishmi, Imponuesi, Madhështori. Qoftë i lartësuar Allahu mbi gjithçka që ia shoqërojnë Atij (në adhurim)! Ai është Allahu, Krijuesi, Zanafillësi, Ai që i jep trajtë çdo gjëje. Atij i përkasin emrat më të bukur; Atë e lavdëron gjithë çka që ndodhet në qiej e në Tokë, Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.” (El-Hashr: 22-24).

“Allahu! Nuk ka zot tjetër (që meriton adhurimin) përveç Tij, të Gjallit, të Përtjetshmit, Mbajtësit të gjithçkaje! Atë nuk e kaplon as dremitja, as gjumi! Atij i përket gjithçka që gjendet në qiej dhe gjithçka që gjendet në Tokë. Kush mund të ndërhyjë tek Ai për ndokënd pa lejen e Tij? Ai di çdo gjë që ka ndodhur përpara dhe çdo gjë që do të ndodhë pas njerëzve, kurse ata nuk mund të përvetësojnë asgjë nga Dituria e Tij, përveçse aq sa Ai dëshiron. Kursi-u i Tij shtrihet mbi qiejt dhe Tokën dhe Ai nuk e ka të rëndë t’i ruajë ato. Ai është i Larti, Madhështori!” (El-Bekare: 255).

“O ithtarët e Librit! Mos e kaloni kufirin në besimin tuaj dhe për Allahun thoni vetëm të vërtetën! Mesihu - Isai, i biri i Merjemes, është vetëm i Dërguar i Allahut dhe Fjala e Tij, të cilën ia ka dërguar Merjemes, si dhe shpirt (i krijuar) nga Ai. Pra, besojini Allahut dhe të dërguarve të Tij! Dhe mos thoni: “Tre zota”! Hiqni dorë, se është më mirë për ju! Allahu është vetëm një Zot - qoftë lavdëruar Ai! Ai është tepër i lartësuar për të pasur fëmijë. E Tij është gjithçka që gjendet në qiej dhe në Tokë. Allahu mjafton për rregullimin e gjithësisë.” (En-Nisa: 171).

Islami ndalon paraqitjen e Zotit në formë njeriu apo paraqitjen e Tij në formë fotografie, skulpture, portreti e të ngjashme, siç ndodh tek disa popuj. Kjo traditë kryesisht bazohet në premisa të fuqisë individuale, të prejardhjes fisnore, pasurisë individuale e familjare, apo shtresës shoqërore së cilës i përkiste individit që besonte. Në Islam një gjë e tillë është e ndaluar, sepse njeriu nuk mund ta perceptojë Zotin në asnjë formë apo mënyrë, përveç ta besojë ashtu siç e përshkruan Ai veten në Kuran, kurse vetë njerëzit mund të krahasohen mes tyre vetëm në bazë të devotshmërisë dhe virtyteve (takvallëkut):

“O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime, se, vërtet, disa dyshime janë gjynah. Mos e spiunoni dhe mos e përgojoni njëri-tjetrin! Mos vallë dëshiron ndokush prej jush të hajë mishin e vëllait të vet të vdekur?! Sigurisht që ju do ta urrenit këtë! Kijeni frikë Allahun! Me të vërtetë, Allahu është Pranues i pendimit dhe Mëshirëplotë.” (El-Huxhurat: 12).³

2. Konsulto: Dejvid Xh. Goldberg – Xhon D. Rejner, Jevreji – Istorija i religija, Beograd, 2003.

3. Konsulto librin: Mustafa Mahmud, Allah, Tetovë, 1997.



Qëllimi i arsimit islam

William C. Chittick

vijon nga numri i kaluar...

Arsimi tradicional islam është përpjekur të sigurojë mjetet përmes të cilave njerëzit mund ta arrijnë vetë një vizion të teuhīdit. Ndjekja e Rrugës së Drejtë shihej si përpjekje individuale që kërkonte të kuptuarit e rrjedhimeve të teuhīdit për vetë individin. Vetëm atëherë do të mund t'i drejtohej ai/ajo ndihmës së të tjerëve. Sipas shumë dijetarëve myslimanë, sidomos atyre me prirje filozofike, qëllimi i ndjekjes së Rrugës së Drejtë është tehkīku, pra realizimi dhe verifikimi.

Tehkīk vjen nga fjala *hak*, një emër kuranor i Zotit, që do të thotë, i vërtetë, real, i duhur, i denjë. Rrjedhimi i këtij emri hyjnor është se vetëm Zoti është e vërteta, realiteti, e drejta dhe e duhura. Mirëpo, Kurani na thotë se Zoti krijoi gjithçka me hak, pra me të vërtetën, të drejtën e të duhurën. Profeti ka thënë se gjithçka ka hakun e vet dhe se njerëzit duhet t'ia japin hakun çdo zotëruesi të hakut. Pra, çdo gjë e ka një të vërtetë dhe një drejtësishtëmëri. Ajo nënkupton po ashtu se “përgjegjësia” (*hak 'alejnā* = “e drejta mbi ne”) njerëzore është që të veprohet ndaj gjithçkaje në

përputhje me të vërtetën dhe drejtësishtëmërinë e saj.

Sipas një hadīthi të famshëm, Zoti ka një hak - një të drejtë - ndaj njerëzve, dhe ajo e drejtë është që ata të deklarojnë Unitetin e Tij, të pohojnë teuhīdin. Me fjalë të tjera, teuhīdi është *përgjegjësia* e parë njerëzore. Hadīthi vazhdon e thotë që, nëse njerëzit e përmbushin këtë përgjegjësi, është e drejta e tyre ndaj Zotit që t'u jepet lumturi e përjetshme. Me fjalë të tjera, është *përgjegjësia* e Zotit që t'i shpëtojë nga Ferri e t'i vendosë në Parajsë. Thashë se qëllimi i arsimit islam është tehkīku. Tehkīk do të thotë të njohësh hakun e gjërave dhe të veprosh në përputhje me të. Haku i parë që duhet njohur është ai i Zotit, sepse nuk ka hak të vërtetë përveç hakut absolut dhe të vërtetë – nuk ka asgjë vërtetësishtë të drejtë, reale dhe të duhur përveç Zotit. Njëkohësisht, tehkīk do të thotë të jetosh në përputhje me hakun e Zotit. Fryti i kësaj është shpëtimi. Mënyra e arritjes së tehkīkut parashtrohet nga profetët, specifikisht në Rrugën e Drejtë. E drejta e Zotit ndaj nesh - që të pohojmë Unitetin e Tij - shtron themelet e të gjitha të drejtave të njerëzimit dhe krijimit, sepse Zoti ia ka dhënë gjithçkaje hakun e saj dhe ka siguruar udhëzimin se si të

respektohen këto haqe. Kjo do të thotë se e drejta e Zotit ndaj nesh është themeli i të gjitha përgjegjësive tona njerëzore.

Në pastë ndonjë tejvështrim të traditës myslimane pas teuhidit, është se askush nuk mund ta ndjekë Rrugën e Drejtë për ty. Çdo individ thirret të futet vetë në Rrugën e Drejtë, dhe secili do të konsiderohet përgjegjës për përpjekjet e veta. Kurani e thekson këtë në pesë ajete të ndryshme: (Askush nuk e bart barrën e një tjetri) (6:164, 17:15, 35:18, 39:7, 53:38). ‘Ulematë kanë përgjegjësinë t’ua ofrojnë të tjerëve çdo dije që mund të kenë, por njerëzit kanë përgjegjësinë e kërkimit të asaj diturie. Askush nuk mund të detyrohet të kërkojë të vërtetën dhe askush nuk mund të detyrohet ta kuptojë atë. Kurani thotë *la ikrāhe fīd-dīn*: nuk ka detyrim e as shtrëngim në fe. Sërish, kjo nuk është urdhëresë morale, por pohim faktual. “Feja” është Udha e Drejtë dhe është e pamundur të detyrohet ndokush për ta ndjekur. Të gjitha lëvizjet moderne islamiste e shpërfillin këtë të vërtetë elementare, duke e kthyer fenë në sistem ideologjik, të cilin pastaj përpiqen t’ia imponojnë shoqërisë. Kjo ndihmon në shpjegimin e natyrës autoritare të regjimeve që ato arrijnë të vendosin. Kjo është një ndër pikat e shumta ku nocionet moderne të arsimit u bien ndesh tradicionaleve. Sot njerëzit besojnë në “arsimin e detyruar”, që në të vërtetë është indoktrinim - apo më mirë - trushpëlarje e detyruar. Dikur njerëzit ishin shumë më të ndërgjegjshëm për faktin se: të kuptuarit nuk mund të mësohet, por vetëm të zbulohet brenda vetes.



Në diskutimin e tehkikut si qëllimi i Rrugës së Drejtë, dijetarët myslimanë janë të kujdesshëm në përcaktimin e dallimit të tij nga teklidi. *Teklīd* do të thotë imitim dhe konsiderohet i përshtatshëm vetëm në çështjet e praktikës. Për të qenë mysliman i mirë, duhet ndjekur Suneti dhe emuluar praktika e Profetit, njohuria për të cilën duhet marrë nga juristët, ekspertët e Sheriatit.

Mirëpo, teklidi nuk ka vend në teuhid. Nuk mund të thuhet “besoj në njëshmërinë e Zotit sepse më ka thënë mësuuesi të besoj.” Ose, më mirë, kjo mund të thuhet por do të vërtetonte thjesht që personi nuk kupton dhe se pohimi i njëshmërisë së Zotit nga ana e tij mbështetet në injorancë. Ajo nuk ka hyrë akoma në mendjen dhe zemrën e tij. Vini re se Kurani flet për teuhidin si mesazhi universal i të gjithë profetëve. Secili prej tyre mori mesazhin (Nuk ka zot veç Meje, ndaj shërbemëni Mua!) (20:114). Shumica e dijetarëve pohojnë se teuhidi ka të bëjë me natyrën njerëzore, që quhet *fitre*, mënyra në të cilën janë krijuar njerëzit. Profetët erdhën me udhërrëfim, i cili fillon me “të përkuj-



tuarit” (*dhīkr, tedhkīre*). T’u kujtosh njerëzve një gjë, do të thotë t’u përmendësh diçka që tashmë e dinë, në mënyrë që ta sjellin ndër mend. Profetët erdhën për të zgjuar fitren njerëzore, për të larguar harresën që ua kishte errësuar njerëzve të kuptuarit e teuhidit. Kjo dije është e lindur në çdo inteligjencë të shëndoshë, te çdo njeri. Mirëpo, për të rrokur atë çfarë ajo nënkupton, njerëzve u nevojitet udhëzimi profetik - pra, u nevojitet ‘arsimi/edukimi’.

Cilido arsimim i denjë për emrin ‘islam’, duhet të shpjegohet kah të kuptuarit e teuhidit dhe zbatimi i tij në praktikë. Përndryshe nuk është udhëzim, por kequdhëzim (*idlal*, atributi kuranor i Shejtanit). Njohja e teuhidit e fituar me *teklīd* është thjesht mësim papagalli. Pa dyshim, kujtesa e Kuranit është meritë e lartë dhe ka shpërblime, por të memorizuarit nuk është njëllë me të kuptuarit. Tehkiku ose realizimi do të thotë pikërisht të kuptosh vetë; ta njohësh të vërtetën e të drejtën e diçkaje dhe të veprosh në përputhje me të vërtetën e të drejtën.



Është karakteristike për kohët moderne që çdo diskutim për “arsimin” të sillet rreth nevojave të shteteve e shoqërive. Këto nevoja përkufizohen në terma të perëndive shumë, që sundojnë botëkuptimin e tekthirit. Këta zota janë të mirënjohur për të gjithë, sepse përcaktojnë orientimin e shoqërive moderne dhe diskutohen vazhdimisht



nga politikanët dhe ideologët. Njerëzit pandehin se këta zota janë zota të mirë, dhe nëse i adhurojnë zotat duke i kushtuar përpjekje arritjes së asaj që ata premtojnë, do të jenë të lumtur. Adhurimi i këtyre zotave është pjesë e etosit modern dhe merret si i mirëqenë, tamam siç merrej i mirëqenë teuhīdi, i cili ishte pjesë e etosit paramodern.

Parë brenda shumë konteksteve, sot është e rrezikshme të flasësh kundër zotave të tekthirit, sepse adhuruesit e këtyre zotave janë fanatikë dhe kanë pushtet të madh shoqëror e politik. Megjithatë, duhet të jemi realistë e të pranojmë emrat e zotave sundues të kohës sonë. S'ka ndonjë listë shteruese, sepse zotat janë aq shumë. Por këta emra janë përfaqësues: liria, demokracia, shkenca, mjekësia, teknologjia, progresi, zhvillimi, barazia, arsimit.

Adhurimi i perëndisë “arsim” nderohet maskimalisht. Të gjitha perënditë e tjera na inkurajojnë të vizitojmë tempujt e këtij zoti, sepse arsimit i stërvit njerëzit për të flakur zotët e lashtë dhe për të braktisur parimet e mendimit tradicional: teuhīdin, profetësinë e Kthimin. Në këtë kuptim, arsimit përbën kudo interesin parësor të politikanëve e të shteteve. Shtetet duhet të ofrojnë arsimit, t'i stërvisin njerëzit në botëkuptimin e tekthirit dhe t'i mësojnë me adhurimin e tempujve të aq shumë perëndive. Përgjegjësia më e vogël e myslimanëve në këtë situatë, është që të pranojnë se arsimit modern luan rol shkatërrimtar ndaj qëllimeve të teuhīdit. Pa i njohur udhët pa krye të ideologjisë dhe premtimeve boshe të parajsës që bëjnë politikanët, nuk do të ketë shpresë që njerëzit të ndjekin Udhën e Drejtë.



Për ta mbyllur kumtesën time të shkurtër, më lejoni të bëj një citim nga një prej “edukuesve/arsimuesve” më të mëdhenj të historisë islame, Meelānā Xhelāl ed-Dīn Rumīu. Në një prej veprave të tij në prozë, ai e shpjegon synimin e arsimit, në terma të detyrës njerëzore për të mbajtur Amanetin e lënë nga Zoti. Ky Amanet, i përmendur në ajetin që ai citon, nuk mbartet dot pa ndjekur Rrugën e Drejtë:

Ka diçka në këtë botë, që s'duhet ta harroni kurrë. Mund të harroni gjithçka, por jo këtë, nuk do keni pse të druheni. Por nëse i kryeni, i kujtoni e nuk i hiqni nga mendja të gjitha gjërat dhe e harroni këtë të vetme, atëherë nuk do të keni bërë as edhe një gjë.

Ta zëmë se një mbret ju dërgon në një fshat për një detyrë të caktuar. Ju shkoni e kryeni njëqind detyra të tjera, por nuk kryeni atë për të cilën u nisët. Është tamam sikur të mos kishit bërë asgjë.

Njerëzit kanë ardhur në këtë botë për një detyrë e ky është qëllimi i tyre. Nëse nuk e kryejnë atë, nuk do kenë bërë asgjë. (Ne ua ofruam Amanetin qiejve dhe tokës e maleve, por ato refuzuan ta merrnin përsipër dhe iu frikësuan; ndërsa njeriu e mori përsipër. S'ka dyshim se ai është treguar zullumqar, i paditur). (33:72)

(Ne ua ofruam Amanetin qiejve dhe tokës, por ato s'e pranuan). Qiejt, toka dhe malet bëjnë gjithë ato gjëra, por është një detyrë, të cilën s'e bëjnë dot. Kjo detyrë e vetme kryhet vetëm nga njeriu... Kur e kryejnë atë detyrë, “zullumi” e “padituria” do asgjësohen prej tyre. Në thënjë: “Edhe po të mos e kryej atë detyrë, kryej shumë të tjera!” – ti s'je krijuar për ato të tjerat.

Është tamam si të marrësh një shpatë të paçmueshme çeliku indian, si ato nga thesaret e mbretërve, dhe ta bësh hanxhar për mish të kalbur. Pastaj thua: “S'e lë këtë shpatë të rrijë kot, bëj aq shumë gjëra të dobishme me të!” Ose, merr një tas ari dhe gatuan rrepa në të. Kur me një grimcë të vetme të atij ari mund të blesh njëqind tasa! Ose e kthen një kamë të stolitur me xhevahirë, në varëse kungulli të çarë e thua: “Po e përdor mirë, po var kungullin në të. S'po ia lë tehun të rrijë kot.” Ku qëndron urtia e përdorimit të një kame të tillë që vlen njëqind dinarë?

Zoti të ka dhënë vlerë të jashtëzakonshme. Ai thotë: (S'ka dyshim se Zoti ka blerë nga besimtarët vetet e tyre dhe pasuritë e tyre, që të mund të kenë Xhenetin) (9:111)... Mos e shit veten lirë – ti ke çmim tepër të lartë!¹

Shqipëroi: Edin Q. Lohja

1. *Fīhi mā fīhi* (red. B. Furūzānfar), ff. 14-15.



Namazi i natës

udhëtim shpirtëror

Mr. Zymer Ramadani

Njëra nga mrekullitë që Allahu i Madhëruar ka bërë për njerëzit e kësaj bote, është edhe ndërrimi i kohëve, viteve, stinëve, muajve, javëve dhe ditëve në net. Ai, me madhërinë e Tij bëri që në disa periudha të këtyre që thamë, njerëzit të gjejnë prehje dhe ta kalojnë atë periudhë duke pushuar apo duke u marrë me diçka që do të ishte në dobi të madhe të njeriut. Meqë Allahu i Madhëruar krijoi natën dhe ditën, Ai na tregoi se dita vlen për angazhim, përfitime të kësaj bote dhe botës tjetër dhe për të siguruar jetesën, përkrah natës, e cila është kohë pushimi dhe mbulojë e çdo gjallese, në këtë rast edhe e njeriut. Andaj këtu duhet të cekim se edhe ibadetet që Allahu i caktoi, janë kryesisht gjatë ditës, e ka edhe prej atyre që bëhen edhe natën, por që janë vullnetare, mirëpo me një gradë dhe shpërblim të madh nga Krijuesi Fuqplotë. Po ashtu këto ibadete që bëhen natën, njeriun e zhvillojnë dhe e rrisin moralisht në një shkallë që nuk mund të arrihet përmes ndonjë mënyre tjetër. Për këta njerëz fatlumë, Kurani shprehet në këtë mënyrë:

“Robërit e të Gjithëmëshirshmit janë ata që ecin thjesht nëpër Tokë dhe, kur të paditurit i sulmojnë me fjalë, ata përgjigjen: “Paqe qoftë!”; dhe ata që e kalojnë natën duke iu falur Zotit të tyre në sexhde dhe në këmbë.”¹

“Ata ngrihen nga shtrati, i luten Zotit të tyre me frikë e shpresë dhe japin nga ajo që iu kemi dhënë Ne.”²

1. Furkan, 25/ 63, 64
2. Sexhde, 32/16

Transmetohet nga nëna e besimtareve, Aishja (r.a.) se: *“Pejgamberi (a.s.) zgjohej naten dhe u falte derisa iu enjteshin këmbët, dhe i thashë: O i dashur i Allahut, përderisa ty t’i ka falur Allahu gabimet e kaluara dhe ato të ardhmet, pse vepron kështu? Pejgamberi (a.s.) iu përgjigj: A të mos jem një rob falënderues?”³*

Në ajetet Kuranore gjithmonë është cekur se njeriu është i ngarkuar vetëm me aq sa mundet të përballojë, dhe në asnjë mënyrë apo formë tjetër nuk është rënduar me ndonjë obligim apo detyrë të vështirë. Sepse siç thuhet *“feja është lehtësi dhe ajo e do të lehtën”*, parimi i saj është shëndeti dhe jeta e njeriut. Për këtë, feja islame ka vënë në dispozitën e saj këto vlera njerëzore:

1. Jeta – Kjo ka një vlerë më të madhe se gjithçka tjetër në këtë jetë. Vlera e kësaj në Kuran theksohet kështu:

“... kush vret ndokënd, që s’ka vrarë njeri ose që nuk ka bërë çrregullime në Tokë, është sikur të ketë vrarë të gjithë njerëzit. Dhe, nëse dikush shpëton një jetë, është sikur të ketë shpëtuar jetën e krejt njerëzve.”⁴

2. Mendja – Lidhur me intelektin e njeriut Allahu ((xh. sh.)) po ashtu në shumë vende në Kuran urdhëron apo preferon që të mendojmë, të ecim drejt zhvillimit mendor duke e përdorur atë në vepra të mira, duke studiuar shkenca të ndryshme etj. Allahu pyet: *Thuaj: “A janë të bara-*

3. Muttefekun Alejhi
4. Maide, 5/32.



bartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?! Vetëm mendarët i pranojnë këshillat!⁵

3. Edhe Muhamedi (a.s.) thotë se nuk ka fe ai, i cili nuk është i mençur, pra ai që nuk zotëron mendjen e shëndoshë nuk është i obliguar me dispozita fetare.

4. Pasuria - Allahu ((xh.sh.)) i ka dhënë çdo myslimani të drejtën që të fitojë pasuri, të orvatet që ta rrisë atë dhe gjithmonë të jetë i kënaqur me të, por që në fund të çdo viti të bëjë llogarinë e saj se a duhet dhënë zekati apo jo. Allahu: **“Ju shumon pasurinë dhe fëmijët, ju bën të keni kopshite dhe ju jep lumenj.”**⁶ Edhe Pejgamberi (a.s.) thotë: “Sa e mirë është pasuria e mirë tek besimtari i mirë”.

5. Feja - Pa këtë shenjtëri nuk mund të ekzistojë njeri, nëse nuk e mbështet njeriu shpirtin e tij në një Zot të vetëm, ai nuk do të ketë ndonjë sistem frytdhënës të jetës së tij. Feja islame është ajo që gjithmonë ka ruajtur gjeneratat njerëzore.

6. Brezi - Pikërisht këtu Islami përqendrohet duke venë norma të ndryshme që të ruhet brezi dhe gjinia njerëzore. Për këtë Allahu (xh.sh.) urdhëron martesën dhe ka venë dispozita të rrepta në lidhje me krijimin e familjes dhe ruajtjen e brezit.

Meqë dijetarët Islam, duke u bazuar në shkencat Kurane, kanë vendosur këto pika të rëndësishme, dhe meqë

5. Zumer, 39/9.

6. Nüh, 71/12.

më sipër përmendëm se nata është ajo që Allahu e ka bërë për pushim dhe fjetje, prapë se prapë Ai, ka dashur që besimtarët e devotshëm një pjesë të saj ta kalojnë në adhurim, të përqendrohen shpirtërisht në lidhjen me Allahun (xh.sh.).

Në lidhje me rëndësinë e namazit të natës ka transmetime të shumta. Në njërin prej tyre i cili transmetohet nga Ebu Hurejra thuhet se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: **“Pas namazeve të përcaktuara (farz) namazi më i mirë është ai i natës.”** Po ashtu transmetohet nga Ali ibn Ebi Talib se atij dhe Fatimes, bijës së Pejgamberit (a.s.) Pejgamberi u kishte trokitur në derë duke i pyetur: **“A nuk po faleni?”**⁷ e ai ishte përgjigjur: **“O pejgamber i Allahut, shpirtat tanë janë në dorën e Allahut dhe Ai i ringjall (d.m.th. i zgjon) kur Ai do.”** Kur e thashë këtë ai shkoi pa më thënë gjë. Pas pak e dëgjova se si në largim e sipër, po thoshte duke lexuar ajetin: **“...por njeriu kundërshton më tepër se çdo krijesë tjetër.”**⁸ Imam Taberiu në lidhje me këtë rast deklaroi: **“Sikur Pejgamberi (a.s.) të mos e kishte ditur rëndësinë e namazit të natës, ai me siguri nuk do ta kishte shqetësuar bijën e vet dhe Aliun, posaçërisht në kohën të cilën Allahu krijesave të Tij ia ka caktuar për pushim. Mirëpo për ta ai ka zgjedhur atë që është më e mirë.”**

Nga kjo duhet të veçojmë se namazi i natës është një namaz vullnetar, por, Pejgamberi (a.s.) i ka dhënë një rëndësi të madhe faljes së këtij namazi, për arsye se ky namaz ka shumë begati dhe mirësi. Ai ka dashur që të zbatojë urdhrin e Allahut ku i është drejtuar duke i thënë: **“Kaloje një pjesë të natës, si falje shtesë për ty (Muhamed)! Është e vërtetë se Zoti yt do të të vendosë ty në një vend të lavdëruar.”**⁹ Dijetarët kanë hedhur mendime të ndryshme në lidhje me këtë çështje duke thënë se namazi i natës ka qenë obligim vetëm për Pejgamberin (a.s.), e jo për të tjerët. Ndërsa për vlerën dhe shpërblimin e tij, Pejgamberi (a.s.) e shqetësoi Aliun (r.a.) që edhe ai të marrë nga kjo pjesë e shpërblimit që ka ndarë i Lartmadhërishtëmi.

Në këtë mënyrë, myslimanët duhet të përqendrohen në namazet vullnetare, gjegjësisht ato të natës. Këtë kategori njerëzish Allahu e çmon lart dhe atyre u garanton begati të mëdha. Allahu (xh.sh.) në Kuran thotë: **“A mund të krahasohet ai që falet natën, duke bërë sexhde dhe duke qëndruar në këmbë e që ruhet prej jetës tjetër dhe shpreson në mëshirën e Zotit të tij**

7. Buhari, Tehexhxhud, 5; Muslim, Musafirin, 206.

8. Kehf, 54

9. İsrâ, 17/79.

(me jobsimtarin)?!¹⁰ Po ashtu njerëz të tillë, nuk kanë asnjë brengë për ndonjë ndodhi që mund t'u paraqitet. Në këtë kontekst Allahu (xh.sh.) në mënyrë të përpiktë ndalet duke na tërhequr vëmendjen dhe duke dhënë një shfaqje mahnitëse të këtyre njerzëve në Kuran. Ai thotë: **“Natën flinin vetëm pak dhe para agimit luteshin për faljen e mëkateve.”**¹¹ Ndërsa për gjendjen e tyre shpirtërore se çfarë ndiejnë ata, Allahu po ashtu e shfaq brendinë e zemrave dhe shpirttrave të robërve të Tij të devotshëm. Për ta, çdo gjë është e mirëseardhur, dhe nuk shqetësohen për asgjë: **“Ata lartësojnë (Allahun) natë e ditë dhe nuk mërzhiten”**.¹²

Gjithmonë duhet të kthehemi tek shembulli më i shkëlqyeshëm i njerëzimit, drita e errësirës së zemrave të ndotura nga mëkatet dhe mosnjohja e së vërtetës, duhet të kthehemi tek Pejgamberi (a.s.) ku në lidhje me namazin e natës ishte shembulli më i mirë që duhet të ndjekim. Ai hidhërohej për shokët dhe miqtë e tij të cilët nuk tregonin kujdes ndaj namazit të natës. Njëri nga ata ishte Abdullah ibni Omeri (r.a.). Pejgamberit (a.s.) dhe dëshironte që edhe ai të përfitoje diçka nga namazi i natës, të mos jetë i privuar nga shpërblimet e Allahut (xh.sh.). Transmetohet nga Salim ibni Abdullah ibni Omer ibni Hattab (r.a.) se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Sa njeri i mirë është Abdullahu, sikur të zgjohej dhe të falej natën!”¹³

Edhe pse më vonë Abdullahu filloi që ta praktikojë këtë, ne këtu e vërejmë korrektësinë e Pejgamberit (a.s.) në lidhje me namazin e natës. Për besimtarin mysliman është e rëndësishme që këtë namaz të mundohet ta e kryejë, mirëpo të mos e shfaqë këtë duke u lavdëruar me punën që bën. Për këtë është thënë gjithashtu se besimtari përveç tjerash nuk duhet t'i përmendë dy gjëra të rëndësishme:

a) Një të keqe që mund ta bëjë dikush qoftë i afërt apo i huaj, ngase që një ditë mund të jetë miku yt i dashur,

b) Një të mirë që ia bën dikujt, sepse për këtë vetëm Allahu të shpërblen dhe vetëm Ai e di qëllimin e bërjes së kësaj vepre.

Në bazë të kësaj, namazi i natës është vetëm për Allahun dhe shpërblimin e tij e merr vetë falësi, sepse kur në kohën kur të tjerët janë duke fjetur, ai rob adhuron Allahun (xh.sh.), por këtë nuk duhet ta shfaqë gjatë ditës, në mënyrë që të mos mbetet pa ndonjë shpërblim.

Si përfundim i kësaj, namazi i natës në literaturën islame

quhet si “*Salātu'l-Lejli* apo edhe *Salātu't-Tehexhud*”.

- Është një namaz vullnetar, i cili robin e afron më tepër tek Allahu (xh.sh.). Ai po ashtu është një namaz që ka një shpërblim të posaçëm.

- Ai është një udhëtim i shpirtit drejt begatave të Allahut (xh.sh.)

- Pejgamberi (a.s.) këtë e ka praktikuar shumë herë dhe ka porositur që edhe të tjerët ta e kryejnë.

- Preferohet që të kryhet në pjesën e tretë të natës, para se të afrohet koha e imsakut,

- Numri i rekateve që duhet falur nuk është i caktuar, kjo mbetet në vullnetin e njeriut, por më së paku duhen falur dy rekate, sepse kështu është thënë edhe në hadith,¹⁴ e në qoftë se nuk mbetet shumë kohë atëherë këtë duhet plotësuar me rekatin e fundit që është Salātu'l-Vitri – Namazi i vitrit.¹⁵

- Preferohet që të lexohet Kuran, duke e kryer rukunë dhe sexhden po ashtu ngadalë dhe më gjatë.

- Allahu (xh.sh.) nuk e kthen lutjen e robit që e bën në këtë kohë të begatshme, sepse Ai thotë:

- A ka njeri që do të pendohet dhe t'ia pranoj pendimin?;

- A ka njeri që dëshiron diçka e që Unë t'ia jap?

- Preferohet që gjatë kohës së ramazanit, ky namaz të fallet në mënyrë kolektive dhe të caktohet një vend për faljen e tij.

- Njeriu, shpërblimin e këtij namazi e merr vetëm nga Allahu dhe nga askush tjetër.

- Në koleksionet e haditheve dhe literaturës tjetër islame i është dhënë një hapësirë e veçantë dhe e madhe përgëzimeve të Pejgamberit (a.s.) në lidhje me namazin e natës. Këto kanë një vlerë për myslimanët, sepse është një lehtësim për të hulumtuar rreth kësaj tematike.

Pejgamberi (a.s.) thotë: “*Agjërimi më i mirë pas muajit të ramazanit është ai i muajit të Allahut, muajit Muharrem, dhe namazi më i vlefshëm pas namazeve farze, është ai i natës*”.¹⁶

10. Zumer, 39/9.

11. Dharijat, 51/17-18.

12. Enbija, 21/20.

13. Buhârî, Tehexhxhud, 2/21, Fedâilu's-Sahâbe, 19.

14. Buhârî, Vitri, 2 etj. Hadithet janë të shumta në lidhje me numrin e rekateve, sepse sipas kohës dhe mundësisë pejgamberi (a.s.) Ka falur namaz.

15. Buhârî, Tehexhxhud, 10, Salât, 84 etj.

16. Muslim, Sijâm, 202.

ETIKA E BIZNESIT NË ISLAM

Dr. Muzemmil Siddik

Është me rëndësi të theksohet fakti se, nëse myslimanët do t'i përmbaheshin parimeve etike në jetën e përditshme, ata do të bëheshin shembull i atillë që edhe të tjerët të merrnin mësim. Ata do të ndihmonin që të përmirësoheshin imazhet e shtrembëruara për islamin në botën e sotme dhe do të bëheshin përfaqësues të merituar të fesë së tyre.

Allahu i madhërishëm në Kuranin fisnik urdhëron:

Popullit të Medjenit, Ne i dërguam vëllanë e tyre, Shuajbin. Ai tha: "O populli im, adhuroni Allahun! Ju s'keni tjetër zot përveç Tij. Mos bëni hile as gjatë matjes, as në kandar. Unë po shoh se ju gjendeni në begati dhe kam frikë se do t'ju godasë dënimi i një dite, që ju përfshin të gjithëve."

"O populli im, matni drejt në litër dhe kandar, mos ua hani njerëzve hakun e tyre dhe mos bëni ngatërresa në Tokë!"

"Ajo që ju është lënë nga Allahu, është më e mirë për ju, nëse jeni besimtarë; e unë nuk jam ruajtësi juaj."

Ata thanë: "O Shuajb, a mos vallë namazi yt urdhëron që ne t'i lëmë ato që i kanë adhuroar të parët tanë ose që të mos bëjmë çfarë të duam me pasurinë tonë? Ti qenke njëmend i butë dhe i drejtë!"

Ai tha: "O populli im, mendoni pak! Nëse unë kam provë të qartë nga Zoti im, i Cili më ka furnizuar me be-

gati të mira nga ana e Vet, a të mos ju udhëzoj në rrugën e drejtë?! Unë nuk dëshiroj të bëj atë, që jua ndaloj juve. Unë dëshiroj vetëm të përmirësoj atë që mundem, ndërsa suksesi im varet vetëm nga Allahu. Tek Ai mbështetem dhe Atij i drejtohem." (Hudë, 84-88)

I Dërguari i Allahut, Shuajbi, paqja e Zotit qoftë mbi të, i ishte dërguar njerëzve të Medjenit në kohën e Pejgamberit Musa (a.s.). Pejgamberi Shuajb (a.s.) i ishte dërguar njerëzve, të cilët ishin mjaft aktiv në punë. Ishin tejet krenar në diturinë e tyre të biznesit dhe të suksesit, por nuk ishin të ndershëm.

Shuajbi (a.s.) i këshillonte që t'i përmbaheshin parimeve etike në biznes, por ata hidhëroheshin me të dhe i thonin: **"Mos e përziej fenë me punën."**

Kurani na thotë se si i kaploi dënimi i Allahut këta njerëz, ndërsa Shuajbi (a.s.) dhe pasuesit e tij shpëtuan.

Vërtet duhet kuptuar seriozisht që secili duhet t'i përmbahet standardeve etike në biznes.

Puna dhe etika nuk janë të ndara, por të lidhura në mes tyre. Allahu i madhërishëm thotë në Kuran: **"Ju e kishit shembullin më të lartë në të dërguarin e Allahut..."** (El - Ahzab, 21)

Pejgamberi - Muhamedi (s.a.v.s.) ka qenë qenie njerëzore ideale që meriton respekt. Ishte mësuesi më i mirë, ligjërues dhe lider, burrë i mirë shteti, ligjdhënës, gjy-

katës, diplomat, konsultues dhe kryekomandant ushtarak, njeriu më i mirë familjar, bashkëshort i mirë, baba i dhembshëm, gjysh i dashur dhe mik i popullit të tij, por gjithashtu ishte edhe njeri shumë i ndershëm e biznesmen i suksesshëm.

Në moshën 40 vjeçare Muhamedi (s.a.v.s.) u zgjodh nga Allahu i madhërishëm për të qenë peygamberi i fundit. Para kësaj moshe ai ishte biznesmen shumë aktiv. I lindur në Meke, qytet i cili asokohe ishte i njohur për tregti. Karvanet nga Siria, drejt veriut, dhe nga Jemeni, drejt jugut, kalonin nëpër Meke. Muhamedi (s.a.v.s.) u bashkohej shpesh këtyre karvaneve. Transmetohet se ai ka udhëtuar në Siri, Jemen, Bahrein, dhe shumë vende të tjera në Arabi.

Disa historianë janë të mendimit që ai padyshim ka udhëtuar edhe në Irak e Etiopi.

Ai është marrë me tregti që në rininë e tij. Kishte reputacion të mirë si njeri i vyeshëm e i ndershëm. Kështu, duke marrë parasysh këtë reputacion të mirë, Hatixha (r.a.), e cila atëherë çmohej si një grua e pasur, e punësoi.

Shumë njerëz në Meke kërkonin dorën e saj për martesë dhe shumë njerëz punonin për të, por shpesh nuk e kryenin punën si duhet.

Më në fund, ajo dëgjoi për Muhamedin (s.a.v.s.), i cili atëherë nuk ishte peygamber, dhe e punësoi.

E dërgoi me karvan për të bërë tregti për të dhe rezultati i tij ishte shumë i suksesshëm.

Ndihej e mahnitur me punën e tij, e po ashtu edhe me karakterin e tij. Më pastaj u martuan.

Pas martesës me Hatixhen, Muhamedi (s.a.v.s.) vazhdoi punën dhe shkoi në disa udhëtime për tregti në vende të ndryshme të Arabisë. Në atë kohë Arabia kishte panairë tregtare gati në çdo qytet kryesor të saj, kështu që s'ka dyshim se Muhamedi (s.a.v.s.) i kishte vizituar.

Pasi u bë Peygamber, filloi të merrej më pak me tregti, edhe pse kohë pas kohe bënte disa marrëveshje tregtare. Përvoja që kishte arritur në tregti e ndihmoi shumë që të tregonte kujdes të madh në sjelljen me njerëzit. Shpesh përmendte popujt dhe fiset që i kishte njohur në udhëtimet e tij, ndërsa njerëzit ishin të mahnitur me diturinë e tij.



Peygamberi (s.a.v.s.) e ka theksuar faktin se ndershmëria dhe sjellja e mirë me klientët është fshehtësia e suksesit në biznes. Ebu Seidi (r.a.) transmeton nga Peygamberi (s.a.v.s.) hadithin vijues: **“Tregtari i sinqertë dhe i besueshëm do të jetë në shoqëri me peygamberët, të sinqertit dhe me dëshmorët.”** (Tirmidhiu)

Xhabir ibn Abdullahu transmeton se Peygamberi (s.a.v.s.) ka thënë: **“Allahu e mëshiroftë njeriun, i cili është zemërgjerë kur blen, kur shet dhe kur kërkon borxhin.”** Peygamberi (s.a.v.s.) ka mësuar shumë për çështjet ekonomike dhe të biznesit dhe ka mbuluar gati çdo aspekt të biznesit e ekonomisë. Ja vetëm disa parime kryesore të biznesit fer sipas islamit:

1. Nuk ka mashtrim as huti, është shënuar që Peygamberi (s.a.v.s.) ka thënë: **“Kur mbahet shitja thuaj: “Nuk ka mashtrim.”** (Buhariu)

D.m.th., duhen treguar mangësitë e mallit nëse ekzistojnë, në të kundërtën kjo do të thotë mashtrim ndaj blerësit.

2. Shitësit duhet t'i largohen betimit të shpeshtë gjatë shitjes së mallit, Ebu Hurejre (r.a.) transmeton që Peygamberi (s.a.v.s.) ka thënë: **“Bëhuni të kujdesshëm me betime të shpeshta të Zotit në tregti, sepse edhe nëse kjo ndihmon në fitim (të përkohshëm), në fund kjo ia merr bekimin e asaj që është fituar.”** (Muttefekun alejhi)

3. Nevojitet pajtimi i ndërsjellë gjatë tregtisë, kjo bazohet në hadithin e Pejgamberit (s.a.v.s.) të cilin e transmeton Abdullah b. Omeri (r.a.): **“Shitësi dhe blerësi mundën të ndërpresin lirisht marrëveshjet, përderisa nuk largohen ose nuk e vërtetojnë shitblerjen.”** (Buhariu)

4. Rreth të qenit i saktë gjatë matjes dhe peshimit, Muhamedi (s.a.v.s.) ka thënë: **“Kur populli mashtron gjatë matjes dhe peshimit, përcaktimi i tyre është prerë për ata.”** (Imam Maliku në El-Muvetta)

Islami i ka përcaktuar kriteret e qarta në çështjen e matjes dhe peshimit, peshoret duhen të jenë të rregulluara në atë mënyrë, që mos të çënojnë mushterion, sepse Pejgamberi (s.a.v.s.) ka theksuar: **“Ju janë besuar dy (matja dhe peshimi) në të cilat janë shkatërruar popujt që kanë jetuar para jush.”** (Tirmidhiu)

5. Muhamedi (s.a.v.s.) ka ndaluar monopolin: **“Kushdo që monopolizon është mëkatar.”** (Ebu Davudi)

Këtu veçanërisht mendohet në grumbullimin e ushqimit dhe mallit tjetër për ta shitur më shtrenjtë gjatë mungesës.

6. Tregtia e lirë, çmimet e mallit nuk duhen të jenë fikse, përveç rasteve kur është në pyetje ndonjë situatë krize ose domosdoshmërie të skajshme.

7. Mbajtja e mallit përkohësisht, me qëllim të ngritjes së çmimit është e ndaluar.

8. Transaksioni i mallit, i cili është haram (p.sh.: çdo gjë që deh) është e ndaluar.

Pejgamberi (s.a.v.s.) ka dhënë këshillë për tërë njerëzit. Ebu Abdullah En-Numan ibn Beshir transmeton se e ka dëgjuar Pejgamberin (s.a.v.s.) duke thënë: **“Çfarë është e lejuar është e qartë, e çfarë është e ndaluar është e qartë. Mes tyre ka gjëra të dyshimta, të cilat shumica e njerëzve nuk i njohin. Kush ruhet nga gjërat e dyshimta, e ka ruajtur pastërtinë e fesë së tij dhe nderin e tij, e kush bie në gjërat e dyshimta, i ngjason bariut, i cili kullot kopenë e tij rreth të ndaluarës në të cilën ajo lehtë bie. Dini që secili bari ka ndalesat e veta, por mbani mend që ndalesat e Zotit në tokën e Tij janë punët që Ai i ka ndaluar.”** (Buahriu)

ROLI I ETIKËS NË BIZNESIN E SOTËM

Duhen përkujtuar biznesmenët, kooperatat e tyre dhe përgjegjësitë që bartin. Në këto çështje sot duhen

patur kujdes:

1. Globalizimi duhet të kuptojë që të gjithë njerëzit janë të përfshirë në një familje, një bashkësi. Të gjitha qeniet njerëzore duhen trajtuar me respekt, në mënyrë të barabartë dhe me drejtësi. Eksploatimi i një grupi njerëzish nga ana e grupit tjetër duhet ndërprerë. Nuk duhet të ketë përçarje mes njerëve për shkak të racës së tyre, ngjyrës, kombësisë, seksit, etj.

2. Resurset e Tokës nuk janë vetëm për ne. Këtë biosferë e ndajmë edhe me llojet tjera, ndaj duhet pasur kujdes që të mos 'i dëmtojmë apo shfarosim.

3. Resurset e Tokës duhen t'i shfrytëzojmë me kujdes të veçantë dhe të mbajmë mend që jemi të obliguar ta lëmë këtë botë në gjendje më të mirë për gjeneratat që vijnë pas nesh.

4. Të gjitha qeniet njerëzore janë një familje, edhe pse ka dallime. Ndryshueshmëria është natyrale dhe e bukur. Duhet të kemi mirëkuptim për religjionet dhe kulturat e njerëzve të tjerë dhe duhet të jemi të vëmendshëm ndaj emocioneve të tyre.

5. Rregulla e artë universale thotë: **“Dëshiro për tjerët atë që dëshiron për vete.”** Duhet të përpiqemi t'i fuqizojmë të tjerët dhe të punojmë në çrrënjosjen e varfërisë, urisë, analfabetizmit, sëmundjeve dhe kushteve johigjienike të jetesës, në mënyrë që njerëzit në botë të jetojnë në paqe dhe në kënaqësi.

6. Të gjitha kompanitë do të duhej të promovojnë sjellje etike në biznes, ashtu si edhe në botë përgjithësisht. Njerëzit që janë aktiv në biznes duhet të jenë gjithmonë të ndershëm, të sinqertë dhe të plotësojnë detyrat e premtimit dhe të obligimit. Duhen eliminuar mashtrimet, keqpërdorimet dhe qarqet e ngushta të konkurrencës.

7. Duhen promovuar më tepër liria politike dhe debatet e hapura.

8. Duhet nxitur dhe përkrahur një sistem arsimor që promovon sistem të hapur. Fëmijët tanë duhen mësuar në perspektiva të shumta dhe njëra duhet të jetë e hapur nga pikëvështrimi tjetër.

Përktheu dhe përshtati:
Prim.dr.med.sc. Ali F. Iljazi

JETA E NATËS

për një mysliman



Ahmet Tashketiren

Koha e natës, e cila fillon me Darkën dhe mbaron me Mëngjesin, përfshin në vetvete tre kohë namazi farz. Nëse përfshijmë këtu edhe kohën e Vitrit e të Tehexhudit, atëherë rezulton se myslimani ka me të vërtetë një jetë nate të ngarkuar me adhurim. Si rrjedhojë, nata është një pjesë kohe e kurdisur sipas **“Orës së myslimanit”**.

Megjithatë, nuk mbaron gjithçka me kaq. Kjo natë ka peshën e saj të rëndësishme, pasi reflekton në adhurim. Është një natë ndryshe në jetën e myslimanit... I Dërguari i Allahut na ka këshilluar që gjumin ta bëjmë sipas një rregulli dhe disipline.

Huzejfe (r.a.) thotë:

Kur i Dërguari i Allahut donte të flinte, ai e vendoste dorën poshtë faqes dhe lutej: - *Zoti im! Me emrin tënd vdes dhe po me emrin tënd ringjallet*, ndërsa kur zgjohej, thoshte: - *Falënderimet i qofshin Allahut, i Cili na ringjall pas vdekjes. Ringjallja është një punë që i takon vetëm Atij.* (Buhari, Muslim)

Gjithashtu, i Dërguari i Allahut na këshillon të bëjmë edhe një lutje për gjumin: Sipas një transmetimi të Ebu Umare Bera bin Azib, i Dërguari i Allahut ka thënë:

- O ti njeri! Kur të shtrihesh bëj këtë lutje:

Zoti im! Ty Të jam dorëzuar. Fytyrën drejt Teje e kam kthyer. Puna të qoftë falë. Ty të besova në punën time. Ty t’u mbështeta, duke të kërkuar pëlqimin Tënd, i frikësuar nga dënimi. Nuk kam mbështetje tjetër veç Teje. I besova librit që zbritte dhe peygamberit që dërgove.

Njeriu që bën një lutje të tillë dhe gjatë po asaj nate ndërron jetë, ai vdes si besimtar, por nëse jo, ngrihet në mëngjes si njeri me shumë mirësi. (Buhari, Muslim)

Nga sa kuptohet prej dy haditheve të mësipërme, i Dërguari i Allahut e ka konceptuar gjumin si vdekje, ndërsa zgjimin si ringjallje. Për rrjedhojë, duhet të jemi të përgatitur shpirtërisht para se të flemë.

Gradat shpirtërore mund t’i radhisim kështu:

Dorëzimi i plotë tek Allahu

Drejtimi tek Allahu

Mbështetja tek Ai

Lidhja me Të

Fitimi i pëlqimit të Tij

Frika ndaj dënimit

Besimi në librin e zbritur dhe në peygamberin e dër-

guar.

Domethënë, i Dërguari i Allahut e sheh të nevojshme që kohën tjetër të natës përveç adhurimit, ta kalojmë duke rikujtuar dhe kuptuar gradat shpirtërore.

I Dërguari i Allahut na ka këshilluar të bëjmë një lutje kur të ngrihemi për tehexhud, lutje e cila ka parime edukative për gradat shpirtërore:

Falënderimet të qofshin Ty o Zot! Ti je Ai që i mban në këmbë ç'ka në qiell dhe në tokë. Falënderimi të përket vetëm Ty o Zoti im! Ti je drita e gjithçka ka në qiell dhe në tokë. Falënderimi të përket Ty o Zoti im! Ti je mbreti i gjithë ç'ka në qiell dhe në tokë. Falënderimet qofshin vetëm për Ty, pasi Ti je e Vërteta, edhe premtimi Yt është i vërtetë. Arritja tek Ti është e vërtetë, fjala Jote është e vërtetë, xheneti është i vërtetë, xhehenemi është i vërtetë, pejgamberët janë të vërtetë, Muhamedi (a.s.) është i vërtetë dhe vetë ora e ditës së gjykimit është një e vërtetë. Tek Ti u dorëzova, o Zoti im! Ty të besova. Tek Ti u mbështeta dhe tek Ti u drejtova. Në mbështetjen Tënde luftova shumë ndaj mosbesimtarëve. Ty të pranova si gjykues. M'i fal gjynahet e mëparshme, ato të mëvonshmet, ato që kam bërë fshehtas dhe ato të dukshmet. S'ka Zot tjetër përveç Teje. Forcën e vërtetë e gjejmë vetëm kur mbështetemi tek Allahu.

Çdo shprehje e kësaj lutjeje është një përzgjedhje e veçantë që ripërtërin lidhjen e njeriut me Zotin, duke zgjeruar horizontin e gjithë njerëzve që besojnë në një Zot.

Namazet... Duatë...

Më pas meditimi...

Një tjetër disiplinë që na bën të kuptojmë shumë ajete të Kuranit...

Është Tasavvufi, një disiplinë e të sotmes që na bën të kuptojmë jetën e natës së të Dërguarit të Allahut...

Kemi të bëjmë me një përqendrim, një fokusim shpirtëror dhe me një rindërtim të individualitetit tonë, pasi errësira na ka mbuluar horizontin, na ka shmangur nga bota rrethuese dhe ndoshta na ka zvogëluar botën tonë deri në një dhomëz, brenda së cilës qëndron një mik i ngushtë i Allahut... Jemi kështu të vetëm deri në ditën e gjykimit...

Meditimi i vdekjes... Një vajtje-ardhje drejt epilogut të vdekjes dhe ahiretit... Një ndjesi, një përjetim... Një lidhje mes kësaj jete dhe tjetrës... Një përjetim i frikës dhe i shpresës. Një përjetim llogaridhëniejeje. Një takim me librin tënd të llogarisë, një përballje me ndjenjën e gjykimit. Konceptimi i takimit me Zotin, sidoqoftë e vërteta e këtij takimi, kalimi në urën e siratit, përcakti-

mi i vendit në rreshtat e ndarë... Një ndjesi e aromës së xhenetit dhe e frikës së xhehenemit... Të kesh etje për të qenë sa më pranë të Dërguarit të Allahut. Të digjesh nga malli që ke për të edhe atje. Të ecësh drejt takimit të madh nën Livaul Hamd... Të ecurit drejt përjetësisë, përgatitja shpirtërisht drejt një udhëtimi të tillë kaq të madh...

Vetëkontrolli... Procesi i ardhjes në jetë dhe konceptimi i dobësisë sonë si njerëz. Konceptim i fuqisë së Allahut në çdo frymëmarrje. Konceptim i tevhidit. Bru-mosja e zemrës me dhikrin "Lailahe illallah". Përmendja e Allahut paralel me ritmet e zemrës. Pasqyrimi i Esmaul Husna në çdo sjellje dhe veprim. Të konceptosh falënderimin. T'u shmangesh gjërave të kësaj bote në çdo fushë të jetës... Të konceptosh arsyet, duke shpëtuar nga të fshehtat. Të kuptosh afrimitetin ndaj Allahut dhe faktin që Ai është bashkë me ne. Të arrish të bëhesh prej të urtëve. Të jesh i gatshëm të dalësh para Tij.

Të jesh pjesë e pandarë e Istigfarit. T'i kalosh netët me pendim dhe lot në sy duke qenë pjesë e bashkësisë së një Pejgamberi, i cili pendohej njëqind herë në ditë. Të futesh në zgavrën e natës dhe të ndash ditën në faqe të bardha e të zeza, të derdhësh qoftë edhe një pikë loti për çdo pikë të zezë të rënë në zemër...

Çdo natë të nisesh drejt rrugëtimit shpirtëror që mbërrin në hallkën e profetit... Një udhëtim përtej trashëgimisë shpirtërore katërmëdhjetë shekullore të Islamit dhe një takim me arkitektët shpirtërorë të kësaj trashëgimie, një krahasim i zemrës me hallkat e tyre shpirtërore, frikë nga një zemër shpirtërore, frikë nga një zemër e sëmurë, rrëqethje nga një zemër e vdekur dhe kërkimi i një formimi shpirtëror që do jetë pjesë e zinxhirit shpirtëror të miqve të ngushtë të Allahut... Të jesh pranë zinxhirit të zemrave të arta dhe ta ndjesh se nuk je i huaj për ta...

I Dërguari i Allahut thotë: **"Syri fle, por zemra jo"**. Kjo është shprehje e një ringjalljeje shpirtërore që as gjumi nuk e shpëton nga jeta, një formim shpirtëror i një karakteri "që Allahu ka edukuar".

Kjo është një veçori "Pejgamberore". Edhe nëse nuk arrijmë të gjejmë këtë ringjallje shpirtërore, mund të bëhemi pjesë e "përkatësisë mëshiruese" duke kthyer gjumin në adhurim, dhe duke kaluar pjesën tjetër të kohës sipas një discipline robërie ndaj Zotit të Madhërueshëm. Pikërisht këtu duhet arritur me "plotësimin e natës".

Ja pra

një jetë e tillë nate

Nuk është një grabitje, nuk është një hakmarrje,

Nuk është humbje kohe,
 Nuk duhet të jenë netë të vjedhura të myslimanit,
 Nuk duhet të jenë netë të grabitura të myslimanit,
 Nata është amanet për myslimanin ...
 Është një pjesë kohe përbërëse e ditës,
 Është një dhunti e Zotit për të përmirësuar pjesën tjetër të ditës,
 Është një lloj depozite që pastron ditën e mëparshme dhe ushqen të sotmen,
 Është një tokë e begatë që do lulëzojë të nesërmet.
 Është një stinë e veçantë.

Në një natë, në të cilën përmendet Allahu, begatitë janë të pafundme. Është një natë në të cilën njeriu lind bashkë me diellin. Në këtë natë rritet dhe ndriçohet individualiteti ynë sikurse dielli, e po ashtu ne lindim sikurse lind edhe dielli.

Nata është koha e rilidhjes me Zotin, e shkëputur ditën
 Është koha e ripërtëritjes së ndjenjave,
 Është koha për t'iu drejtuar Zotit: "Ja pra tek Ti erdha, hapmi dyert ..."

Nata është koha kur do hapen dyert,
 Nata është koha e lutjeve, e thirrjeve, e përlotjes,
 Është koha për t'u ulur në sa e sa sexhde, ruku, për të thënë sa e sa selavate dhe fjalë hyjnore. Është koha e ripërtëritjes. Nata është koha, kur kokrrat e arta të grurit sillen sa andej- këndej të vërtitura nga era...

Të mos përmendësh qoftë edhe një herë emrin e Zotit në kohën e seherit do të thotë të hapësh një plagë të madhe!

Është e dhimbshme të mos bëhesh pjesë e një lutjeje të një miku të ngushtë të Allahut.


Jeta e natës është njohur ndryshe edhe si "përkujtim i natës". Sa i lumtur është ai që ringjall natën ...

E FSHEHTA E NATËS THELLIMI NË ADHURIM DHE MEDITIM

Pas një nate të qetë dhe të lumtur familjare, vjen mëngjesi. Në ajetet kuranore tregohet se ditët janë përpjekje për të përballuar jetesën, ndërsa kohët janë rregulluar për njerëzit.

"E s'ka dyshim se akiviteti i natës është fuqizues dhe fjalë më e qartë. Vërtet, ti gjatë ditës ke angazhim të gjatë (të madh). Po ti, përmende Zotin tënd dhe plotësisht përkushtoj Atij!" (Muzemmil 6-8)

Qetësia e natës është për ata që thellohen në adhuret dhe meditimet e tyre. Bota shpirtërore e robërve të



tillë zgjerohet sa qiejt dhe toka, duke u bërë pjesë e sa e sa rrezatimeve hyjnore dhe ata rriten vetëm me etikën hyjnore.

Dita nuk e jep qetësinë e natës. Është i dukshëm ndikimi i netëve për sa i përket anës sociale dhe etike. Ata që nuk arrijnë të shfrytëzojnë dhuntitë e netëve, bien të lodhur e të përgjumur gjatë ditës dhe nuk arrijnë të marrin begatitë që të dhuron dita. Nuk mund të ketë vlerë dhe dobi dita për ata që nuk ia dijnë vlerën natës. Çdo njeri që ka dëshirë të mbërrijë mëngjesin, është i detyruar ta shfrytëzojë maksimalisht natën, me qëllim që të bëhet pjesë e botës shpirtërore dhe hyjnore.

Ta kuptosh jetën të ndarë në ditë dhe netë është një tjetër aspekt domethënës dhe një mrekulli hyjnore. Nëse një besimtar e kalon natën në gjumë duke mos shfrytëzuar dhuntitë hyjnore dhe shpirtërore, kjo do të thotë se ai është në humbje të madhe. Ne jemi udhëtarë të ahiretit dhe kënaqësitë e botës në të cilën jetojmë na merren nga duart. Nëse jeta e kësaj bote të përkohshme që është si reja e një stine vere jetohej pa ankthin e ahiretit, ajo s'është gjë tjetër, veçse ta kuptosh ditën pa natën.

Këshilla të arta nga Kurani Famëlartë



“E cilat mirësi të Zotit tuaj po i mohoni”

PO KËTO SHPEND QË FLUTUROJNË?

“Allahu ju ka nxjerrë nga barku i nënave tuaja e ju nuk dinit asgjë dhe ju dha të dëgjuarit, të parët dhe zemrat, që të jeni falënderues.”

“A nuk shohin ata, se si shpendët fluturojnë pa mundim në hapësirat qiellore? Ato i mban vetëm Allahu. Kjo, në të vërtetë, është shenjë për popullin që beson.” (Nahl, 78-79)

ATË E MADHËRON ÇDO GJË

“Atë e madhërojnë shtatë qiejt, Toka dhe gjithçka gjendet në to. Dhe nuk ka asgjë që nuk e madhëron Atë, duke e lavdëruar, por ju (o njerëz) nuk e kuptoni madhërimin që i bëjnë ata. Ai, me të vërtetë, është i Butë dhe Falës.” (Isra, 44)

ZOTËRUESI I ARSHIT

“I Gjithëmëshirshmi mbi Fron u ngrit (si i takon Madhërisë së Tij). Atij i përket ç’ka në qiej e ç’ka në Tokë, si dhe gjithçka që gjendet midis tyre e gjithçka që ndodhet nën tokë. Edhe nëse ti flet me zë të lartë, (është e kotë, sepse) Ai, me të vërtetë, i di sekretet edhe më të fshehta. Allahu, nuk ka zot tjetër përveç Tij. Ai ka Emrat më të Bukur.” (Taha, 5-8)

JO PËR TË LUAJTUR

“Ne nuk e kemi krijuar qiellin dhe Tokën e ç’gjendet në mes tyre, për të luajtur (pa qëllim).”

“Sikur të donim argëtim, Ne do ta bënim me gjërat pranë Nesh (si engjëjt, hyrijet etj.), nëse do të bënim diçka të tillë.”

“Por Ne e godasim të pavërtetën, me të vërtetën, e cila e shkatërron atë dhe ajo zhduket dhe, mjerë për ju, për atë që i vishni (Allahut!).”

“Atij i përket gjithkush që gjendet në qiej dhe në Tokë. Ata që janë tek Ai (engjëjt), nuk ngurrojnë për të adhuruar Atë e nuk ndiejnë lodhje, por e lavdërojnë (Atë) natën dhe ditën, paprerë.” (Enbija, 16-20)

“A nuk e dinë mohuesit se qiejt dhe Toka kanë qenë një e tërë? Pastaj Ne e ndamë dhe bëmë nga uji çdo gjë të gjallë! Akoma nuk besojnë?!”

“Ne vendosëm nëpër Tokë male të patundura, që ajo të mos lëkundet bashkë me njerëzit dhe bëmë lugina dhe rrugë për të udhëtuar në to.” (Enbija, 30-31)

SHIHNI VETEN, TOKËN DHE QIELLIN

“Me të vërtetë, Ne e kemi krijuar njeriun prej palcës së baltës, e pastaj, e bëmë atë pikë fare dhe e vumë në një vend të sigurt (mitër).”

“E mandej, pikën e farës e bëmë droçkë gjaku, e pastaj e bëmë copëz mishi pa formë; mandej, me atë mish bëmë eshtrat, pastaj i veshëm eshtrat me mish dhe pastaj e bëmë atë (njeriun) krijesë tjetër (duke i futur shpirtin). Qoftë lartësuar Allahu, Krijuesi më i përsosur!”

“Mandej, pas kësaj ju do të vdisni, pastaj, ju me siguri që do të ringjalleni në Ditën e Kiametit.”

“Ne kemi krijuar mbi ju shtatë qiej dhe nuk jemi të pakujdesshëm ndaj krijesave Tona.”

“Ne zbresim ujë nga qielli me masë të caktuar, pastaj e depozitojmë atë në Tokë. Por, nëse dëshirojmë, Ne jemi në gjendje ta heqim atë tërësisht.”

“Nëpërmjet tij (ujit), Ne bëjmë për ju kopshte hurmash dhe rryshi, ku ka shumë fruta për të ngrënë, si dhe pemën që rritet në malin e Sinait e që u jep vaj dhe mëlmesë, atyre që e hanë.”

“Vërtet, edhe te bagëtitë për ju ka shenja (për të medituuar): ju pini atë që gjendet në barkun e tyre, hani mishin e tyre, nxirrni shumë dobi të tjera dhe udhëtoni me ato, ashtu siç udhëtoni me anije.” (Mu'minum, 12-22)

NJË PYETËSOR

Thuj: “E kujt është Toka dhe gjithçka që gjendet në të, nëse e dini?”

Ata do të thonë: “Të Allahut!” E ti thuaju: “Vallë, a nuk po ia vini veshin?”

Thuj: “Kush është Zoti i shtatë qiejve dhe Zoti i Fronit Madhështor?”

Ata do të thonë: “Allahu!” E ti thuaju: “Vallë, a nuk keni frikë ju?”


Thuj: “Kush është Ai që ka në dorë pushtetin mbi çdo gjë, i Cili mbron, por prej Tij nuk mund të mbrohet askush, nëse e dini?”

Ata thonë: “Allahu.” E ti thuaju: “Atëherë, përse magjepseni?!” (Mu'minum, 84-89)

DËSHTIMI I MOHUESVE

“Ata që nuk besojnë, nuk do t'i mbrojnë asgjë nga dënimi i Allahut, as pasuria e tyre e as fëmijët e tyre. Ata do të jenë banorët e zjarrit (të Xhehenemit), ku do të qëndrojnë përgjithmonë.”

Gjithçka që jobesimtarët shpenzojnë në jetën e kësaj bote, i përngjan erës së akullit, e cila godet të lashtat e ndonjë populli që i ka bërë dëm vetes dhe ua zhduk të lashtat. Allahu nuk u ka bërë padrejtësi atyre, por ata i kanë bërë padrejtësi vetvetes.” (Ali Imran, 116-117)



AI QË DËRGON ERËRAT SI LAJMËTARË

“Dhe është Ai që jua ka bërë natën mbulesë dhe gjumin pushim, kurse ditën jua ka bërë për të lëvizur.”

“Është Ai që i dërgon erërat si lajmëtarë të gëzueshëm para mëshirës së Tij, duke lëshuar prej qiellit ujë të pastër, që nëpërmjet atij të ngjallim vendin e vdekur dhe t'u japim ujë kafshëve dhe shumë njerëzve që Ne i kemi krijuar.”

“Ne e kemi përsëritur (dhuntinë) që të vënë veshin, por shumica e njerëzve kundërshtojnë e janë mosmirënjohës.” (Furkan, 47-50)

AI QË KA KRIJUAR NJERIUN PREJ UJIT

“Është Ai që i ka lënë të lirë dy ujëra, njëri i pijshëm e i ëmbël, kurse tjetri i njelmët e i hidhur, duke ngritur pengesë e kufi të prerë ndërmjet tyre. Është Ai që ka krijuar prej ujit njeriun, e ka vënë në lidhje me fis nga gjaku dhe nga martesat. Zoti yt është i Plotfuqishëm.” (Furkan, 53-54)



PO SIKUR NATA DHE DITA TË ISHIN TË PËRHERSHME

Thuaju (o Muhamed): “Pa mendoni, nëse Allahu jua bën natën të përherëshme deri në Ditën e Kiametit. Cili zot, përveç Tij, do t’jua sillte dritën? Vallë, a nuk dëgjoni?”

Thuaju (o Muhamed): “Pa mendoni, nëse Allahu jua bën ditën të përherëshme deri në Ditën e Kiametit. Cili zot, përveç Tij, do t’jua sillte natën, në të cilën qetësoheni? Vallë, a nuk shihni?”

“Prej mëshirës së Vet, Ai ka bërë për ju natën dhe ditën, që të qetësoheni, të kërkonti nga mirësia e Tij dhe të jeni mirënjohës.” (Kasas, 71-73)

BESIM DHE PROVIM

“Elif, Lâ, Mîm.”

“Vërtet mendojnë njerëzit, se do të lihen të thonë “Ne besojmë”, pa u vënë në provë?!”

“Ne i kemi sprovuar ata që kanë qenë para tyre, në mënyrë që, Allahu të dallojë ata, që thonë të vërtetën dhe ata që gënjejnë.”

“A mos mendojnë ata që bëjnë vepra të këqija, se do t’i shpëtojnë dënimit Tonë?! Sa keq që gjykojnë ata!”

“Kush shpreson takimin e Allahut, ta dijë se Dita e

caktuar nga Ai do të arrijë. Ai dëgjon dhe di gjithçka.”

“Kush përpiqet, përpiqet vetëm për të mirën e vetvetes, se Allahu, në të vërtetë nuk ka nevojë për asgjë.”

“Atyre, që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, me siguri që do t’ua shlyejmë të këqijat dhe do t’u japim shpërblym më të mirë se puna që kanë bërë.” (Ankebut, 1-7)

“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, me siguri do t’i radhisim në mesin e të mirëve. Ka disa njerëz, që thonë: “Ne besojmë Allahun”. Por, kur vuajnë për çështjen e Allahut, e quajnë pëndjekjen prej njeriut njësoj si dënimin e Allahut. Ndërsa, kur u vjen fitorja prej Zotit tënd, ata, me siguri do të thonë: “Ne kemi qenë me ju”. Vallë! A nuk e di Allahu më së miri se ç’ka në zemrat e çdokujt? Sigurisht, Allahu i njeh më mirë ata që kanë besuar dhe hipokritët.” (Ankebut, 9-11)

KA SHENJA

“Ai krijon të gjallën prej së vdekurës, krijon të vdekurën prej së gjallës dhe e gjallëron tokën pas shkretimit të saj. Në të njëjtën mënyrë do të ktheheni edhe ju në jetë.”

“Një prej shenjave të Tij është që Ai ju krijoi prej dheut, pastaj ja, tashmë ju jeni njerëz të shpërndarë në të gjitha anët.”

“Dhe një prej shenjave të Tij është që prej jush krijoi për ju bashkëshortet tuaja, që të qetësoheni pranë tyre, duke vënë ndërmjet jush dashuri dhe mëshirë. Me të vërtetë, në këtë ka shenja, për njerëzit që mendojnë.”

“Ndërmjet shenjave të Tij janë krijimi i qiejve e i Tokës dhe shumëllojshmëria e gjuhëve dhe e ngjyrave (racave) tuaja. Pa dyshim, në këtë ka shenja për ata që dinë.”

“Të tjera shenja të Tij janë gjumi juaj natën e ditën dhe kërkesa e juaj nga dhuntitë e Tij. Vërtet, në këtë ka shenja për njerëzit që dëgjojnë.”

“Gjithashtu, prej shenjave të Tij janë paraqitja e vetëtimës si frikë e shpresë dhe dërgimi i shiut prej qiellit, që nëpërmjet tij të gjallërohet toka pas shkretimit të saj. Sigurisht, në këtë ka shenja për njerëzit që mendojnë.”

“Dhe një prej shenjave të Tij është që qiejt dhe Toka qëndrojnë sipas urdhrin të Tij, pastaj kur t’ju thërrasë Ai, me një të thirrur, ju përnjëherë do të dilni nga toka (të ringjallur).” (Rum, 19-25)

AI QË LËSHON SHIUN

“Pa dyshim, Ne kemi nisur të dërguar para teje te popujt e tyre. Ata u paraqitën me prova të qarta, por popujt i mohuan, prandaj Ne i ndëshkuam keqbërësit. Është detyra Jonë që t’i ndihmojmë besimtarët.”

“Allahu është ai që i dërgon erërat, që ato t’i lëvizin retë, pastaj i shpërndan ato nëpër qiell si të dojë dhe i copëton ato pjesë - pjesë, e ti sheh shiun, si bie prej tyre. Kur ua çon kujt të dojë nga robërit e Vet, atëherë ata gëzohen përnjëherësh, edhe pse, me të vërtetë, para se t’u vinte shiu, ishin të dëshpëruar.”

“Andaj, shikoj gjurmët e mëshirës së Allahut, si e gjallëron tokën pas shkretimit të saj. Vërtet, Ai do t’i ringjallë edhe të vdekurit, se Ai është i Fuqishëm për çdo gjë.” (Rum, 47-50)

ALLAHU DI Ç'KA NË ZEMRAT E NJERËZVE

“Sa për ata që nuk besojnë, ti (o Muhamed), mos u brengos nga mohimi i tyre. Ata do të kthehen te Ne, e Ne do t’i njoftojmë për atë që kanë bërë. Me të vërtetë, Allahu di ç’ka në zemrat e njerëzve.” (Lukman, 23)

SIKUR TË GJITHË DRURËT TË ISHIN PENA

“Sikur të gjithë drurët, që gjenden në Tokë, të ishin pena e deti bojë shkrimi e t’i shtohen atij edhe shtatë dete të tjera, nuk do të shtereshin fjalët e Allahut. Pa dyshim, Allahu është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”

“Krijimi dhe ringjallja e ju të gjithëve është njësoj si krijimi i një njeriu të vetëm. Vërtet, Allahu i dëgjon dhe i sheh të gjitha.” (Lukman, 27-28)

AI KA PËRSOSUR ÇDO GJË QË KA KRIJUAR

“Ai drejton çdo çështje, prej qiellit deri në Tokë, pastaj ato kthehen tek Ai në ditën, gjatësia e së cilës është një mijë vjet sipas llogaritjes suaj.”

“Është Ai që i di gjërat e padukshme dhe të dukshme. Ai është i Plotfuqishmi dhe Mëshirëploti, i Cili ka përsosur çdo gjë që ka krijuar. Ai e ka filluar krijimin e njeriut prej baltës.”

“Pastaj bëri që pasardhësit e tij të krijohen prej një pike të lëngut të shpërfillur, së cilës pastaj i dha trajtë dhe i fryu shpirtin e krijuar prej Tij. Ai ju ka dhënë dëgjimin, shikimin dhe zemrën, por pak prej jush janë mirënjohës.” (Sexhde, 5-9)

KUJTONI DHUNTITË E ALLAHUT

“Lavdërimi qoftë për Allahun, krijuesin e qiejve dhe Tokës, i Cili i ka bërë engjëjt të dërguar me nga dy, tre dhe katër krahë. Ai shton në krijim çfarë të dojë. Allahu, me të vërtetë, është i pushtetshëm për çdo gjë.”

“Begatitë, që Allahu ua jep njerëzve nga mëshira e Tij, nuk mund t’i pengojë askush, ndërsa atë, që Ai e pengon, askush nuk mund ta japë veç Tij; Ai është i Plotfuqishmi dhe i Urti.”

“O njerëz! Kujtoni dhuntinë e Allahut për ju! A ka ndonjë krijues, veç Allahut, i cili ju furnizon nga qielli dhe Toka? S’ka zot tjetër të vërtetë përveç Tij. Atëherë, si po largoheni ju?” (Fatir, 1-3)

ALLAHUT I FRIKËSOHEN VETËM DIJETARËT

“Vallë, a nuk e sheh ti se si Allahu e lëshon ujin prej qiellit dhe nëpërmjet tij krijon fruta llojesh e ngjyrash të ndryshme?! Nëpër male gjenden shtigje të bardha dhe të kuqe, ngjyrash të ndryshme dhe krejtësisht të zeza.”

“Njerëzit, kafshët dhe bagëtitë janë llojesh të ndryshme gjithashtu. Në të vërtetë, nga robërit e Tij, Allahut i frikësohen vetëm dijetarët, (që e dinë se) Allahu është vërtet i Plotfuqishëm dhe Falës.” (Kasas, 71-73)

AI QË PREJ DRURIT TË NJOMË BËRI PËR JU ZJARRIN

“Ai na sjell shembull, duke harruar krijimin e vet dhe thotë: Kush do t’i ngjallë eshtrat kur të kalben?”

Thuaj: “Do t’i ngjallë Ai që i krijoi ato për herë të parë; Ai ka njohuri të plotë për çdo krijesë; Ai që prej drurit të njomë bëri për ju zjarrin, të cilin e përdorni për të nderur”.

“Vallë, a nuk është i Zoti Ai që krijoi qiejt dhe Tokën, t’i rikrijojë ato? Po! Ai është Krijuesi i çdo gjëje dhe i Gjithëdijshmi!”

“Vërtet, urdhri i Tij, kur Ai dëshiron diçka, është që t’i thotë asaj “Bëhu!” - dhe ajo bëhet.”

“Prandaj, qoftë lartësuar Ai, në Dorën e të Cilit është pushteti mbi çdo gjë! Tek Ai do të ktheheni!” (Ja Sin, 78-83)



HAFIZ YMER SHEMSIU

(1895-1945)

Mexhid Yoejsi

Hafiz Ymer Shemsiu ishte hoxhë, mësues, atdhetar, pedagog, poet, shkrimtar, rapsod, këngëtar, valltar...

**“Kur na erdh e para Sërbi
Q’na ngushton ket t’zezë Shqipni
Ka tridhet n’patare ka shti
Ka tridhet po shtje n’patare
Don shqiptarët mej qit fare”**

- Hafiz Ymer Shemsiu

Hafiz Ymer Shemsiu lindi në Prishtinë në vitin 1895, në Mahallën e Muhaxhirëve.

Muhaxhirët ishin të parët e tij, gjyshi Mustafë Sylejmani, me vëllezërit: Ibrahimin, Ismailin dhe Osmanin, të cilën erdhën në Kosovë nga Prokuplja.

Mësimet fillestare i ndoqi në Prishtinë, ndërsa medresenë e vazhdoi në Prishtinë dhe Shkup.

Veprimtarinë arsimore-pedagogjike e filloi në mejtepin e Ferizajit, pranë dajës, Haxhi Pllanës, ku do të mbajë mësim, ndërsa vetë përgatitej për hafiz.

Kur u përgatit për hafiz, pra, kur e mësoi Kuranin e shenjtë përmendësh, atëherë, titullin e nderuar Hafiz e mbrojti publikisht në Xhaminë e Boshnjakëve, para komisionit përkatës.

Gjatë Luftës së Parë Botërore, (1915-1918), në kohën e Austrisë, siç thotë populli, u hapën në Kosovë shkollat shqipe...

Me ndihmën e Hasan Prishtinës, në vitin 1915, Hafiz Ymer Shemsiu e hapi një shkollë shqipe, në katin e Sazli, në rrethin e Ferizajit. Ferizaji ishte zonë e pushtuar nga bullgarët, të cilët e mbyllën pa u bërë muaji, kurse mësuesin, hoxhën, Hafiz Ymer Shemsium e lidhën me zinxhirë dhe e dërguan, ashtu të lidhur, në burgun e Ferizajit...

Burgu i Ferizajit nuk e dobësoi hoxhën, por e forcoi, këtë e dëshmon veprimtaria e tij në vazhdimësi, për fe e atdhe...

Hafiz Ymer Shemsiu, që nga viti 1920, ishte një veprimtar i devotshëm në Lëvizjet kryesore çlirimtare-shqiptare, nëpër Kosovë, disa prej të cilave janë edhe këto:

Komiteti për Çlirimin Kombëtar të Kosovës.

Veprimtar në Xhemiet (Bashkimi), e drejtuar nga atdhetari Ferhat Bej Draga.

Bashkëpunonte me Lëvizjen Kaçake Kombëtare.

Në Xhaminë e Talinocit themeloi Komitetin e Komitetit të Kosovës...

Hafiz Ymer Shemsiu, përveç veprimtarisë atdhetare-kombëtare-çlirimtare, është marrë edhe me veprimtari arsimore, pedagogjike, kulturore...

Në mejtepin e tij, Hafiz Ymeri, përveç mësimëve fetare, ua mësonte nxënësve të tij, në fshehtësi, shkrimleximin shqip, pastaj edhe njohuri të tjera si në histori, gjeografi, matematikë, fizikë, kështu, përgatiti kuadër të aftë edhe për administratë...

Hafiz Ymer Shemsiu, përveç veprimtarisë atdhetare-çlirimtare-kombëtare, arsimore-pedagogjike-kulturore, është marrë edhe me krijimtari letrare, duke shkruar ilahi, poezi, me përmbajta fetare dhe

atdhetare...

Poeti i ndërgjegjes fetare e kombëtare, Hafiz Ymer Shemsiu ka shkruar shumë ilahi, poezi, të cilat janë në frymën e vargut popullor lirik dhe epiko-historik.

Në një ilahi, kushtuar Muhamedit (a.s.) që ka 48 vargje, ndër të tjera, shkruan:

**“Hallall bomna ej ymmet
Nasihah se kom vasijet
Shoqi shoqin mos me dhan
Si n’idhnim qashtu n’gzim
Se n’birlik ka gjallnim...”**

Në një ilahi, kushtuar Namazit, që ka 50 vargje, ndër të tjera, shkruan:

**“Mos e le, fale namazin,
bile synetin, edhe farzin,
mos ta idhnojm Allahin...”**

Në poezinë e Hafiz Ymer Shemsium, pasqyrohen në mënyrën më besnike krimet e forcave armike, krimet barbare ndaj popullsisë shqiptare:

**“Kur na erdh e para Serbi
Q’na ngushton ket t’zezë Shqipni
Ka tridhet n’patare ka shti
Ka tridhet po shtje n’patare
Don shqiptarët mej qit fare...”**

**“Nam po bojn o n’shqiptar zi
Po presin gra po presin fmi
Edhe me zjarm poj djegun n’shpi
Fmin e foshnje ngulin n’singji...”**

Hafiz Ymer Shemsiu, gjatë Luftës së Dytë Botërore, ishte kundërshtar i forcave partizane-komuniste, ndërsa ishte përkrahës i forcave kombëtare-nacionaliste...

Kur forcat partizane-komuniste-çetnike e morën pushtetin, atëherë, menjëherë, Hafiz Ymerin e izoluan. Në fillim të muajit maj, 1945, ashtu, në izolim, Hafiz Ymer Shemsiu, ndërroi jetë në mjerim...

Dobitë e të medituarit mbi vdekjen

Mr. Abdulkadër Durguti

Në Islam, qëllimi i meditimit mbi vdekjen dhe jetën pas vdekjes nuk është që ta mbushë me hidhërim e pesimizëm jetën e besimtarit, por e kundërta: për t'ia rregulluar dhe sistemuar jetën e kësaj bote dhe për t'ia mundësuar shijimin e lumturisë së përjetshme në jetën e ahiretit. Ashtu si dimri nuk e frikëson njeriun që përgatitet për t'u përballur me të, ashtu edhe vdekja nuk e frikëson atë që përgatitet për vdekjen.¹

Jeta e atij njeriu që largohet nga të përkujtuarit dhe të medituarit e vdekjes është e rreme dhe mashtruese. Vdekja është fenomeni më real që njeriu mund të ketë parë me sy. Prandaj është absurde përpjekja për t'i ikur asaj ose për të mbyllur sytë përballë saj. Meditimi dhe përkujtimi i vdekjes në kohë të përshtatshme e vetëdijëson njeriun në lidhje me përgatitjen që ai duhet të bëjë për jetën e ahiretit, ndërsa anashkalimi i këtij obligimi jo vetëm që e bën të frikësohet nga vdekja, por edhe të ndjejë frikë edhe nga jeta e pasvdekjes.

Meditimi mbi vdekjen e vendos njeriun në një sistem të atillë jete, brenda të cilit ai të mund të kontribuojë në këtë botë që të mbledhë fryte për jetën e pasvdekjes. Përkujtimi dhe meditimi i vdekjes nuk e shpie njeriun drejt

të qëndruarit këmbëkryq, drejt veçimit prej të tjerëve dhe urrejtjes për jetën paraprake. Përkundrazi, e nxit njeriun që të punojë sa më shumë në lidhje me përmirësimin e gabimeve të kaluara, me qëllim që të përgatitet në mënyrë të vullnetshme për jetën pas vdekjes, për daljen para Allahut. Është një mjet ekuilibrues ndërmjet kësaj jete dhe tjetrës, sepse si do të mund të përgatitej për vdekjen ai që as nuk e përkujton dhe as nuk mendon fare për të?

Natyra e njeriut është e tillë sa ai asnjëherë nuk dëshiron që ta kujtojë veten të vdekur. Vazhdimisht e sheh veten duke varrosur të tjerët. Vazhdimisht e sheh veten nën tabut dhe mbi varre, e asnjëherë në tabut dhe në varre, sepse ai është përballë disa herë me të dhe shpreson se kështu do të vazhdojë edhe në të ardhmen. Ai vazhdimisht i sheh të vdekurit, por asnjëherë nuk mendon se edhe ai vetë do të vdesë një ditë. Një sahab e pati pyetur Pejgamberin (a.s.): “Kush quhet njeri i mençur, o i dërguari i Allahut?” Ai i qe përgjigjur: “Ai që mendon shumë për vdekjen dhe që preokupohet shumë për t'u përgatitur për të!”² Njeriu i cili nuk mediton për largimin nga kjo botë dhe nuk arrin ta kuptojë këtë gjë, do të thotë se është indiferent, i painteresuar dhe i pashqetësuar, e për më tepër i painformuar për

1. Süleyman Toprak, *Ölümden Sonraki Hayat*, f. 70.

2. İbn Maxhe, *Zuhd*, 31.

ekzistencën e botës tjetër. Ndërsa meditimi mbi vdekjen është pretekst për t'u përballuar me të vërtetën dhe botën reale dhe për ta arritur këtë duhen grisur më parë perdet e indiferentizmit.

Pa dyshim se meditimi mbi vdekjen bart në vete shumë dobi dhe mirësi: Njeriu pendohet në mënyrë të sinqertë për mëkatet dhe gjynahet e mëparshme. Nga frika e vdekjes njeriu u shmaget teprimeve të ndryshme, largohet nga produktet e ndaluara duke e ditur se do të përgjigjet për përdorimin e tyre, largohet nga shkëlja e të drejtave të njeriut, i mundësohet kontrolli ndaj vetes etj.

Meditimi mbi vdekjen është mjet për t'u larguar nga vetet e liga. Besimtari mediton mbi vdekjen me qëllim që të marrë masat e duhura për përgatitje. Ky meditim i mundëson atij forcimin e ndjenjave dhe të emocioneve. Një prej dobive të të përkujtuarit të vdekjes është pa dyshim edhe largimi nga përfytyrimet mashtruese të dynjasë dhe nga pamjet iluzive. Në këtë mënyrë njeriu krijon vetëbesim për nevojën e pendimit të sinqertë, adhurimit ndaj Krijuesit suprem dhe e mbron atë nga ambiciet e pasionet e kësaj bote.

Pa shih varrezat! A nuk janë adresa të llojllojshme njerëzish? Pa marrë parasysh se në çfarë kushtesh kanë jetuar ato njerëz, në pallate të shkëlqyeshme e gjigante apo në shtëpi pa strehë, të gjithë kanë përfunduar në varreza bashkë me të gjitha pasionet dhe lakmitë e tyre. Prandaj Pejgamberi (a.s.) thotë: *"Dhe kujtojeni shpesh vdekjen, atë që i pret si me thikë të gjitha kënaqësitë e kësaj bote!"*³

Niveli i meditimit mbi vdekjen tek njerëzit ndahet në disa grupe:

1. Të zhyturit plotësisht në jetën e dynjasë. Këta nuk kujtojnë vdekjen, por kujtojnë vetëm ato gjëra që nuk i kanë realizuar gjatë jetës dhe dëshpërohen shumë për këtë. Përveç dëmit, ky dëshpërim nuk ka as edhe një dobi për ta.⁴

2. Të penduarit nga mëkatet dhe heqja dorë prej tyre. Tek disa njerëz meditimi mbi vdekjen bën të lindë frika dhe një lloj ngacmimi i brendshëm. Frika krijohet duke u nisur nga fakti se si do t'i dalin Allahut përpara me gjithë ato gjynahe. Kushtu ato shtojnë kujdesin në jetën e tyre. Ndërkohë kjo gjë i afron ata me Allahun.⁵

3. Meditimi i atyre që janë të dashuruar me Allahun. Ata vazhdimisht meditojnë mbi vdekjen, sepse për ta vdekja është takim me Allahun. Të dashuruarit asnjëherë nuk e harrojnë takimin e tyre me Atë që dashurojnë.

Psikologjinë e këtyre njerëzve, Allahu (xh.sh.) e përshkruan kështu në Kuran:

3. Tirmidhi, Zuhd, 4; Nesai, Xhenaiz, 3.

4. Gazali, *Nizamu 'l-Amel*, f. 128.

5. Gazali, *Ihja-i Ulumid-din* IV, 413.

"O Zoti Ynë, cilindo që Ti e fut në zjarr, Ti e ke poshtëruar atë. Dhe për mohuesit nuk do të ketë kurrfarë ndihmuesi."

"O Zoti Ynë! Ne dëgjuam një thirrës që na ftonte në besim: "Besoni Zotin tuaj!" Dhe kështu besuam. O Zoti Ynë! Na i fal gjynahet tona, na i shlyej gabimet dhe na bëj që të vdesim me të mirët!"

"O Zoti Ynë! Na e jep shpërblimin që na ke premtuar nëpërmjet të dërguarve të Tu dhe mos na poshtëro në Ditën e Kia-metit! Se Ti, me të vërtetë, nuk e shkel premtimin e dhënë!"

"Dhe Zoti iu përgjigj lutjes së tyre: "Unë nuk do t'ia humb mundin askujt nga ju që ka bërë vepra, qoftë mashkull apo femër. Ju jeni njëllor (në shpërblim). Atyre që u shpërngulën, u dëbuan nga vatrata e tyre, u munduan në rrugën Time, luftuan dhe u vranë, Unë do t'ua mbuloj veprat e këqija dhe do t'i shpie në kopshte nëpër të cilat rrjedhin lumenj, si shpërblim nga Allahu. Shpërblimi më i mirë është tek Allahu."⁶

Mes këshillave që Aliut (r.a.) i ka lënë të birit, Hasanit (r.a.) ishte edhe meditimi mbi vdekjen. Ai shprehej: *"O bir, kujtoje seriozisht vdekjen dhe edukoje zemrën me anë të përkujtimit të vdekjes. Mos harro se në fund të fundit, çdo gjë do të asgjësohet, ndaj herë pas here kujtoja zemrës rreziqet e mundshme të kësaj bote."*

Mënyrat efektive e të përkujtuarit të vdekjes:

1. Gjatë vizitës në varreza, njeriu e përkujton vdekjen. Kjo është arsyeja se pse Pejgamberi (a.s.) këshillon që të vizitohen varrezat. Vizita në varreza i zbut zemrat e ngurta. Pejgamberi (a.s.) thotë: *Vizitoni varrezat, sepse ato jua kujtojnë vdekjen.*⁷

2. Vizita që u bëjmë të sëmurëve është një metodë e përshtatshme për kujtimin e vdekjes. Pejgamberi (a.s.) thotë: *Vizitoni të sëmurët dhe përcillni të vdekurit, sepse do t'ua kujtojnë ahiretin.*⁸

3. Falja e namazit të xhenazes, përveçse është obligim i besimtarit ndaj besimtarit tjetër ka edhe shpërblime të mëdha, është edukuese dhe përkujtuese e vdekjes dhe e jetës pas saj.

4. Me vdekjen e miqve, të shokëve apo të familjarëve, vendosja e vetvetes në pozitën e tyre. Të menduarit e vetvetes në pozitën e të vdekurit është metoda më efektive për kujtimin e vdekjes. Në këtë mënyrë besimtarit i ngjallet një frikë apo një ngacmim në zemër, që e nxit për t'u larguar nga ambiciet e dynjasë.

5. Një prej metodave efektive të të përkujtuarit të vdekjes është gjithashtu edhe vëzhgimi i shenjave të pleqërisë tek vetvetja dhe tek të tjerët.

6. Ali Imran, 3/192-195.

7. Muslim 3/65.

8. Ahmed 3/48.



Një Ajet

Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirplotit!

“Dhe në një pjesë të natës zgjohu me të (me Kuranin - namazin), është e sigurt se Zoti yt do të të ngre në një vend të lavdishëm.” (Isra 79)

Në ajetin e mësipërm, Pejgamberit i kërkohet të zgjohet nga gjumi në një pjesë të natës dhe të falë namaz. Ky lloj namazi është quajtur namazi i Tehexhudit nisur nga kuptimi i kësaj fjale në gjuhën arabe. Pejgamberi (a.s.) u ka tërhequr vëmendjen sahabeve, të cilët rrinin tërë natën zgjuar për të falur namaz, duke u thënë se është një lodhje e madhe për trupin, prandaj nuk e ka parë të arsyeshme të merren tërë natën me adhurime. Nga sa kuptohet nga ajeti në fjalë, namazi i Tehexhudit është një adhurim që i përket vetëm të Dërguarit të Allahut. Ka nga dijetarët që mendojnë se ky adhurim është mendup dhe nafile, pra një virtyt më shumë për të Dërguarin e Allahut. Arsyeja e një mendimi të tillë është se Pejgamberit (a.s.) i janë falur të gjitha gjynahet. Natyrisht që një gjë e tillë nuk bëhet fjalë për bashkësinë e tij. Namazi i natës është një falje e gjynaheve të tyre.

Të tjerë dijetarë kanë theksuar se namazi i natës i quajtur Tehexhud është një farz më shumë për Pejgamberin (a.s.) i shtuar mbi pesë kohët e ditës dhe ky farz i posaçëm është për të përfocuar edhe më shumë prioritetin e tij mbi bashkësinë Islame.

Nisur nga vijimi i ajetit “është e sigurt se Zoti yt do të të ngre në një vend të lavdishëm”, vendi i lavdishëm është vendi ku bëhen falënderimet dhe mirësitë. Ky post i lartë i përket Pejgamberit (a.s.). Në ditën e gjykimit çdo bashkësi, apo e thënë ndryshe i gjithë njerëzimi do kërkojë të shpëtojë sa më shpejt nga ajo pritje e frikshme nëpërmjet ndërmjetësimit të Profetit dhe me të shpëtuar nga kjo pritje do ta falënderojë. Makami Mahmud mund të quhet ndryshe edhe makami shefaat.

Një Hadith



Transmetohet nga Aishja radijallahu anhe se

Resulullahu sallallahu alejhi ve sellem

ngrihet natën dhe falte namaz deri në enjtjen e këmbëve. Nisur nga kjo e pyeta:

“O i Dërguari i Allahut! Pse e mundon veten kaq shumë ndërkohë që Ty të janë falur të gjitha gjynahet?”

I dërguari i Allahut iu përgjigj:

“Pse të mos jem një rob falënderues?” (Buhari, Muslim)

Shpjegime

Pejgamberi (a.s.) ngrihet natën dhe adhuronte Allahun deri sa këmbët i enjtëshin ndërkohë që Aishja shqetësohej shumë për këtë. Ajo mendonte se Ai bënte adhurim me frikën e gjynaheve apo me dëshirën që të falej. Prandaj ia kujtoi edhe shprehjen që zë vend në hadith “Allahu ti ka falur të gjitha gjynahet”. Prandaj ajo e pyet se përderisa Allahu të ka falur të gjitha gjynahet që ke bërë dhe ato që do bësh përse e mundon veten kaq shumë? Natyrisht i Dërguari i Allahut s’mund të rrinte në heshtje. Ai iu përgjigj se po bënte vetëm detyrën e një robi për ta falënderuar me sa kishte mundësi Allahun për mirësinë e madhe të faljes.

Sipas Aishes, i dërguari i Allahut për një kohë të gjatë ka qëndruar me orë të tëra në këmbë duke bërë adhurim dhe këtë e shijonte me një kënaqësi tepër të madhe, por me të shtuar në pesë nisi të falte namaz i ulur. Rrinte një kohë të gjatë ulur dhe lutej, kur donte të binte në sexhde ngrihet në këmbë, pas një farë kohe ulej në ruku dhe në sexhde sërish.

Mësimet që nxjerrim nga hadithi:

1. I Dërguari i Allahut, natën bënte shumë adhurim që ta falënderonte Zotin si rob që ishte.
2. Falënderimi për mirësinë është një detyrë njerëzore.
3. Ka shumë rrugë për ta falënderuar Allahun për mirësitë e dhëna. Kjo mund të shprehet edhe me gjuhë ashtu sikurse mund të bëhet edhe me adhurim natën siç vepronte vetë Pejgamberi (a.s.).
4. Nëpërmjet kësaj, Pejgamberi (a.s.) tregonte se kjo është mënyra më e mirë për të shprehur robërinë ndaj Allahut.

HAZRETI EBU BEKRI (R.A.)

Periodha më e veçantë në historinë e njerëzimit, përsa i takon virtytit, drejtësisë, altruizmit dhe moralit të lartë është në mënyrë të padiskutueshme periodha e brezit të ndritur, sepse në atë periudhë jetoi Hazreti Muhamed Mustafaja, qëllimi i krijimit të çdo gjëje. Kjo periudhë u formësua nga ngrohtësia e tij shpirtërore. Kjo është një periudhë e mbushur me atmosferë të thellë meditimi dhe dëshmimi, në të cilën njerëzit do të njohin Allahun e Lartmadhëruar dhe profetin e Tij, Muhamedin (s.a.v.s.).

Gjatë asaj periudhe të ndritur, shoqërisë iu bë e mundur që, nga një injorancë e thellë të lartësohej aq shumë sa të ngihej në majat e qytetërit të viryeteve, duke arritur deri në marifetullah, pra deri në njohjen e Zotit me Zemër. Individët e kësaj shoqërie janë emërtuar **“sahabei kiram”**, që do të thotë “besnikët”, njerëzit me shumë vlera, miqtë e nderuar dhe ndjekësit shpirtërorë të Hazreti Pejgamberit në çdo çështje.

Prej këtu mund të themi se brezi i vetëm që perceptoi në formën më të plotë fjalët, veprimet dhe gjendjet e të Dërguarit të Allahut, si dhe që na përcolli çdo shenjë të nurtë të rrugës së Tij, është brezi i artë i sahabeve.

HULEFA-I RASHIDIN

Në krye të sahabeve që ndërtuan personalitetin e tyre duke u mburrur me mëshirën shpirtërore, ndjeshmëritë e holla dhe parimet e të Dërguarit të Allahut, janë padyshim **Hulefai Rashidinët**, pra katër khalifët e mëdhenj. Kjo, sepse ata u lidhën kokë e këmbë me një dashuri të pashembullt me të Dërguarin e Allahut. Ashtu si një pikë uji shkrihet në tërësinë e oqeanit, edhe ata u shkrinë në gjendjet dhe në moralin e të Dërguarit të Allahut. Kështu, nëpërmjet dashurisë ndaj të Dërguarit të Allahut, bota e tyre shpirtërore u bë vendi ku manifestohet dashuria hyjnore, si dhe saraji i mrekullueshëm i thesareve të marifetullahut. Fjalët dhe gjendjet e tyre plot kuptim u shndërruan në një korpus urtësie dhe sekretit, duke u bërë për të gjithë njerëzimin buri mi më i mirë i këshillës dhe modelit-shembull që duhet ndjekur.

Për të shprehur rëndësinë e periudhës së Hulefai Rashidinëve, Pejgamberi (s.a.v.s.), ka thënë:

“(Pas meje) Khilafeti i nubuvvetit do të zgjasë tridhjetë vjet...”¹

Kështu, Ai la të kuptohej se në kohë të caktuara sistemi administrativ do të funksiononte në mënyrë të rregullt, por që do të kishte edhe kohë të atilla kur ky sistem do të dobësohej e nuk do të funksiononte si duhet.

1. Ebu Davud, Sunnet, 8; Ahmed, V, 50, 220, 221.

Sa kam pasur dobi nga pasuria e Ebu Bekrit nuk kam pasur dobi nga pasuria e askujt tjetër...

Gjatë viteve të para të kësaj periudhe harmonia dhe qetësia e kohëve të arta nuk u ndërpre, por vazhduan lulëzimin e tyre. Faktori kryesor që ndikoi pozitivisht në lidhje me këtë, ishte largpamësia dhe aftësia e Ebu Bekrit (r.a.).

HAZRETI EBU BEKIR (R.A.)

I zgjedhuri i parë si khalife, **Hazreti Ebu Bekri**, në periudhën e lumturisë² ishte shkrirë i tëri në besnikëri, në dorëzim të plotë dhe në dashuri tek i Dërguari i Allahut. Ai e ka përjetuar lidhjen shpirtërore me Resulin e Zotit në nivelin më të lartë. Ai pothuajse ishte njësuar me Të. Në lidhje me Ebu Bekrin, Profeti Muhamed (s.a.v.s.) ka thënë:

*“Çdo gjë që kam në zemrën time ia kam dhënë Ebu Bekrit.”*³ Duhet thënë se kjo gjendje njësimi nuk ka qenë pa asnjë kosto, por është arritur në sajë të shumë sakrificave dhe vuajtjeve. Tekem Bramja, për hir të dashurisë njeriu është gati të paguajë koston më të lartë (flijimin më të madh). Kostoja më e lartë që duhet paguar në këtë botë të përkohshme është kostoja e dashurisë ndaj Allahut të Lartmadhëruar.

Hazreti Ebu Bekri jetoi me dëshirën dhe përpjekjen e madhe për të qenë i gatshëm të flijonte çdo gjë për t'u plotësuar në kënaqësinë e miqësisë me të Dërguarin e Allahut. Në Hixhret pati nderin të jetë bashkudhëtar me të Dërguarin e Allahut. Në këtë udhëtim të rëndësishëm ku u përjetuan shumë manifestime të mistershme hyjnore, në shpellën Sevr, gjatë një intervali kohe prej tre ditësh, nga gjoksi i Pejgamberit (a.s.) rrezatuan shumë urtësi dhe mistere. Hazreti Ebu Bekri u bë meritues i nderit dhe virtytit të të qenit bashkë me Hazreti

Pejgamberin. Në atë vend, i cili u bë shkollë e kredhjes në misteret hyjnore dhe në zhvillimin (progresin) shpirtëror, ai u nderua me të qenit **“i dyti i të dyve”**, ku i treti i tyre ishte vetë Allahu i Lartmadhëruar. Ajo Qenie e Përndritur i tha shokut të tij: **“Mos u mërzit, Allahu është me ne!..”** (et-Tevbe, 40), duke ndërkallur tek ai **“të fshehtën e maijjetit”**, pra të vërtetën e të qenit vazhdimisht me Allahun e Lartmadhëruar.

Këto gjendje, mjeshtërit shpirtërorë i kanë vlerësuar si fillesën e instruktimit të dhikrit khafi⁴, por gjithashtu edhe si shfaqjet e para në arritjen e qetësisë shpirtërore nëpërmjet përmendjes së Allahut të Lartmadhëruar. Vendi i parë ku u shfaq në skenën e historisë islame e vërteta e transmetimit të të vërtetave nga zemra në zemër, është shpella Sevr, ndërsa fatlumi i parë që u prezantua me të është Hazreti Ebu Bekri (r.a.). Prandaj, pas të Dërguarit të Allahut, Hazreti Siddiku është pranuar si hallka e parë e **Vargut të Artë** që do të vazhdojë deri në kiamet.

Kjo do të thotë se qëllimi i të gjitha rrugëtimit të shenjta arrihet në raport me dashurinë ndaj Allahut dhe Resultit të Tij. Tekefundit, kushti i dashurisë dhe treguesi i ashtut është të duash ato gjëra që do personi që ti dashuron.

Pra, njësimi me objektin tënd të dashurisë dhe shkrirja e gjendjeve të dy të dashuruarve është një hap shumë i rëndësishëm i rrugëtimit në fjalë. Jeta e Ebu Bekrit është e mbushur me manifestime të tilla.


Ebu Bekri është pjesë imja, dhe unë gjithashtu jam pjesë e tij.

Ai kapërceu vetveten (egon e tij) duke çuar një jetë plot me zjarr dashurie hyjnore. Ai gjeti tek i Dër-

2. Kuptojmë kohën kur ishte në jetë Pejgamberi (a.s.).

3. Shih Axhluni, Keshful-Hafa, v. 2, fq. 419.

4. Që bëhet në mënyrë të fshehtë, të qetë.



guari i Allahut burimin e vetëm të jetës. Ai përjetonte emocione të forta shpirtërore (gjendje transi dhe dalldie) sa herë që takohej me të Dërguarin e Allahut, apo kur ata të dy bisedonin së bashku. Kur ishte në praninë e profetit, në vend që dashuria ndaj tij t'i qetësohej, ndodhte krejt e kundërta: zjarri i dashurisë për Profetin i shtojte edhe më shumë.

Një ditë Hazreti Muhamedi (s.a.v.s.), tha:

“Sa kam pasur dobi nga pasuria e Ebu Bekrit nuk kam pasur dobi nga pasuria e askujt tjetër..”

Pasi dëgjoi këto fjalë komplimentuese, Hazreti Ebu Bekri filloi të qante dhe tha:

“A nuk jemi unë dhe pasuria ime vetëm për Ty o Resulullah?!” (Ibni Maxe, Fedailu As'habin-Nebi, 11). Me këto fjalë ai donte të thoshte se vetveten dhe çdo gjë të tijën ia kishte kushtuar Hazreti Pejgamberit, tek i cili ishte shkrirë krejtësisht.

Gjithashtu, Pejgamberi (s.a.v.s.) është shprehur:

*“Ebu Bekri është pjesë e imja, dhe unë jam pjesë e tij. Ebu Bekri është vëllai im në dynja dhe në ahiret.”*⁵ Nga ky hadith kuptohet qartë afria e të Dërguarit të Allahut me Hazreti Ebu Bekrin në planin shpirtëror, dhe gjithashtu vihen re qartazi marrëdhëniet e tyre ndjesore. (Nga ky hadith kuptohet qartë uniteti i të Dërguarit të Allahut me Hazreti Ebu Bekrin në planin shpirtëror, por gjithashtu edhe marrëdhëniet e tyre në planin emocional.)

MIKU MË I NGUSHTË I FSHEHTËSIVE PROFETIKE

Zemra e Ebu Bekrit (r.a.),



ishite bërë pasqyra më e kristaltë që reflektonte botën shpirtërore të Resulullahut (s.a.v.s.). Kështu, ai ishte bërë modeli shembullor që personifikonte shkrirjen shpirtërore tek Hazreti Pejgamberi. Në sajë të kësaj gjendjeje përhumbjeje, çdo gjë që lidhej me Hazreti Muhamedin (s.a.v.s.), fitonte kuptim shumë të thellë në zemrën e tij. Ebu Bekri (r.a.), arriti të bëhej njëri nga sahabet më të aftë në perceptimin e ajeteve të Allahut, fjalëve të Resulullahut, si dhe qenien i pranishëm në ecurinë e ngjarjeve të ndryshme. Shumë urtësi profetike, që të tjerët nuk arrinin t'i kuptonin, ai i kapte në mënyrë intuitive, falë largpamësisë dhe dhuntive të tij perceptuese. Kur në haxhin e lamtumirës u shpall ajeti: **“...Sot jua përsosa fenë tuaj, e plotësova dhuntinë Time ndaj jush dhe zgjedha që Islami të jetë feja juaj...”** (el-Maide, 3), të gjithë u gëzuan për plotësimin e fesë, por Ebu Bekri arriti të kuptojë në mënyrë të natyrshme se tashmë që feja ishte kompletuar në aspektin e shpalljes, Allahu i Lartmadhëruar do ta ftonte së shpejti të Dashurinë e Tij, Resulullahun (s.a.v.s.), në botën e përtejme. Në atë çast, ndërsa të tjerët lumturroheshin, atij iu mbush gjoksi me hidhërimin që shkaktohet nga ndarja e dy të dashuruarve.⁶

Një tjetër shembull që dëshmon vizionin e hollë të Ebu Bekrit është edhe ky që vijon:

Në ditët e fundit të jetës së Tij, për arsye të përkeqësimit të sëmundjes, Hazreti Pejgamberi nuk arriti të dilte në mesxhid. Ai emëroi si imam të të gjitha namazeve që do të faleshin me xhematë Hazreti Ebu Bekrin (r.a.). Një ditë Ai u ndie më mirë me shëndet dhe doli në mesxhid. Pasi u dha disa këshilla sahabeve, tha:

“Allahu Famëmadh (i Lartmadhëruar), robin e tij e la

⁵ S. Tirmidhi, Menakih, 20

⁶ Shih Elmalili, III, 1569

**Çdonjëri që na ka bërë mirësi,
ia kemi shlyer atij në atë masë
ose më shumë. Këtu bën
përrjashtim vetëm Ebu Bekri!..
Ai na ka bërë aq shumë mirësi,
saqë vetëm Allahu mund t'ia
shpërblejë në Ahiret.**

të lirë në përzgjedhjen e kësaj bote dhe mirësive qiellore që gjenden pranë Tij. Ai rob zgjodhi mirësitë qiellore pranë të Lartmadhërueshmit..”

Pasi dëgjoi këto fjalë, Hazreti Ebu ndjeu hidhërim në zemrën e tij të butë, teksa në sy iu vërejtën disa pika të ngrohta lotësh. Ai e ndjeu se në një farë mënyre Hazreti Pejgamberi (s.a.v.s.), po thoshte fjalët e lamtumirës, sepse ai ishte miku më i ngushtë i fshehtësive profetike. Ai filloi të rënkonte ashtu si një nejt (fyell) që rënkon nga ndarja. Ndërsa qante me dënësë, ai tha:

“Nëna dhe babai im të qofshin falë o Resulullah! Ne jemi gati të flijojmë baballarët, nënat, jetën, pasurinë dhe fëmijët tanë vetëm për ty, o i Dashuri i Allahut!..” (Ahmed, III, 91)

Kur Hazreti Pejgamberi foli, asnjë prej atyre që ishin të pranishëm nuk e kuptoi thellësinë emocionale dhe faktin që Profeti po bëhej gati të ndahej nga kjo botë. Madje shumë nga sahabet nuk arritën t’i jepnin ndonjë kuptim të qarave të Ebu Bekrit. Të çuditur, ata i thoshin njëri-tjetrit:

“Me të vërtetë është e habitshme, se pse qan ky njeri në moshë të thyer, ndërkohë që Resulullahu (s.a.v.s.) po flet në lidhje me një vepërmirë që kërkon të bashkohet me Zotin e tij!..” (Buhari, Salat, 80)

Përveç Ebu Bekrit, i cili e kish kapur mesazhin e thënies së Profetit në mënyrë intuitive, askush nga të pranishmit nuk kish arritur ta kuptonte se në këtë rast vepërmiri ishte vetë i Dashuri i Allahut (s.a.v.s.). Ndërkohë, për të qetësuar zemrën e mërzitur të Ebu Bekrit dhe për të shpalosur vlerat e tij të larta para sahabeve, Resulullahu (s.a.v.s.) u shpreh:

“Çdonjëri që na ka bërë mirësi, ia kemi shlyer atij në

atë masë ose më shumë. Këtu bën përrjashtim vetëm Ebu Bekri!.. Ai na ka bërë aq shumë mirësi, saqë vetëm Allahu mund t’ia shpërblejë në Ahiret.

Ebu Bekri është treguar më bujari ndaj meje, qoftë me bisedat e qoftë me pasurinë e tij. Në qoftëse do të dëshiroja të zë edhe ndonjë mik tjetër përveç Allahut, me siguri do të zgjidhja Ebu Bekrin, por vëllazëria Islame është më lartë se çdo lloj miqësie.”

Pastaj, Hazreti Pejgamberi (s.a.v.s.), të cilit tashmë po i afrohej vdekja çast pas çasti, tha:

“Të gjitha dyert që komunikojnë me mesxhidin të mbyllën, vetëm ajo e Ebu Bekrit të qëndrojë hapur! Unë jam duke parë një nur në derën e Hazreti Ebu Bekrit...”

Kështu, në atë çast të vështirë lamtumire u mbyllën të gjitha dyert, përveç derës së Ebu Bekrit (r.a.), që ishte e vetmja që qëndroi hapur.

Në një kuptim simbolik ky fenomen mund të kuptohet kështu: e vetmja rrugë që arrin të hapë derën e afrisë me Resulullahun (s.a.v.s.), është ajo e bindjes, e dorëzimit, e besnikërisë, e sakrificës, e miqësisë dhe e dashurisë së Ebu Bekrit.

NJË KALA E PALËKUNDSHME BESIMI

Një nga sahabet më të pasur, Ebu Bekri (r.a.), pasi u shkri në qenien e të Dërguarit të Allahut, flijoi pasurinë dhe jetën në rrugën e Tij. Disa herë ia ka dhuruar tërë pasurinë të Dërguarit të Allahut, pa u frikësuar aspak nga varfëria. Një herë, profeti (s.a.v.s.)

7. Shih Buhari, Ashabun-Nebi 3, Menakibul Bani, 45, S. 80; Muslim, Fedailus-Sahabe 2; Tirmizi, Menakib 15; Ibni Sa‘ud, 11, 27.

e pyeti:

-Çfarë i le familjes tënde, o Ebu Bekër?

Ai u përgjigj me një qetësi të madhe shpirtërore:

-Atyre u lashë Allahun dhe të Dërguarin e Tij!..⁸

I Dërguari i Allahut nuk e lejonte asnjë sahab që të dhuronte krejt pasurinë e tij, por këtu bënte përjashtim vetëm Ebu Bekri. Ekziston mundësia, që njeriu i cili dhuron të gjithë pasurinë e tij, teksa gjendet i zhytur në varfëri dhe skamje të mund të ndikohet nga manovrat e djallit e të bëhet pishman për këtë akt sublim. Një pishmanllëk i tillë e shkatërron dhe e djeg sevapin e kësaj vepre të mirë. Por bota shpirtërore e Ebu Bekrit ishte pjekur me dashurinë për Allahun dhe të Dërguarin e Tij. Bota e tij shpirtërore ishte bërë si një kala imani që nuk lëkundet.

Pranimi i menjëhershëm e pa asnjë lëkundje që ai shfaqti ndaj ngjarjes së Miraxhit, dhe miratimi i plotë e pa as më të voglin dyshim që ai i bëri fjalës së të Dërguarit të Allahut në lidhje me këtë çështje, tregon qartë forcën e tij të besimit. Në lidhje me qëndresën shpirtërore të Ebu Bekrit, Imam Aliu (r.a.) ka thënë:

“Hazreti Ebu Bekri është si një mal që nuk tundet aspak nga asnjë lloj ere.”

Me të vërtetë, ngaqë e flijonte të gjithë pasurinë e tij në rrugë të Allahut, Ebu Bekri binte herë pas here në gjendje varfërie dhe skamjeje. Mirëpo dëshira që ai kishte të kënaqte Allahun dhe Resulin e Tij, ia lehtësonte të gjitha vështirësitë tokësore dhe



Ai që don të shohë dikë që është i shpëtuar nga Xhehennemi, le të shohë Ebu Bekrin!

bënte që Ebu Bekri të jetonte i qetë dhe i kënaqur me çdo gjë. Përballë lartësisë së virtytit dhe besnikërisë së Ebu Bekrit, Profeti (s.a.v.s.) ka thënë:

“Ai që do të shohë dikë që është i shpëtuar nga Xhehennemi, le të shohë Ebu Bekrin!” (Ali el-Muttaki, no: 32617)

ATMOSFERA E MODESTISË DHE E TË QENIT NJË “HIÇ”

Duke shpëtuar nga pasuria dhe egoja e tij, pra duke duke fituar jetë dhe qenie tek i Dërguari i Allahut, Ebu Bekri (r.a.) u bë një shembull i gjallë i moralit të Profetit Muhamed (s.a.v.s.).

Ashtu si i Dërguari i Allahut (s.a.v.s.), edhe ai i kishte harruar hallet e veta. Ai ishte ngjitur në kulmet e dhembshurisë, duke pasur si hall dhe problem të vetëm hallet dhe problemet e umetit. Ai e kishte kaluar fazën e egoizmit të tij dhe nuk thoshte kurrë **“Vetja ime, vetja ime”**, por kishte arritur shkallën e të një-suarit me të tjerët, duke thënë **“Umeti im, umeti im”**. Kjo gjendje reflektohej në duatë e tij kështu:

“O Zoti im! Ma zmadho aq shumë trupin tim në xhehenem, saqë aty mos të ketë më vend për asnjë njeri tjetër!..”

Kjo thënie e Ebu Bekrit shpreh qartë përmasat e dhembshurisë dhe të mëshirës së tij, por shpreh gjithashtu edhe modestinë e zhvlerësimin që ai i bënte vetes.

Kur ai u zgjodh khalife për myslimanët, hipi në minber dhe tha me modesti:

“O njerëz! Edhe pse nuk jam më i miri ndër ju, u zgjodha khalifi juaj. Në qoftë se e kryej detyrën time

⁸ Shih Bahari, Ashabun-Nebi 3, Menakibul-Ensar 45, Salat 80; Muslim, Fedailus-Sahabe 2; Tirmidhi, Menakib 15; Ibni Sa'd, II, 227.



siç duhet, më ndihmoni. Nëse veproj gabim më tregoni rrugën e drejtë...” (Ibni Sa’d, III, 182-183; Sujuti, Tarihu’-Hulefa, s. 69, 71-72; Hamidullah, Pejgamberi i Islamit, II, 1181)

Pra, ai sahab i madh e jetoi me një modesti dhe pjekuri të rrallë virtytin **“e të pranuarit të kritikës e të tërheqjes së veshit (paralajmërimit)”**. Kur populli po i jepte atij besueshmërinë për këtë detyrë, ai u shpreh:

“Unë nuk kam kërkuar asnjëherë pushtet, madje as nuk e kam vlerësuar ndonjëherë atë. Nuk ia kam kërkuar Allahut as fshehtazi e as haptazi, sepse (nga frika e përgjegjësisë që të ngarkon kjo detyrë) nuk do të mund të kem asnjë çast qetësie.”

Dhe me të vërtetë, kur Ebu Bekri (r.a.) u zgjodh khalife, u bë edhe më modest e i devotshëm. Para se të bëhej khalife, milte delet e vajzave jetime dhe kujdesej për nevojat e tyre. Pasi u bë khalife, fqinjët e tij filluan të mendonin se për shkak të shtimit të punëve dhe të ndryshimit të kushteve të jetesës, ai nuk do milte më delet e vajzave jetime. Por asgjë nuk ndryshoi. Me të njëjtën modesti, ai vazhdoi të milte delet e vajzave jetime dhe të kujdesej personalisht për nevojat e tyre. (Sujuti, Tarihu’-Hulefa, faq. 80; Sariçam, Hz. Ebu Bekir, faq. 82)

Ai nukanoi nga kjo botë as para se të bëhej khalife e as më pas. Njësoj si vetë Resulullahu (s.a.v.s.), dëshira e tij më e madhe ishte plotësimi i udhëtimit për në ahiret, me një dëshirë bashkimi hyjnor dhe me një qetësi shpirtërore të çliruar nga sikletet e kësaj bote. Për këtë arsye, pak kohë para se të ndërronte jetë, ai la si amanet shitjen e një toke që i përkiste atij, duke porositur që me të ardhurat e saj të shpague rrogat që kishte marrë në mënyrë të detyrueshme nga thesari i shtetit

gjatë gjithë kohës që kishte qenë khalife. (Ibni Esir, el Kamil, II, 428-429)

MODEL NË MATURI DHE PJEKURI

Në jetën e tij kishte një ekuilibër të fuqishëm hyjnor. Gjithmonë shfaqti një modesti të madhe, por asnjëherë nuk u tregua i shtypur dhe i dobët. Gjithmonë ishte serioz, por kurrë nuk e kaploi krenaria dhe mendjemadhësia. Ai ishte shumë falës, tolerant, i urtë dhe i butë, por diti edhe të ishte i ashpër e i guximshëm aty ku duhej. Sidoqoftë, në çdo rast ishte model në maturi dhe pjekuri.

Me gjithë këto virtyte, ai asnjëherë nuk tregoi tolerancë ndaj kundërshtimit të urdhrave të Hazreti Pejgamberit. Ai gjithmonë u bë një mbrojtës i vendosur i Islamit dhe nuk lëshoi pe në asnjë çështje të fesë. Irtidatin (lënien e fesë) dhe refuzimin e obligimit të zekatit, që ngriti krye pasi ndërroi jetë Resuli i Allahut (s.a.v.s.), e luftoi me forcë dhe vendosmëri të madhe, duke thënë: *“Do t’iu shpall luftë atyre, edhe sikur të fshehin e të mos japin prej mallit të zekatit qoftë edhe një copë të vogël litari!...”*

Kështu, ai u bë pengesë në rritjen e mëtejshme të ngatërrësive dhe i mbylli të gjitha dyert që mund të bëheshin shkak për prishjen e fesë. Ky veprim i tij i vendosur dhe i guximshëm mahniti edhe vetë simbolin e drejtësisë e të trimërisë, hazreti Omerin.⁹

Ky sahab fisnik dhe madhështor jetoi gjithmonë në pedestalin e drejtësisë dhe miqësisë. Prandaj, në lidhje me këtë çështje, qortimet dhe këshillat e tij kanë një vlerë aq të madhe për ne, sa mund të hapin dyert e këtij pedestalit të lartë. Me jetesën e tij të ka-

9. Ali el-Kari, Mirkati, X, 381-383/6034

rakterizuar nga një besnikëri shembullore, ai u bë një model i pashoq. Në të njëjtën kohë, me fjalët e tij plot margaritarë urtësie, fjalë të cilat shprehin fshehtësitë e kësaj jetese, u bë parimi jetësor i zemrave të besimtarëve. Ja disa prej fjalëve të tij, të cilat përbëjnë një thesar të urtësisë dhe të fisnikërisë.

FJALË TË URTA NGA HAZRETI EBU BEKR (R.A.)

“Midis Allahut dhe krijesave të Tij nuk ka asnjë lidhje familjare. Afërsia me Allahun është e mundur vetëm me bindje ndaj urdhrave të Tij.”

“Allahu nuk kënaqet nga fjalët e pashoqëruara me vepra.”

“Fjalët e tepërta e bëjnë njeriun harraq.”

“Mendoje mirë atë që thua, kur e thua dhe kujt ia thua!”

“Bëhu skllav i të diturve që e njozin Hakun (Allahun)!”

“Mos ia fshih gjendjen tënde atij që dëshiron të të ndihmojë! Përndryshe mashtron vetveten.”

“Përmirësoje veten, në mënyrë që edhe njerëzit të sillen mirë me ty.”

Katër lloj njerëzish janë prej robërve të mirë të Allahut:

1. Ai që gëzohet kur sheh dikë që bën teube (pendohet).

2. Ai që i përgjërohet Allahut për faljen e gjynaheve.

3. Njeriu që bën dua për vëllanë e tij të fesë kur ai nuk ndodhet i pranishëm.

4. Ai që ndihmon dhe i shërben dikujt që është nevojtar më shumë se ai vetë.

“Pranë meje, më i fortë prej jush është i dobëti, deri sa të marrë të drejtën



e tij, ndërsa më i dobëti prej jush është i fortë, derisa t'i merret e drejta që i ka dikujt.”

“Kur imani është i vetëm në xhami, kur pasuria është tek koprracët, armët tek frikacakët dhe përgjegjësia tek të paaftët, atëherë çdo punë shkon ters.”

“Njeri me mend është njeriu i devotshëm, ndërsa njeri pa mend është keqberësi.”

“Në Kuranin Kerim, Allahu Teala e ka përmendur shpërblimin e premtuar së bashku me dënimin, me qëllim që robi të dëshirojë adhurimin dhe të frikësohet prej dënimit.”

“Nëse të shpëton një mirësi, mundohu ta kapësh; kur ta arrish, mundohu ta kalosh që të arrish një më të mirë!”

“Të bërët mirësi ndaj njerëzve e mbron robin prej be-lave dhe fatkeqësive.”

“Largohu prej famës, që të të ndjekë nderi. Përgatitu për vdekjen, që të të jepet jetë.”

“Nuk ka asnjë fatkeqësi për të cilën mund të mendosh se nuk ka më të keqe se ajo.”

“Durimi nuk sjell dëm dhe hidhërimi nuk sjell dobi.”

“Durimi është gjysma e besimit, ndërsa dituria (absolute) i gjithë besimi.”

“Prej Allahut kërkoni shëndet, sepse pas diturisë (absolute) askujt nuk i është dhënë ndonjë gjë më e mirë se shëndeti.”

“Për mua është më e pranueshme të jem me shëndet dhe të falënderoj, se sa të jem në sprovë dhe të duroj.”

“Dyngjaja është pazari i besimtarëve; nata dhe dita

**Dynjaja është pazari i
besimtarëve; nata dhe dita janë
kapitali i tyre, punët e mira,
mallrat e tregtisë, xheneti janë
fitimi, ndërsa xhehenemi është
dëmi e tyre.**

janë kapitali i tyre, punët e mira, mallrat e tregtisë, xheneti janë fitimi, ndërsa xhehenemi është dëmi e tyre.”

“T’i dërgosh salavat Hazreti pejgamberit, i fshin gjynahet më shpejt nga ç’e shuan uji zjarrin. T’i dërgosh selam (me dashuri dhe sinqeritet) është më e vlefshme se sa të lirosh disa skllëvër. Ndërsa, ta duash Resulullahun –sallallahu alejhi ue sellem - është më sublime se sa të luftosh me nefsin apo të luftosh me shpatë në rrugë të Allahut.” (Bagdadi, Tarihu Bagdad, VII, 161)

“Miqhtë e Allahut ndahen në tre kategori (sipas karakterit) dhe në të tre kategoritë vihen re tri shenja:

- Në kategorinë e parë janë atë që ndodhen në **hauf** (gjendje frike ndaj Allahut). Këta kanë cilësi të tilla:

1. Janë gjithmonë modestë.
2. Megjithëse mund të kenë bërë shumë të vepra të mira, ata i konsiderojnë të pakta.
3. Edhe gabimin më të vogël e shohin si të madh. (Sepse janë të vetëdijshëm se kundër kujt kanë bërë gjynah)

- Kategoria e dytë janë ata që zotërojnë **rexha** (shpresë tek Allahu). Cilësitë e tyre janë:

1. Me çdo fjalë dhe vepër të tyre, duke shpërndarë mirësi dhe urtësi, këta bëhen shembull për të gjithë.
2. Duke harxhuar pasurinë në rrugë të Allahut, ata bëhen njerëzit më bujarë.
3. Kanë gjithmonë mendim të mirë në lidhje me njerëzit e tjerë.

- Kategoria e tretë janë ata që e adhurojnë Allahun me dashuri dhe devotshmëri. Cilësitë e tyre janë:

1. Gjërat që i duan më shumë, i japin për hir të Alla-

hut.

2. Me çdo fjalë dhe vepër synojnë kënaqësinë e Allahut, arsye për të cilën nuk hidhërohen prej qortimeve të injorantëve e nuk shqetësohen prej veprimeve të tyre të pasjellshme.

2. Me gjithë kundërshtimin e nefsit (egos), mundohen të bëjnë gjëra të cilat i vijnë rëndë nefsit. Me çdo fjalë dhe vepër i binden urdhrave dhe ndalesave të Allahut.” (Ibn-i Haxheri’l Askalani, Munebbihat, faq. 94-95)

Ja pra, Ebu Bekri (r.a.) ishte një personalitet Islam, i cili i kishte përmbledhur në vetvete të trija këto kategori dhe i zotëronte të gjitha cilësitë e tyre. Allahu na bëftë prej atyre që përfitojnë nga këshillat e tij të urta dhe të kemi begati prej tyre. Gjithashtu na bëftë hallka të zinxhirit të miqësisë së tij!, sepse ata që arrijnë burimin e miqësisë së Allahut dhe Resultit të tij, janë Hulefa-i Rashidinët (khalifët e drejtë), sahabet e ndershëm, miqtë e Allahut dhe ata të cilët shkojnë pas gjurmëve të tyre, duke u bërë me mëshirën e Allahut prej udhëtarëve të lumtur të karvanit të pafundësisë.

Fjalëve tona u japim fund me këto lutje të sinqerta që rrjedhin prej zemrës së Ebu Bekrit (r.a.):

“Allahu im! Periudha më e mirë e jetës sime le të jetë fundi, pjesa më e mirë e punëve të mija le të jenë përfundimet dhe dita ime më e mirë le të jetë dita kur do të takohem me Ty.” (Sujuti, Tarihu’l-Hulefa, faq. 103)

“Allahu im! Mirësia e fundit që do të më falësh le të jetë kënaqësia Jote (ndaj meje) dhe gradët e larta në xhenetet Naim!” (Sujuti, Tarihu’l-Hulefa, faq. 103)

Amin!



Mr. sci. Flamur Sofiu

Furnizimi dhe mirëmbajtja sipas të drejtës së sheriatit

Me shprehjen **التزكية** në Sheriatin islam kuptohet mirëmbajtja dhe furnizimi i obligueshëm ndaj disa personave dhe i shtazëve që ke në zotërim, duke u siguruar atyre ushqimin, veshmbathjen dhe vendbanimin.

Furnizimi dhe mirëmbajtja është obligim për:

1. gruan,
2. fëmijën,
3. prindërit,
4. të afërmit,
5. shtazët.

FURNIZIMI DHE MIRËMBAJTJA E GRUAS

Furnizimi dhe mirëmbajtja e gruas është obligim për bu-

rrin, gjë për të cilën gjejmë mbështetje në Kuranin (a.s.), në Sunet dhe në Ixhma. Si argumente prej Kuranit mund të përmendim këto ajete:

“...Babai i fëmijës është i obliguar për furnizimin dhe veshmbathjen e tyre (gruas) ashtu si është rregulli. Askush nuk ngarkohet më tepër, vetëm aq sa ka mundësinë e tij...” (El-Bekare: 233)

“Ai që është i pasur, le të shpenzojë sipas mundësisë së vet, e ai që është ngusht nga pasuria, le të japë nga ajo që i ka dhënë Allahu...” (Et-Talak: 7)

Si argument prej Sunetit kemi hadithin e Pejgamberit (s.a.v.s.) të transmetuar nga Mu’avijetul Kushejriji (r.a.), i cili tregon se i ka thënë Pejgamberit (s.a.v.s.):

“O Pejgamberi i Zotit, çfarë obligimi kemi ne ndaj grave tona? E ai i është përgjigjur: “Ushqe atë (gruan) kur ti të ushqehesh, siguroja veshmbathjen kur ta sigurosh për vete, mos e rrah fytyrës, mos i thuaj diçka të keqe dhe mos ia kthe shpinën përveç se në shtëpi”.

Po ashtu, sipas *ixhmait* të *ulemave* (konsensusit të dijetarëve) burri e ka për obligim të kujdeset për furnizimin e gruas.

Shkaku i obligueshmërisë së furnizimit ndaj gruas

Ligdhënësi e ka obliguar burrin që ta furnizojë gruan e tij, për shkak se qysh prej aktit të martesës ajo konsiderohet e varur prej tij, të cilin e ka për obligim ta respektojë, të qëndrojë në shtëpinë e tij, të kujdeset dhe t’i edukojë fëmijët etj, e për shkak të gjitha këtyre burri e ka për obligim furnizimin dhe mirëmbajtjen e gruas.

Kushtet që duhet të plotësojë gruaja për të merituar furnizimin

Këto kushte janë:

1. që akti i martesës të jetë i vlefshëm.
2. që gruaja t’i dorëzohet (respektojë) burrit të saj.
3. që t’i mundësojë burrit të vet shprehjen e epsheve.
4. që të dy bashkëshortët të jenë të aftë të kryejnë marrëdhënie intime.
5. që të mos e pengojë burrin e saj kur ai dëshiron të transferohet, të udhëtojë prej një vendi në një vend tjetër.¹

Po qe se nuk plotësohen këto kushte, atëherë burri nuk e ka obligim për kujdesjen dhe furnizimin ndaj gruas së tij. Nëse akti i martesës nuk është i vlefshëm (*عقد الزواج فاسد*), bashkëshortet duhet të ndahen doemos dhe furnizimi në këtë rast nuk është obligim për burrin. Po ashtu nëse gruaja nuk i dorëzohet burrit, pra nuk e respekton atë, nuk i mundëson shprehjen e epsheve dhe e pengon të transferohet prej një vendi në një vend tjetër, atëherë burri nuk është i obliguar ta furnizojë atë (gruan). Nëse ndodh që gruaja të jetë e moshës së re, arsye për të cilën nuk është ende e aftë për marrëdhënie intime, atëherë burri nuk është i obliguar ta furnizojë atë, por nëse rasis e kundërta, pra që burri është ende i ri dhe ende i paaftë për marrëdhënie intime, ndërsa gruaja është e aftë për marrëdhënie intime, atëherë burri e ka për obligim furnizimin ndaj saj. E nëse ndodh që të dy bashkëshortët të jenë të rinj dhe nuk janë në gjendje të kryejnë marrëdhënie intime, atëherë burri

1. Gruaja mund ta pengojë burrin vetëm atëherë kur burri i saj dëshiron që me anë të atij transferimi ta dëmtojë atë, ose nëse nuk e siguron atë dhe pasurinë e saj.

nuk e ka obligim furnizimin ndaj gruas. Po qe se ndodh që gruaja të udhëtojë pa lejen e burrit, ta kryejë haxhin pa lejen e tij, të dalë prej shtëpisë pa lejen e burrit, në këto raste burri nuk e ka për obligim furnizimin e saj. Nëse ndodh që ajo të udhëtojë me lejen e burrit, apo të kryejë haxhin me lejen e tij, atëherë burri e ka për obligim furnizimin dhe mirëmbajtjen e saj. Gjithashtu, nëse burri e thërret gruan e tij të transferohet prej një vendi në një vend tjetër për shkak se e kërkon nevoja, f.v. nëse ndodh që burri të punojë në ndonjë vend larg vendbanimit dhe ajo refuzon të shkojë me të, burri nuk e ka obligim furnizimin dhe mirëmbajtjen e saj.

FURNIZIMI DHE MIRËMBAJTJA E FËMIJËVE

Babai e ka obligim furnizimin dhe mirëmbajtjen e fëmijëve të vet, duke u bazuar në fjalët e Allahut (xh.sh.):

“... *babai i fëmijës është i obliguar për furnizimin dhe veshmbathjen e tyre ashtu si është rregulli...*” (El-Bekare: 233)

Sipas kësaj pjese të ajetit, vërehet qartë se babai e ka obligim furnizimin dhe mirëmbajtjen e fëmijës dhe të gruas. Po ashtu, faktin se babai e ka për obligim furnizimin dhe mirëmbajtjen e fëmijës dhe gruas, e vërejmë qartë edhe nga fjalët e Pejgamberit (s.a.v.s.), kur ai i drejtohet gruas së Ebu Sufjanit, Hindit: “*Merr (prej pasurisë së Ebu Sufjanit) aq sa ke nevojë ti dhe fëmija yt*”.

Obligim është furnizimi dhe mirëmbajtja e fëmijëve, fëmijëve të fëmijëve (nipave) d.m.th., gjyshi e ka për obligim edhe furnizimin e nipave prej cilësdo anë qofshin ata.

Kushtet e obligueshmërisë së furnizimit dhe mirëmbajtjes së fëmijëve

Obligimi për furnizimin dhe mirëmbajtjen e fëmijëve përmban këto kushte:

1. **Babai të jetë i pasur për t’i furnizuar, ose të ketë mundësi fitimi.** Kur babai është i pasur ose është i aftë për t’i furnizuar fëmijët, atëherë ai ngarkohet me një obligim të tillë. Por, nëse ndodh që babai nuk është i pasur, por është i aftë për të fituar, atëherë për të është obligim (*farz*) fitimi për t’i furnizuar dhe mirëmbajtur fëmijët. E nëse prindi është i varfër dhe nuk ka mundësi fitimi, ai nuk është i ngarkuar me këtë detyrë, ngase vetë ai ka nevojë që dikush tjetër ta atë furnizojë dhe ta mirëmbajë.

2. **Fëmija të jetë i varfër e të mos ketë pasuri, por edhe të mos jetë i aftë të fitojë.** Nëse fëmija ka pasuri, babai nuk është i obliguar ta furnizojë dhe ta mirëmbajë.



Por, nëse ndodh që fëmija të jetë i varfër dhe pa pasuri, por edhe i paaftë për të fituar, atëherë babai obligohet të furnizojë e ta ndihmojë.

Paafësia për të fituar mund të ndodhë për këto shkaqe:

a. **Mituria.** Kur fëmija hyn në moshën madhore, babai ka të drejtë ta angazhojë fëmijën mashkull që të punojë për të fituar, ose të paguajë dikë që t'i mësojë atij ndonjë zanat për të fituar. Ndërsa, sa i përket fëmijës femër, nuk lejohet të angazhohet për të punuar si shërbëtore, por mund ta dërgojë te ndonjë grua që të mësojë zanatin e rrobaqepësisë, të qëndisjes, e punë të të ngjashme me këto.

Sa i përket fëmijës së rritur, babai nuk e ka obligim as mirëmbajtjen dhe as furnizimin e tij, përveçse nëse ai është me të meta psikike dhe fizike si, f.v. është i çmendur, i ka duart dhe këmbët e këputura, është i verbër, është duke studiuar ose ka ndonjë sëmundje, e cila e pengon të punojë e të fitojë.

b. **Femëria.** Babai e ka për obligim të kujdeset për fëmijën femër jo vetëm deri sa të hyjnë në moshën e pjekurisë, por edhe deri sa të martohet e të fillojë të furnizohet prej burrit të saj. Nëse ndodh që burri ta shkurorëzojë, babai prapë është i obliguar ta furnizojë atë, duke mos iu lejuar ta detyrojë vajzën e tij të punojë e të fitojë. Nëse ndodh që vajza të fitojë nga profesioni-zanati që ka, por që me

atë profesion nuk e sjell vetën në ndonjë *fitne*, f.v. në *zina*, atëherë babai nuk e ka për obligim që të kujdeset për të. Mirëpo, nëse ajo ka nevojë dhe nuk i mjafton vetëm fitimi i saj, atëherë babai e ka për obligim që t'ia plotësojë.

c. **Sëmundja, e cila bëhet shkak ta pengojë për të fituar-punuar.** Si sëmundje mund të jenë: verbëria, çalimi, çmenduria, matufosja etj.

ç. **Të kërkuarit e diturisë, e cila bëhet shkak për të mos fituar.** Studiuesin, i cili është duke mësuar, edhe po të jetë i aftë për të fituar babai e ka obligim ta furnizojë, por me kusht që studiuesi të jetë i aftë dhe i zellshëm në çështjet e studimit.

FURNIZIMI DHE MIRËMBAJTJA E PRINDËRVE

Muslimani është i obliguar të kujdeset për prindërit. Për këtë ka mbështetje në Kuran dhe Sunet. Allahu (xh.sh.) thotë:

“Zoti yt ka dhënë urdhër të prerë që të mos adhuronit tjetër përveç Atij, që të silleni në mënyrë bamirëse ndaj prindërve...”
(El-Isra: 23)

“...dhe shoqëroji ata dy (prindërit) në këtë botë me të mira...”
(Lukman: 15)

Në ajetin e parë, fjala (إحسانا) ka për qëllim të tregojë se prindërit duhet të furnizohen kur ata kanë nevojë. Po ashtu, në ajetin e dytë fjala (معروفا) jep të kuptojë se muslimani e ka për obligim që t'i furnizojë prindërit, edhe po qe se ata nuk janë muslimanë.

Në këtë aspekt, muslimani e ka për obligim furnizimin dhe mirëmbajtjen e këtyre personave:

1. babait (babën e babës (gjyshin),..etj)
2. nënën (nënë e nënës (gjyshen), nënën e babait (gjyshen)...etj)

Kushtet që duhet të përmbushin prindërit për të merituar furnizimin dhe mirëmbajtjen

Kushtet e tilla janë:

1. **Prindi të jetë i varfër apo i paaftë për të fituar.** Nëse prindi nuk është i aftë për të fituar, duhet të furnizohet dhe të mirëmbahet.

2. **Fëmija të jetë i pasur ose i aftë për të fituar.** Nëse ndodh që fëmija nuk është i pasur dhe nuk është i aftë për të fituar, atëherë nuk e ka për obligim furnizimin dhe mirëmbajtjen e prindërve. Ky mendim mbështetet në hadi-

thin e Pejgamberit (s.a.v.s.): “Kur ndonjëri prej jush është i varfër, le të kujdeset në fillim vetëm për vetveten, e nëse fiton diçka më tepër, le ta furnizojë familjen e tij, e po qe se fiton edhe më tepër le të i furnizojë të afërmit e tij”.

3. Furnizuesi të jetë prej të afërmeve me të drejtë trashëgimie.

FURNIZIMI DHE MIRËMBAJTJA E TË AFËRMVE

Është obligim furnizimi dhe mirëmbajtja e të afërmve, si f.v., mirëmbajtja dhe furnizimi i vëllait, i dajës, i mixhës, i djalit të vëllait, i tezës dhe i hallës. Për këtë lloj obligueshmërie kemi si argument fjalët e Allahut (xh.sh.):

“Dhe jepi çdo të afërmi të drejtën që i takon...” (El-Isra: 26)

“Adhuroni Allahun dhe mos i shoqëroni Atij asnjë send, silluni mirë ndaj prindërve, ndaj të afërmve...” (En-Nisa: 36)

Sipas këtyre ajeteve, na bëhet e qartë obligueshmëria e furnizimit dhe mirëmbajtjes së të afërmve që kanë nevojë për furnizim. Obligim është furnizimi dhe mirëmbajtja ndaj atyre që janë të një barku, si p.sh: xhaxhai, vëllai, biri i vëllait, halla, tezja dhe daja. Nuk është obligim furnizimi dhe mirëmbajtja ndaj djalit dhe vajzës së xhaxhait; po ashtu nuk është obligim furnizimi as mirëmbajtja e vëllait apo motrës prej qumështi.

Kushtet që duhet të plotësojë i afërmi për të merituar furnizimin dhe mirëmbajtjen

Këto kushte janë:

1. I afërmi nga barku të jetë i varfër dhe i paaftë për të fituar (punuar). Nëse i afërmi është i varfër, i mitur, femër, i sëmurë, i verbër etj. është obligim ndaj tyre furnizimi dhe mirëmbajtja. Por, nëse ndodh që i afërmi është i rritur, por është i paaftë për të punuar-fituar për ndonjë arsye të justifikueshme, si f.v. sëmundja, verbëria etj, atëherë furnizimi dhe mirëmbajtja ndaj tij është obligim. Po qe se ndodh që i afërmi është i aftë për të punuar dhe fituar, atëherë furnizimi dhe mirëmbajtja e tij nuk është obligim.

2. I afërmi dhe furnizuesi të jenë myslimanë. Nuk është obligim furnizimi dhe mirëmbajtja ndaj atij të afërmi që nuk është mysliman, ashtu sikundër ai nuk gëzon as të drejtë trashëgimie.

3. Furnizuesi të jetë i pasur. Nëse i afërmi nuk është i pasur, atëherë ai nuk është i obliguar t'i furnizojë të afër-



mit e tij, edhe nëse ky është i aftë për të punuar dhe fituar.

Imam Ebu Jusufi (r.a.) dhe imam Muhamedi (r.a.) ndajnë mendimet e tyre në lidhje me rastin kur i afërmi konsiderohet i pasur dhe që meriton të obligohet për furnizimin e mirëmbajtjen e të afërmve.

Imam Ebu Jusufi (r.a.) mendon se kur njeriu është i pasur, e ka obligim furnizimin dhe mirëmbajtjen e të afërmve nëse pasuria e tij arrin vlerën e 96 gr. ari, vlerë për të cilën duhet dhënë zekat.

Imam Muhammedi (r.a.) është i mendimit se konsiderohet i pasur ai person që ka furnizim për veten dhe familjen sa për një muaj, por që përveç kësaj pasurie i mbetet tepërcë, tepërcë të cilën duhet t'ua japë të afërmve që kanë nevojë për furnizim e mirëmbajtje.

FURNIZIMI I SHTAZËVE

Pronari është i obliguar që të furnizojë dhe mirëmbajë shtazët dhe shpezët shtëpiake. Pejgamberi (s.a.v.s.) ka thënë: “Një grua do të hyjë në xhehenem për shkak të një maceje të cilën e ka ngujuar derisa ka ngordhur nga uria, që jo vetëm nuk e ka ushqyer fare, por as dhe nuk e ka lëshuar që të mund të ushqehet nga zvarranikët e tokës.”



Përmendja e Allahut në një të tretën e natës

Sadik Dana

Nëse një besimtar do ta shfrytëzojë natën për të përfutuar sa më shumë nga atmosfera e përmendjes (Dhikr) së Allahut atëherë nata do të bëhet edhe më e shndritshme se dita e tij. Por nëse ai fle pa qëllim përmendjen e Allahut /Dhikrin atëherë nata e tij do t' i ngjajë shiut të pafrytshëm që bie në shkretëtirë, det apo gur. Në të vërtetë kjo është një humbje e pazëvendësueshme. Për të përfutuar nga nata duhet të fillojmë me Istigfar/pendim. Njeriu duke u mbështetur në instiktin e tij egoist, zhytet në injorancën e mendjemadhësisë, epshit, kokëfortësisë dhe kopracisë. Duke u sjellur në këtë mënyrë mohon mirësitë që i ka dhuruar Allahu dhe bëhet prej mëkatarrëve. Besimtari nëse arrin ta largojë perden e mosmirënjohjes, ndërgjegjësohet për peshën e mëkatit të kryer dhe pendohet me sy te përlotur.

Edhe sikur të mos kemi asnjë mëkat forca që bart njeriu është e pamjaftueshme për të falenderuar sa duhet Allahun për mirësitë që na ka dhuruar. Prandaj është i domosdoshëm istigfari/pendimi dhe nënshtrimi kundrejt Krijuesit. Kurani famëlartë përcjell shembuj të shumtë rreth istigfarit/pendimit të Pejgamberëve. Alla-

hu Mëshiruesi, Mëshirëbërësi në Kuranin famëlartë na tregon mënyrën sesi të lutemi dhe të mbështetemi tek Ai. Në një ajet Allahu është shprehur: **Thuaj: "Zoti im nuk do t'ju përfillte, sikur të mos ishte lutja juaj."** (Furkan 77)

I Dërguari i Allahut (s.a.v.s.) urdhëron ta rideklarojmë dëshminë e njësimin të Allahut (Kelime-i Tevhid). Në një Hadith tjetër Pejgamberi (s.a.v.s.) thotë: *"Ashtu siç do të jetoni, ashtu edhe do të vdisni"*. Nëse njësimi i Allahut që fillojmë në mesnatë (seher) arrin të na kaplojë zemrat dhe ditët tona, shpresojmë dhe lusim Allahun që edhe në lamtumirën tonë të fundit me gjithçka të kësaj dynjaje të na shoqërojnë shehadetet (Kelime-I Tevhid), në mënyrë që ai çast të kthehet në atmosferë dasme e jo tragjedia.

Vlera e salavateve që i dërgojmë Profetit në mesnatë është shumë e madhe. Është shprehje dashurie dhe respekti që kemi për Pejgamberin (s.a.v.s.). Allahu i Lartësuar duke vlerësuar të dashurin e tij në Kuranin famëlartë urdhëron që zemrat tona të mbushen me mirësi dhe dashuri për të Dërguarin e Allahut.

“Vërtet, Allahu e bekon të Dërguarin dhe engjëjt e Tij lutën për atë. O besimtarë, lutuni për atë dhe përshëndeteni me “selam!” (Ahzab-56)

Allahu i Lartësuar në Kuranin famëlartë duke u betuar në jetën e Zotërisë sonë (s.a.v.s.) thekson pozitën e veçantë që ka Pejgamberi (s.a.v.s.) mes pejgamberëve të tjerë. Ndërmjetësimi (Shefaati) i Zotërisë sonë (s.a.v.s.) ditën e gjykimit është në varësi (raport) me dashurinë dhe respektin ndaj Profetit (s.a.v.s.). Të jetuarit e fesë sa më mirë lidhet drejtpërdrejt me ndjekjen e traditës Profetike. Kusht për imitimim e kësaj tradite është dashuria dhe respekti për Profetin (a.s.), sepse i dashuruari imiton gjithmonë atë që dashuron. Allahu i Lartësuar atë e krijoi nga nuri i Tij dhe e bëri shkak për krijimin e gjithsisë. Çdo salavat që buron nga zemra jonë shton dashurinë tonë ndaj të Dërguarit të Allahut.

Allahu i Lartësuar vetëm atë na e përshkruan si shembullin më konkret. Lumturia e dy botërave kalon përmes tij. Allahu në Kuranin famëlartë thotë:

“Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm për atë, që shpreson tek Allahu dhe Dita e Fundit dhe e përmend shumë Allahun.” (Ahzab-21)

Për rigjallërimin e zemrës Dhikri/Permendja e Allahut në njërin pjesë të natës është me shumë rëndësi sepse ajo (zemra) vetëm duke qendruar bashkë me Allahun zgjohet. Ashtu siç ka nevojë trupi për ushqim ashtu edhe shpirti ka nevojë të ushqehet në mënyrë që ta njohë Krijuesin dhe t’i nënshtrohet Atij. Po ashtu siç ushqimi material shpërndahet nëpër kapilar dhe monitoron egzistencën e trupit ashtu edhe ushqimi shpirtëror që është Dhikrullah/Permendja e Allahut duhet të deportojë në të gjitha fshehtësitë dhe ta detyrojë besimtarin të jetë i vetëdijshëm. Allahu i fton robërit e vet në Darus-selam/Shtëpinë e Lumturisë. Kushti për t’iu përgjigjur kësaj ftese është Kalbi Selim/zemra e pastër. Në Kuranin famëlartë thuhet:

“Në Ditën kur askujt nuk do t’i bëjë dobi as pasuria, as fëmijët, përveç atij që vjen me zemër të pastër tek Allahu!” (Eshuara / 88-89)

Sa herë që do të permendim Allahun në këtë botë, po aq herë do të arrijmë mëshirën e Allahut nesër në botën tjetër. Për këtë shkak jemi të detyruar ta permendim dhe ta lartësojmë Allahun sa më shumë, për të përfituar nga kjo atmosfere madhështore. Guri më i çmuar dhe



puna më e pranuar në këtë botë është Dhikri/Përmendja e Allahut. Nëse e vërteta e dhikrit që shqipton gjuha, arrin të depërtojë në zemër, atëherë fillon adhurimi i denjë për Krijuesin dhe zbulohet sekreti i ekzistencës. Allahu i Lartmadhëruar në Kuranin famëlartë shpjegon vlerën e dhikrit dhe sekretin se si të arrijmë gradën më të lartë (Ahsen-I Takvim).

“Me të vërtetë, në krijimin e qiejve dhe të Tokës dhe në ndërrimin e natës e të ditës, ka shenja për mendarët, për ata që e përmendin Allahun duke qendruar në këmbë, ndenjor ose shtrirë dhe që meditojnë për krijimin e qiejve dhe të Tokës (duke thënë:) “O Zoti Ynë! Ti nuk i ke krijuar kot këto -lartësuar qofsh (nga çdo e metë)! Prandaj na ruaj nga ndëshkimi i zjarrit.” (Al Imran / 190-191)

Pëlqimi i ALLAHUT, si dhe grada më e lartë shpirtërore arrihet nepërmjet Dhikrit (Përmendjes së Allahut) të vazhdueshëm.

Njeriu që ecte përmbi ujë

Një ditë, një dervish me mendësi të kushtëzuar, prodhim i një shkolle të rreptë religjioze, po bariste përgjatë një bregu uji, krejtësisht i përhumbur në probleme teologjike dhe morale, sepse kjo ishte forma e mësimve sufi që i kishin dhënë në bashkësinë ku ai bënte pjesë. Për të, religjioni emocional përputhej me kërkimin e së Vërtetës Sublime.

Papritmas filli i mendimeve të tij u këput nga një britme e fortë: dikush po përsëriste lutjet e veta dervishore.

Dervishi ynë tha me vete: “Atij njeriu nuk do t’i bëjë fare dobi lutja, sepse po i shqipton keq rrokjet. Në vend që të këndojë JA HU, thotë U JA HU...”

Kështu, dervishi në fjalë mendoi se është detyra e tij e atij që kishte mësuar me aq zell- që ta korrigjonte atë të gJORë i cili, me sa shihej, nuk kishte patur fat të udhëhiqej në mënyrën e duhur, e që me gjasë bënte të mundshmen e tij për të hyrë në harmoni me idenë nëpërmjet tingujve.

Mori me qera një barkë dhe zuri të voziste në drejtim të një ishulli, prej nga dukej se vinte zëri.

Në një kasolle prej kallamash shquajti, ulur përtokë, një njeri të veshur si dervish që përkundej nën ritmin e përsëritjes së asaj formule.

-Miku im-, i tha, -shqiptimi që bën ti është i gabuar. Më takon të ta them, sepse është mirë të jepen këshilla, e po aq mirë të pranohen. Ja se si duhet ta shqiptosh.

Dhe ia shpjegoi.

-Falemnderit.- tha tjetri me përunjësi.

Dervishi i parë hipi sërish në barkë, shumë i kënaqur që kishte përmbushur një veprim të mirë. Por, në fund të fundit, a nuk do të ishte e udhës që, ai i cili e shqipton drejt një formulë të shenjtë, të zotërojë edhe aftësinë për të ecur mbi ujë? Dervishi nuk kishte parë kurrë ndonjë njeri që të kryente një mrekulli të tillë, por kishte shpresuar gjithmonë, se herët a vonë ai do mund t’ia mbërrinte vetë kësaj.


Nga kasollja nuk vinte më asnjë tingull; gjithsesi, dervishi ishte i bindur se mësimi i tij kishte dhënë fryte. Pikërisht në atë çast u dëgjua një U JA e shqiptuar me mëdyshje: dervishi i kasolles kishte rifilluar ta shqiptonte formulën simbas mënyrës së tij...

Teksa dervishi i parë ishte përhumbur në mendimet e tij, duke meditaruar rreth perversiteteve të njerëzve dhe kokëngjeshjes së tyre për të mos hequr dorë nga gabimet, sytë e tij dalluan një shfaqje të çuditshme: dervishi i kasolles pati lënë ishullin dhe po vinte drejt tij duke ecur përmbi sipërfaqen e ujit...

I mahnitur, reshti së vozituri. Tjetri e mbërriti dhe iu drejtua me këto fjalë:

-Vëlla, më fal që po të besdis, por erdha të të lutem që të ma mësosh edhe njëherë mënyrën e saktë për të thënë formulën, sepse e kam të vështirë ta mbaj mend.

Nga letërsia popullore orientale



Uji i parajsës

Përgjatë jetës së tyre prej nomadësh, Harith Beduini dhe gruaja e tij Nafisa e ngulnin çadrën e tyre të mjerë aty ku mund të gjenin ndonjë palmë hurmash, ndonjë degë të thatë për gamilen e tyre, apo ndonjë pellg uji të njelmët.

Kishte vite të tëra që bënin një jetë të tillë, e çdo ditë, Harithi kryente të njejtat veprime: nëpërmjet kurtheve, zinte minj shkretëtire për t'u marrë lëkurën, të cilën e ndërthurte me fijet e palmave, bënte litarë, dhe ua shiste karvaneve që kalonin andej.

Një ditë, gjithsesi, ai pa të teptiste nga rëra e shkretëtirës një burim. Harithi e ngjeroni ujin me buzë dhe iu duk si ujë parajse. Ai ujë, që ne do ta gjykonim si tmerrësisht të njelmët, ishte në të vërtetë shumë më i ëmbël se uji që ai ish mësuar të pinte. “Është e domosdoshme t'ia jap ta provojë ndokujt që ia di vlerën”, tha me vete Harithi.

Kështu, u përudh rrugës që e çonte në Bagdat, drejt e tek pallati i kalifit Harun El-Rashid, duke u ndalur vetëm për të përtypur ndonjë hurmë. Kishte marrë me vete dy shakuj me ujë: njërin për vete, kurse tjetrin për kalifin.

Mbas disa ditësh udhëtimi, Harith Beduini arriti në Bagdad dhe shkoi fill e te pallati. Rojet e dëgjuan rrëfimin e tij, dhe duke mos ditur ç'të bënin tjetër- ky ishte zakoni- e çuan në sallën e pritjes së njerëzve, ku gjendej kalifi.

-Prijës i besimtarëve-, tha Harithi, -unë jam një be-

duin i varfër dhe i njoh të gjithë llojet e ujërave të shkretëtirës, paçka se prej gjërave tjera marr vesh shumë pak. Sapo kam zbuluar këtë Ujë Parajse, dhe menjëherë mendova të ta sjell, sepse, në të vërtetë, është një dhuratë e denjë për ju.

Haruni, i Sinqerti, ngjeroni ujin e, meqë dinte t'i kuptonte nënshtetasit e tij, i urdhëroi oborrtarët ta rehatonin beduinin në pallat, e ta mbanin aty derisa ai, kalifi, të merrte një vendim lidhur me këtë çështje. Mandej thirri kapitenin e rojeve, dhe i tha:

-Ajo çka për ne është asgjë, për atë është gjithçka. Në të errur, shoqërojeni jashtë pallatit. Kini kujdes që të mos e shohë lumin e fuqishëm Tigër; shoqërojeni deri tek çadra e tij, dhe mos e lejoni të pijë ujë të ëmbël. Mandej jepini njëmijë monedha ari, bashkë me falenderimet e mia për shërbimet e tij. I thoni se e kam emëruar roje të Ujit të Parajsës, e se këndeje e mbrapa duhet t'u ofrojë të pijë ujë në emërin tim të gjithë udhëtarëve që do kalojnë aty.

Ky rrëfim titullohet edhe: “Historia e dy botëve”. Është rrëfyer nga Abu El-Atahiyya, i fisit Aniu, bashkëkohor me Harun El-Rashid. El-Atahiyya është quajtur “babai i pozisë së shenjtë arabe”. Vdiq në vitin 828.

Islami mes dijes dhe praktikës

A jetet e para të Kuranit famëlartë që i zbritën Pejgamberit tonë, Muhamedit (a.s.) nga Allahu i madhëruar janë: **“Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë)”**. (Alak, 1)

“Ai që e mësoi (njeriun) të shkruajë me pendë”. (Alak, 4) Kjo është shpallja e parë që lartëson vlerën e pendës dhe çmon vlerën e diturisë.

Sot, shumë njerëz e njohin vetëm si emër fenë Islame dhe mendojnë se mësimi i fesë është vetëm detyrë e hoxhallarëve, por jo dhe e tyre. Disa të tjerë kanë shumë njohuri islame, mirëpo kur shikon adhurimin dhe sjelljet e tyre zhgënjehesh, ngaqë ata ndjekin rrugë tjetër nga ajo që kanë mësuar.

Dituria është adhurimi më i mirë pas farzeve, ndërsa kërkimi i saj është një ndërmarrje e rëndësishme. Në një hadith të transmetuar nga Tirmidhiu, Pejgamberi (a.s.) ka thënë: **“Kush del të kërkojë dituri, ai është në rrugë të Allahut, deri sa të kthehet në vendin e tij”**.


Rruga e diturisë është rruga për në xhenet, të cilën njeriu vijon ta kërkojë derisa të hyjë në të. Në një hadith të transmetuar nga Muslimi, Pejgamberi (a.s.) ka thënë: **“Allahu ia lehtëson rrugën për në xhenet myslimanit që merr rrugën për të nxënë dituri”**.

Por, sa e ndihmon të verbërin shkëlqimi i dritës së diellit kur nuk e shikon dot atë? Po kështu edhe ditu-

ria nuk e ndihmon atë që e zotëron, përderisa ai nuk vepron në përputhje me të. Pa dituri dhe pa punë, imani nuk është i plotë dhe ngjason me bimën që nuk mund të rritet pa tokë e pa ujë.

Njeriu vlen aq sa di dhe di aq sa mban mend, sepse atë çfarë ke në xhep mund të ta marrin, por atë çfarë ke në tru nuk ta marrin dot. Kërkoje diturinë, por duke pasur parasysh se sado që të kesh mësuar, njohuritë tuaja nuk kanë dobi pa i kthyer në praktikë. Dituria është si pasuria, kërkuesi i saj nuk ngopet. Dallimi mes diturisë dhe pasurisë është se dituria forcohet sa më shumë që të punohet me të, dhe shtohet sa më tepër që të shpërndalet. Nëse paraja të mundëson të jetosh një jetë komode, atëherë dituria bën të mundur t’i fitosh të dyja jetët i lumtur dhe të mos harrohesh. Siç thotë edhe fjala e urtë: Arin e çmojnë ata që e njohin. Përpiqu të punosh në mënyrë të sinqertë me atë çfarë ke mësuar prej kësaj feje të madhe, sepse dituria është pemë, ndërsa vepra fryti i saj.

Disa të urtë thonin: Dituria është shërbëtori i vepërës, ndërsa vepra është qëllimi i diturisë, sepse po mos të ishte puna nuk do të kërkohet dituria, e po të mos ishte dituria s’do të kërkohet prej nesh puna e veprimi. Ai që mbledh dituri është si ai që mbledh pasuri. E mira e saj shijohet vetëm kur shfrytëzohet dhe shpenzohet.



“Zoti im! Ma shto diturinë!”

(Ta ha, 114)

Transmeton Ebu Davudi dhe Tirmidhiu nga Ebu Derda (r.a.) se Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Ai që nisat për rrugë që të kërkojë dituri, Allahu atij do t’ia lehtësojë rrugën për në xhenet. Vërtet që edhe melekët ia shtijnë krahët kërkuesit të diturisë nga kënaqësia që ndjejnë për veprën e tij. Vërtet që dijetarët janë trashëgimtarët e pejgamberëve; pejgamberët nuk kanë lënë trashëgimi as dinarë e as dirhemë, por ata kanë lënë trashëgimi diturinë, prandaj kush e merr atë, ka marrë hisen më të bollshme.”

Fet’h el-Musilij ka thënë: “Nëse nuk i japim të sëmurit as ushqim, as pije dhe as ilaçe, a nuk vdes ai? I thanë: Po. Tha: E njëjta gjë ndodh edhe me zemrën, nëse i ndalohej urtësia e dituria ajo vdes.”

Llukman Hakimi e këshillonte djalin e tij me fjalët: “O biri im: Ulu pranë dijetarëve me thjeshtësi dhe shoqëroi ata, sepse Allahu i ringjall zemrat me dritën e urtësisë, ashtu siç ringjall tokën e shkretë me ujin e shiut.”

Imam Maliku ka thënë: “Nuk përmirësohet fundi i këtij umeti veçse me atë që u ndreq fillimi i tij”.

Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Ndër shejat e kijametit janë: zhdukja e diturisë, shtimi i paditurisë, pirja e pijeve dehëse”. (Buhariu)

Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Zoti nuk do ta zhdukë diturinë duke e tërhequr atë (me dhunë) nga njerëzit, por duke i tërhequr (pra duke i marr afër vetes) njerëzit e ditur. Kur nuk do të ngelin më njerëz të ditur, populli do të

zgjedhë për udhëheqës të paditurit. Kur këta udhëheqës do të pyeten për ndonjë çështje, do të përgjigjen pa dijeni. Kështu do të vazhdojnë deri sa t’u arrijë shkatërrimi.” (Buhariu)

Ibni Mesudi (r.a.) ka thënë: “Mësoni, dhe me atë që keni mësuar, veproni.” Ebu Hurejra (r.a.) ka thënë: “Dituria me të cilën s’punohet është si thesari që nuk shpenzohet në rrugë të Zotit.” Kurse Fudajli ka thënë: “Ajo që kërkohet prej diturisë është vepra, kurse dituria është argumenti i saj.” (Transmeton Hatib El Bagdadi në “Iktidaul ilmi el amel.”)

Pejgamberi (a.s.) ka thënë: “Mjerë ai që s’di! Mjerë ai që di, por nuk vepron në bazë të asaj që di (këtë e përsëriti tri herë).”

Malik Ibn Dinari ka thënë: “Ai që nuk vepron me atë që di, është si shkëmbi. Kur shiu pikon mbi të, rrëshqet (e nuk qëndron).”

Sufjan Ibn Ujejne ka thënë: “Dituria, nëse nuk të sjell dobi, të dëmton”, sepse bëhet argument kundër teje Ditën e Gjykimit. Në një fjalë të urtë thuhet: Trupi shërohet duke punuar, ndërsa mendja duke mësuar.

Këtë shkrim po e përfundojmë me një lutje që Allahu (xh.sh.) i ka mësuar Pejgamberit tonë, Muhamed (a.s.) dhe nëpërmjet tij të gjithë besimtarëve myslimanë. Ajo është:

“Zoti im! Ma shto diturinë!” (Ta ha, 114)

Astronomia në Islam

Mr. Artur Tagani

Një prej shkencave në të cilat myslimanët u angazhuan më së tepërmi dhe më herët është astronomia. Për arsye të dobive praktike që kishte, shkenca e astronomisë gëzoi interesimin e masës së gjerë. Këto dobi ishin: përcaktimi i drejtimit të Kibles dhe i kohëve të namazit, përcaktimi i drejtimit në rrugën ajrore dhe tokësore, përzgjedhja e kohës së prodhimitarisë, përcaktimi kohor i bujqësisë dhe në veçanti parashikimi politik i vendit. Zakonisht myslimanët e kanë quajtur astronominë “*Ilmu’l-Hej’e*”, “*Ilmu’l-Eflak*”, dhe “*Ilmu’n-Nuxhum*”.

Të dhënat tregojnë se myslimanët u morën me astronomi e astrologji që në kohën e Emevive, gjatë periudhës së kalifatit të Abdu’l-Melikut (vd. 705). Ndërsa gjatë periudhës abbasite, në kohën e kalifatit të Me’munit (813 – 833), kjo shkencë mori një hov të madh me përkthimet në arabisht që iu bënë veprave kryesore botërore të kësaj fushe, si: “*Siddhanta*” e indianëve, “*Zixh’i-Shahi*” i sasanive, “*Almagest*” dhe “*Tetrabibles*” të antikitetit. Si rezultat, në një kohë të shkurtër u formuan shumë ekspertë të astronomisë, u shkruan shumë vepra të kësaj fushe dhe u bënë mjaft zbulime shkencore.

Shkencëtari zyrtar i parë astronom i shtetit abbasit ishte Muhammed el-Fezari (v. 777), i cili kishte një seri veprash që lidheshin me shkencat e astronomi-



së. Ky shkencëtar ishte autor i disa veprave të fushës së astronomisë e njëkohësisht ishte edhe shpikësi i astrolabit. Më pas vijnë Ibn Nevbaht (vd. 815) dhe Mashaallah (vd. 815), të cilët patën bërë kalkulimet astronomike të qytetit të Bagdadit.

Shkencëtarët myslimanë që u morën me astronominë janë të shumtë; ndër ta mund të veçojmë: Habesh el-Hasib, Havarizmi, Ebu Mashar, el-Fargani, en-Najziri, Thabit bin Kurra, el-Battani, el-Kuhi, Abdurrahman es-Sufi, vëllezërit Benu Musa, Ebu Sa’id el-Sixhzi, Ebu’l-Vefa el-Buzxhani, Ibn Junuz, el-Hakimi, ez-Zerkali, Ibn Baxhxhe, Ibn Tufejl, el-Bitruxhi, Ibn Sina, el-Biruni, Hazini, Nasiruddin et-Tusi, Kutubuddin Shirazi, Ibnu’sh-Shatir, Ullu Bej, Ali Kushçu, Gijaseddin el-Kashani, Kadizade-i Rumi dhe një seri emra shkencëtarësh të tjerë që patën hedhur hapa të rëndësishëm në shkencën e astronomisë. Kështu, mund të

përmendim për shembull el-Hasib (vd. 864), i cili përgatiti tablotë e para astronomike. Havarizmi (vd. 840) ushtroi në astronomi disa teorema gjeometrike dhe algjebrike. El-Fergani (shek. IX), i cili prej perëndimorëve njihet si "Alfaganus", është astronomi më i njohur i kohës; vepra e tij "*Kitab fi'l-Hareketi's-Semavije*" bën pjesë në veprat e rëndësishme klasike të botës Islame.

Kontributi dhe ndikimi i astronomisë dhe i astrologjisë së myslimanëve në shkencën e astronomisë dhe të astrologjisë është më i madh nga sa mund të mendohet. Shumë prej emrave të yjeve dhe planetëve që përdoren sot në astronominë moderne janë të marrë nga librat e myslimanëve dhe janë në arabisht, si p.sh.: Algol, Altair, Aldebaran, Rigel, Vega, Betelgeuse, Mercury, Venus, Mars, Jupiter, Saturn, etj, si dhe shumë emra të mjeteve astronomike.

RROTULLIMI I TOKËS, GRAVITACIONI DHE SISTEMI HELIOCENTRIK

Gjithkush e di të vërtetën që Galilei pati përsëritur, si pasojë edhe u kërcënua për t'u djegur së gjalli. Në fakt, nuk ishte Galilei (vd. 1642) ai që pati thënë i pari Galilei se bota rrotullohet. I pari që e pati thënë këtë ishte es-Sixhzi, rreth shtatë shekuj më parë, Galilei vetëm e pat përsëritur atë.

Sistemi astronomik i Ptolomeut ishte mjaft i përshtatshëm për kredon e krishterë të kohës, një sistem sipas të cilit toka qëndronte e fiksuar në një vend. Shkencëtarët myslimanë të astronomisë, si es-Sixhzi, Biruni, ez-Zerkali, Ibn Tufejl, Ibn Rushd dhe el-Bitruksi, -ky i fundit njihet nga perëndimorët edhe si krijuesi i astronomisë moderne-, vërtetuan dhe mbrojtën teorinë se toka rrotullohet. Në momentin kur filluan të përktheheshin librat e tyre në latinisht, greqisht, spanjisht dhe frëngjisht, shumë prej shkencëtarëve perëndimorë filluan të hiqnin dorë nga ideja ptolomeiste e Tokës dhe kush gjeti guximin e shprehu atë, ndonëse shumica e tyre shkuan me kokë nga Kisha.

Biruni (vd. 1051) nuk thoshte vetëm se Toka rrotullohet, por edhe se ajo ka një ligj që sot quhet gravitet. Në veprën e tij "*Kitabu'l-mali'l-hind*", ai shpjegon gjatë e gjerë se si në kohën e tij mbizotëronte teoria

se toka është e sheshtë dhe e palëvizshme. Ai shpjegon në mënyrë të detajuar se si mund të shpjegohet shkencërisht se toka është e rrumbullakët dhe se rrotullohet. Madje, po në këtë libër, ai kundërshton edhe teorinë aristoteliane, sipas së cilës Toka bën rrotullimin rrethor, por në formën elipsi. Pra, shumë kohë para se ta thoshte Kepleri, këtë të vërtetë e mbron Biruni.

Perëndimorët, bënë studime duke u mbështetur në studimet e el-Bitruksit (shek. XII). Nuk është e çuditshme pse Robert Grosseteste, Roger Bacon, Albertus Magnus, Galilei, Kopernik, Regiomontus, Tycho Brahe madje edhe Kepler, në veprat e tyre përmendin emrat e el-Bitruksit dhe shkencëtarëve të tjerë myslimanë që trajtuam më sipër. Fjala vjen, në pjesën e katërt të librit "*De Revolutionibus Orbium Coelestium*", Koperniku përmend me kënaqësi mendimet e el-Battanit (vd. 929) dhe ez-Zerkalit (vd. 1087).



Koçi Beu: Monteskieu osman me origjinë shqiptare

Burë shteti në perandorinë osmane në shek. XVII, Koçi Beu është i njohur për traktatet që i paraqiti Sulltan Murati IV dhe vëllait të tij sulltan Ibrahimit. Nuk ka të dhëna të sakta rreth datës dhe vendit ku ai lindi, por dihet se emri i tij i vërtetë qe Mustafa. Fakti që ai u përfshi që në rininë e tij si devshirme nga kasabaja e Korçës, i ka shtyrë studiuesit të mendojnë se ai ishte me origjinë nga kjo krahinë.

Pasi u pranua në shkollën Enderun, Koçi beu u përfshi në hasoda gjatë sundimit të sulltanit Murat IV (1623-1640). Duke fituar besimin e sulltanit, ai u bë edhe musahibi i tij. Me këtë cilësi ai mori pjesë në fushatën ushtarake të Bagdadit. Në vitin 1631 ai paraqiti në trajtën e një raporti të gjitha parregullsitë që vëreheshin në administratën osmane të asaj kohe. Ai qe edhe i besuari i sulltan Ibrahimit, të cilit në vitin 1640 i paraqiti një tjetër raport si ai i pari. Pak përpara, apo menjëherë pasi vdiq ky sulltan, Koçi beu tërhiqet në Korçë ku qëndroi deri në fund të jetës. U varros në fshatin Pllamet. Burimet osmane bëjnë fjalë për një vëlla të Koçi beut, i cili nuk arriti të ambientohet brenda sistemit osman, prandaj edhe u arratis në Ukrainë ku mori edhe emrin Andrea.

Në gjysmën e dytë të shekullit të gjashtëmbëdhjetë struktura “klasike” e shtetit dhe e shoqërisë osmane u përball me një “krizë” apo një “transformim”. Në të njëjtën kohë, shtetarët dhe dijetarët osmanë qenë të vetëdijshëm që shteti dhe shoqëria po përjetonte një transformim me prirje drejt një krize e brendshme, prandaj u përpoqën që ta përshkruanin e ta zgjidhin

atë nëpërmjet teorisë sociale që kishte në qendër drejtësinë shoqërore dhe katër parimet bazë, të cilat ishin katër klasat kryesore që formonin shoqërinë: dijetarët, ushtarakët, tregtarët dhe masat e popullit.

Traktatet e Koçi beut ishin më të njohurat dhe më gjithëpërfshirëset, sa u takon traktateve që analizuan nga këndvështrimi tradicional ndryshimet që pëndodhnin në atë kohë në rregullin shtetëror të shoqërisë osmane. Ato bëjnë një analizë të ndryshimeve që ndodhën në fundin e shek. XVI dhe fillimin e shek. XVII në perandorinë osmane. Për këtë arsye, historiani i njohur austriak Hammer Purgstall e quajti Koçi beun si Monteskieun e Osmanëve.

Koçi beu shkroi dy traktate, njërin për sulltan Murat IV dhe tjetrin për sulltan Ibrahimin. Traktatet dallojnë nga njëri-tjetri për sa i përket gjuhës dhe metodës së trajtimit, por në linja të përgjithshme ato janë shumë të afërta. Ndryshimi në fjalë ka të bëjë me karakterin dhe shkallën e arsimimit të çdonjërit prej sulltanëve që iu drejtuan.

Të shumtën e rasteve, kur shkruhet apo flitet për Traktatin e Koçi beut nënkuptohet më shumë traktati që ai shkroi në vitin 1631 drejtuar sulltan Muratit IV, i cili kishte njohuri të thella në gjuhët arabe dhe perse, arsye për të cilën edhe gjuha e këtij traktati është shkruar në gjuhën osmane dhe në një nivel të lartë artistiko-letrar. Ky traktat përbëhet nga 22 kapituj të shkurtër. Në pjesën e parë, autori përkufizon parimet bazë të sistemit shtetëror dhe shoqëror osman.



Në pesë kapitujt në vijim, jep të dhëna në lidhje me funksionet dhe rolet që kanë në sistemin osman sulltani, veziri, këshilli perandorak, nedim dhe klerikët myslimanë. Më pas, ai shpjegon dhe tregon rëndësinë që ka sistemi i timarit brenda sistemit shtetëror. Në tre kapitujt që vijojnë, ai sqaron sistemin e timarëve, e gjithashtu fillimin dhe shkaqet e prishjes së marrëdhënieve mes nëpunësve të shtetit, jeniçerëve dhe ushtarëve të tjerë të perandorisë. Në pesë kapitujt e tjerë ai analizon situatën në të cilën gjendeshin shteti dhe shoqëria osmane, duke dhënë mendimin e tij për përgjegjësit e kësaj situatë. Në kapitujt e tjerë e deri në fund ai propozon rrugët dhe mënyrat që mund të parandalojnë krizën e shtetit, për t'ia rikthyer perandorisë fuqinë e dikurshme.

Traktati i dytë u shkrua nga Koçi beu për t'u lexuar nga sulltan Ibrahim, i cili kish kërkuar të dhëna rreth situatës sociale dhe ekonomike të shtetit osman, sepse në dallim nga i vëllai Murati IV ai nuk kishte marrë një arsimim aq serioz. Për shkak të intrigave të oborrit e kishte kaluar jetën brenda një kafazi të krijuar me thupra dhe bimë të larta. Traktati i dytë mban vitin 1640 dhe për arsye që përmendëm më sipër, Koçi beu e shkroi me një gjuhë të thjeshtë e të qartë. Për këtë arsye, ai i kërkon sulltanit që, pasi ta lexonte traktatin, ta digjte e të mos ia tregonte kujt; veç kësaj, ato që do të mësonte prej atij traktati duhej t'i transme-

tonte si të ishin mendimet e vetë sulltanit dhe jo si të tijat. Metoda e përdorur në traktat ka natyrë didaktike. Traktati ka 18 kapituj. Gjatë shtjellimit të çështjeve në këta kapituj, Koçi beu i trajton problemet si të ishte duke ia mësuar ato sulltanit. Nëpërmjet përmbajtjes së traktatit ai arrin deri aty sa t'i mësojë sulltanit edhe se si duhet të komunikojë me shtetarët e perandorisë, se kujt duhet t'i ngrihet në këmbë për respekt, si duhet të sillet me ambasadorët e ndryshëm etj.

Koçi beu përpiqet ta analizojë transformimin si rezultat negativ i shthurjes që po ndodhte në administratën osmane, rritjes së rryshëve, caktimit të të paafteve në poste të rëndësishme, shthurjes së strukturave të shoqërisë osmane dhe prishjes së ekuilibrit financiar të perandorisë, duke shtuar më pas edhe këshillat e propozimet e tij, për të ndërmarrë reformat e duhura me synim zgjidhjen e këtyre problemeve. Gjatë gjithë propozimeve ai kërkon që të përdoret forca, nëse është e nevojshme.

Në trajtimet e tij Koçi beu nuk cek asnjë zhvillim që ndodhte jashtë perandorisë osmane dhe asnjë reflektim rreth ndryshimeve të atjeshme mbi perandorinë, gjë që tregon se ai prirej ta realizonte trajtimin e tij vetëm mbi bazat e problemeve të perandorisë, pa u ndalur fare në ndikimet që vinin nga jashtë.



Hz. Rukija (r.a.)

Hz. Rukija (r.a.) vajza e dytë e Profetit (s.a.s.) njihet ndryshe edhe me emrin “dhatu’l-hixhretejn”, zotëruesja e dy hixhreteve dhe shembull në çështjet e fesë islame, si në demonstrim ashtu edhe në transmetim.

Lindi në Meke 7 vite para Profetësisë së babait të saj. U rrit pranë nënës Hz. Hatixhes, një grua e zgjuar, e dashur dhe plot virtyte. Dijen, kulturën, sjelljet moralo-etike i mori nga një burim i pashtershëm, nga prindër model. Po ashtu edhe dashurinë, respektin, dhembshurinë ndaj të tjerëve, mëshirën etj.

Pas martesës së motrës së madhe Hz. Zejnebi (r.a.), ajo u kujdes gjithnjë për nënën dhe motrën tjetër Ummu Gulthumin (r.a.) me të cilën u rritën sikur të ishin binjake.

Vitet vazhdonin në rrjedhën e tyre... derisa një ditë xhaxhai i madh, Ebu Talibi erdhi me një grup të ftuarish për të kërkuar dorën e Hz. Rukijes (r.a.) për Utben, djalin e Ebu Lehebit. Lidhur me këtë çështje, duke qenë një baba shembullor, Muhamedi (s.a.s.) u kërkoi atyre kohë për t’u menduar dhe për të biseduar me vajzën e tij, sepse ai dinte t’i vlerësonte më mirë se askush, aq më tepër kur bëhej fjalë për një çështje kaq të ndjeshme që kishte të bënte me fatin e vajzës së

tij. Pavarësisht dilemave që përherë e mendojnë një prind, Profeti (s.a.s.) e pranoi këtë kërkesë.

Kohë pas kësaj martese, në qiejt e Mekes u shfaq një dritë. Allahu (xh.sh.) kishte zgjedhur babain e saj Muhamedin (s.a.s.), si Profet dhe udhëzues për të gjithë njerëzimin. Tashmë Muhammedu’l-Emin (Muhammedi i besueshëm) do quhet Muhammedu’r-rasulullah (Muhammedi i dërguari i Allahut).

Çdo gjë kishte ndryshuar. Dita-ditës jeta e këtyre njerëzve të mirë po begatohej, po ndriçohej, por nga ana tjetër kjo dritë po verbonte gjithnjë e më tepër sytë e injorantëve, sy që nuk patën mirësinë të shijonin dritën vezulluese të islamit. Flitej për sytë dhe zemrën e vulosur të Ebu Lehebit, i cili i ndodhur para një fakti të tillë, urdhëroi djalin e tij Utben të divorcohej nga Hz. Rukija (r.a.), si shkak i pranimit të fesë së babait të saj.

Me ndarjen e Hz. Rukijes (r.a.) dhe të vajzës tjetër Ummu Gulthumit, Ebu Lehebi mendoi se do i sillte shqetësime Profetit (s.a.s.) dhe ëndërronte ta pengonte atë nga thirrja islame, por ndodhi e kundërta. Pak kohë me vonë Hz. Rukija (r.a.) u martua martua me një burrë më bujar, më besnik, më të moralshëm,

më të devotshëm, i cili qe një nga 10 sahabet e lajmëruar qysh në këtë botë se do të ishin banorë të xhenetit, pra u martua me Osman ibni Affan (r.a.).

Ndërsa politeistët me në krye Ebu Lehebin nuk do qëndronin duarkryq përballë një skene të tillë. Ata i shtuan gjithnjë e më tepër torturat ndaj atyre që po nderoheshin me islam, por si për çudi, pavarësisht këtyre mundimeve radhët e myslimanëve shtoheshin dita-ditës.

Pas një periudhe u lejua hixhreti (emigrimi) për në Etiopi. Në krye të grupit emigrues ishte dhëndrri Hz. Osmani (r.a.) dhe vajza e Profetit (s.a.s.) Hz. Rukija (r.a.). Ndarja nga Burimi i mëshirës, nga Krenaria e njerëzimit, nga familja, nga atdheu nuk ishte aspak e lehtë, por nga ana tjetër trysnia e mospërjetimit të islamit në qetësi i mundonte, ndërsa në Etiopi ishin të mbrojtur, të sigurt, larg torturave dhe mundimeve të politeistëve.

Jetuan në Etiopi të gjithë si një familje e vetme, si një trup i vetëm, ashtu siç u ka hije myslimanëve, pa e ndjerë anë çast vetminë. Demonstruan të gjitha vlerat e kësaj feje të vërtetë.

Nga Meka erdhën lajme të gëzueshme: që një pjesë e madhe e politeistëve kishte pranuar islamin. U përhapën fjalë gjithandej sikur ata kishin rënë në sexhde bashkë me Profetin (s.a.s.). Të gëzuar nga ky lajm, një pjesë e madhe e sahabeve (shokëve) të Profetit (s.a.s.) u kthyen në Meke. Ndër ata që u kthyen ishin edhe Hz. Osmani dhe Hz. Rukija (r.a.).

Por lajmet e përhapura nuk ishin të vërteta, ngjarja e sexhdes ishte e tillë: “Teksa Profeti (s.a.s.) kishte lexuar suren Nexhm, sure në të cilën tregohet pafuqia e idhujve, duke u përmendur edhe emrat e tyre. Në fund të sures ndodhet ajeti i sexhdes dhe Profeti bëri sexhde për hir të Allahut, ndërsa politeistet e kryen sexhden në nderim të idhujve, emrat e të cilëve u përmendën në sure”. Ky ishte shkaku i përhapjes së lajmit të rremë në lidhje me besimin e politeistëve.

Muhaxhirët e kthyer në Meke nuk gjetën asnjë ndryshim. Vazhdonin po të njëjtat tortura, po të

njëjtat mundime. Përveç torturave, Hz. Rukija (r.a.) u përball edhe me dhimbjen e madhe të humbjes së nënës së saj, dhimbje e cila ia dërrmoi ndjenjat.

Qëndrimi në Meke nuk do zgjaste shumë. U dha leja e emigrimit të dytë, kësaj here në Medine.

Në vitin e dytë të hixhretit Allahu e gëzoi Hz. Rukijen (r.a.) me një djalë. Jetuan në Medine të qetë nën sigurinë që rrezatonte vëllazërimi Ensar-Muhaxhir. Por kjo qetësi nuk do zgjaste shumë, sepse tashmë kishte ardhur koha që Hz. Rukija (r.a.) t’ia dorëzonte emanetin, shpirtin Allahut (xh.sh.), ndërkohë që nuk ishte më shumë se 22 vjeç.

Të gjithë po qanin të mërziur për këtë ndarje në shtëpinë e Hz. Omerit. Ky u mat t’i qortonte, por Profeti (s.a.s.) i këshilloi të gjithë: “Ndjenjat e dhembshurisë ndaj të vdekurit lejohen, nëse shfaqen me anë të syve dhe të zemrës, sepse këto janë nga Allahu. Nëse tregohen me anë të fjalëve dhe duarve (veprave), atëherë janë nga shejtani”.

Allahu e nderoftë Hz. Rukijen (r.a.) me xhenet. Amin!



Zemra artificiale gati për të zëvendësuar natyralen

Shkencëtarët francezë në bashkëpunim me qendrën e Mbrojtjes ajrore dhe hapësirës (EADS) – njohur me mirë për prodhimin e avionit Airbus, kanë krijuar një prototip zemre artificiale. Dr. Alain Carpentier, kirurgu në krye të studimit thotë se pacientet e parë do të pajisen me organin eksperimental brenda tre vjetëve të ardhshëm.

“Fusha e kërkimit të zëvendësimit të përgjithmonshëm të zemrës fiziologjike me një aparat artificial ka qënë pikësynimi më madhor i studimeve mjekësore” – thotë Dr. Peter Weissberg, drejtori i Fondacionit Britanik të Zemrës edhe pse ai vetë nuk ka marrë pjesë në këtë studim. “Pyetja qëndron nëse kjo zemër artificiale do qëndroje aq rezistente sa zemra natyrale, duke rrahur 60-100 herë në minute për gjatë gjithë jetës së pacientit”.

Krijuesit e zemrës artificiale thonë se deri tani zemra e tyre është ajo që i ngjason më shumë se çdo gjë tjetër zemrës natyrale. Studiuesit e pavarur janë dakord se kjo zemër ka arritur të materializojë një seri përmirësimesh në krahasim me versionet e mëparshme të zemrës artificiale. Tek zemra e re artificiale tashmë gjenden jo më një pompe, por dy, duke reflektuar ndërtimin e zemrës natyrale, si dhe në të gjenden një sasi sensorësh të cilët reagojnë ndaj aktivitetit fizik dhe automatikisht ngrënë dhe ulin rritjen e zemrës dhe presionin e gjakut.

Carpenter thotë se aparati i ri përbëhet prej materialeve bio-teknologjike, të cilat janë të fabrikuara nga inde prej kafshëve të trajtuara kimikisht për të reduktuar rrezikun e mpiksjes së gjakut, një prob-



lem që ka dominuar tek versionet e mëparshme të zemrave artificiale.

Jarvik 7 një zemër artificiale që përdoret sot, nuk ka qënë e krijuar për të zëvendësuar zemrën në mënyrë permanente por vetëm si organ për asistimin e kirurgeve gjatë operacioneve ose transplanteve. Prototipet e krijuar për të zëvendësuar zemrën si AbioCor apo versioni i eksperimentuar nga MagScrew nuk kanë arritur të imitojnë rrahjet e zemrës sipas aktivitetit fizik dhe nevojës së pacientit.

“Kjo aftësi e kësaj zemre për të lexuar të dhënat fiziologjike është një hap para, i cili do mundësojë pacientet për të patur një jete më normale” thotë

presidenti i Shoqërisë Amerikane të Zemrës, Dr. Timothy Gardner.

Ky është një lajm i mirë për rreth 20,000 pacientë që çdo vit janë në pritje të një zemre për transplant dhe që fatkeqësisht vetëm çereku i tyre arrin të gjejë një donator. Mundësia për të patur një organ artificial do të shkurtojë listat e pritjeve për transplant dhe do të mundësojë një shans jete në 17 milion pacientë që çdo vit vdesin prej sëmundjeve të zemrës. Transplantet e para do jenë për pacientet në gjendje kritike të cilët mbahen në aparate dhe janë në pritje të vdekjes, por më vonë mendohet që kjo zemër artificiale të vendoset edhe në moshat e reja që kanë një shans më të madh për të mbijetuar dhe për tu rikuperuar më shpejt.

Deri më tani zemra “Camat” është testuar me suk-

ses tek kafshët dhe brenda dy vjetësh mendohet që të aprovohet për testim tek njerëzit. Një prej problemeve që duhen zgjidhur tek prototipi është jeta e baterive. Megjithëse Camat ka treguar një përmi-rësim të madh në krahasim me zemrat e rivaleve të cilat punonin vetëm 30 minuta me bateri, jeta e saj është vetëm 5-16 orë, një gjë që krijon problem me rikarikimet e shpeshta. Është një problem i madh për të gjetur mënyrën e karikimit të baterive pa krijuar infeksion, por meqenëse ky aparat është krijuar për të ndihmuar 40-50 vjeçarët të cilët nuk do kishin shans tjetër për të jetuar dhe do të vdisnin, karikimi i baterive disa herë në ditë nuk është ndonjë dramë e madhe.

Çmimi i zemrës artificiale kur të dalë në treg, mendohet të jetë rreth 250 mijë dollarë.

Sëmundja e sheqerit: Tashmë do të përcaktohet 10 vjet më parë

Me anë të një analize të gjakut, tashmë është bërë e mundur që sëmundja e sheqerit të zbulohet 10 vjet më herët se sa me metodat që kanë ekzistuar deri tani...

Në Festivalin e Shkencës Angleze që u zhvillua në Birmingham, u paraqit një test që arriti të parashikoj se afërsisht gjysma e të testuarve do të ketë sëmundjen e sheqerit të tipit II. Shkencëtarët deklaruan se ky aparat i testit të gjakut që përcakton sasinë e molekulave gjenetike në gjak, do të dali së shpejti në qarkullim.

Ndërsa në një shkrim të publikuar në revistën mjekësore “Journal Circulation Research”, thuhet se një tjetër test molekular i ngjashëm, me emrin MicronRNA (MiR) do të përcaktojë më herët njerëzit që mund të kenë sëmundje të zemrës dhe të damarëve. Sipas informacioneve ky test do të përdoret së bashku me metodat e zakonshme dhe do të kushtojë afërsisht 2 pound.



Tashmë myslimanët kanë "facebook"-un e tyre



Një grup Muslimanësh nga Egjipti kanë themeluar një faqe të re të ngjashme me Facebook-un,

IkhwanBook.com.

Themeluesit e Ikhwanbook, me sloganin *"Ndaheni jetën tuaj me vëllezërit tuaj në të gjithë botën"* kanë për qëllim që të sjellin një komunikim më cilësor sa i përket rregullave morale. Pra në këtë rrjet nuk do të qarkullojnë materiale që janë jashtë kodit moral Islam. Por megjithatë kjo faqe funksionon njësoj si Facebook dhe mund të dërgoni foto dhe video si dhe të komunikoni me persona tjerë. Përkrah kësaj webfaqeje ata kanë hapur edhe disa faqe të tjera te dobishme për Muslimanët si IkhwanWiki, IkhwanWeb, IkhwanGoogle dhe IkhwanTube.

IE 9: shpresa e fundit e microsoftit

Internet Explorer 9 si arma më e fundit e Microsoftit në luftën e web-browser-ve (motorë kërkues të internetit) ka tërhequr vëmendje të madhe që nga dalja e tij si version Beta. Microsofti i cili kërkon të rifitojë pjesën e tortës së humbur në këtë luftë kundër Firefoxit dhe Chrome, po mundohet të nxjerri jashtë loje web-browser-in e vet IE6.

Ky version i IE që tashmë ka mbushur 9 vjet dhe që është ende shumë i preferuar, nuk suporton më riparimet në problemet e sigurisë. Microsofti, pjesën që mbulon IE6 në Amerikë ka arritur ta ulë nga 9.33% deri në 4.17%, por do të jetë e vështirë për të që ta eliminojë plotësisht IE6-ën, sepse sistemet financiare që përdorin disa firma të mëdha, punojnë vetëm me IE6.

Pengesa tjetër në eliminimin e IE6 nga IE9, janë edhe kopjet e Windows XP pirate të cilat përdorin IE6 dhe që përdoren në mënyrë të gjerë në Kinë dhe Indi. Mbi të gjitha, shpejtuesit e programeve në IE9,



në versionin XP të ëindoësit nuk punojnë. Pra siç duket, sukcesi i IE9 varet shumë nga sukcesi i Windows 7-ës.

Universiteti i Teologjisë Islame në Shqipëri

Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, Haxhi Selim Muça, me anë të një deklarate të shpërndarë më datë 17.09.2010, ka publikuar vendimin e marrë nga ky komunitet për ngritjen e Universitetit Teologjik Islam në Shqipëri.

“Ky universitet do të synojë dhënien e një arsimit të lartë të përshtatshëm me kulturën, traditat dhe karakteristikat e shoqërisë shqiptare, duke mbajtur në bazat e tij, themelet dhe kushtet e besimit dhe fesë islame. Me hapjen e këtij universiteti, të rinjtë shqiptarë nuk do të kenë nevojë të shkojnë në vendet e huaja për të vazhduar studimet teologjike.”

Duke parë zhvillimet globale dhe ato në Shqipëri, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë ka qenë gjithmonë i kujdesshëm, që krahas realizimit të misionit dhe qëllimeve të tij institucionale, të marrë parasysh realitetin dhe situatën kombëtare dhe atë sociale. KMSH ka qenë gjithmonë i kujdesshëm në zhvillimin e aktiviteteve dhe promovimit të vlerave islame, pa prishur ekuilibrat dhe trashëgiminë e besimit tradicional shqiptar, i cili ka rezultuar të jetë një model ideal për vendin tonë, duke u përputhur plotësisht me parimet e ruajtjes së harmonisë mes besimeve të ndryshme që ka shoqëria shqiptare.

Një nga treguesit më objektiv dhe më të qartë të strategjive që Komuniteti Mysliman ka ndjekur, janë edhe modeli i shumicës së medreseve, të cilat kanë prodhuar dhe vazhdojnë të prodhojnë të rinj të arsimuar nga njëra anë me vlera fetare dhe patriotike, dhe nga ana tjetër të formuar me dijet e shkencës dhe teknologjisë, e cila u hap dritaret e botës përreth këtyre intelektualëve të ardhshëm, të cilët pas studimeve të mesme vazhdojnë studimet e larta në specialitete të ndryshme si inxhinieri, mjekësi, juridik, ekonomik, shkenca sociale, teologji, etj.

Studimet universitare dhe pasuniversitare të këtyre të rinjve kanë qenë të suksesshme dhe ata kanë qenë në gjendje të konkurojnë denjësisht si në universitetet brenda vendit edhe jashtë tij. Këta të rinj me përfundimin e studimeve janë kthyer në Shqipëri, por kanë hasur vështirësi në integrimin e tyre me shoqërinë shqiptare.

Për këtë arsye, Komuniteti Mysliman i Shqipërisë, ka vendosur themelimin e Universitetit Teologjik Islam. Ky universitet do të synojë dhënien e një arsimit të lartë të përshtatshëm me kulturën, traditat dhe karakteristikat e



shoqërisë shqiptare, duke mbajtur në bazat e tij, themelet dhe kushtet e besimit dhe fesë islame.

Ky universitet do të jetë një institucion i standardeve ndërkombëtare, duke synuar tërheqjen dhe arsimimin e të rinjve jo vetëm nga Shqipëria, por edhe nga vendet e rajonit dhe Evropa, duke u bërë kështu një qendër e promovimit të vlerave islamo-shqiptare.

Universiteti Islam i Shqipërisë do të ofrojë programe studimore të ciklit të parë në fushat e shkencave islame si dhe të filologjisë me qëllim parësor kualifikimin akademik të imamëve, predikuesve si dhe personave të tjerë, pjesë e strukturave të Komunitetit Mysliman të Shqipërisë.

Universiteti do të ketë në përbërje dy fakultete: Fakulteti i Teologjisë Islame, i përbërë nga Departamenti i Shkencave Themelore Islame dhe Departamenti i Shkencave Sociale Islame si dhe Fakulteti i Filologjisë, i cili përfshin Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Arabe si dhe Departamentin e Gjuhës dhe Letërsisë Turke, si dhe dy Qendra Kërkimore, atë të Dialogut Ndërfetar dhe atë të Albanologjisë.

Mësimdhënia në Universitetin Islam të Shqipërisë do të zhvillohet në gjuhët arabe, shqipe dhe turke, ndërkohë që edhe gjuha angleze do të jepet intensivisht si lëndë e gjuhës të huaj gjatë gjithë kohëzgjatjes së studimeve.

Universiteti synon që nëpërmjet kurrikulave bashkëkohore, stafit cilësor akademik si dhe infrastrukturës moderne fizike dhe teknologjike, të bëhet një qendër e rëndësishme e studimeve islame jo vetëm në Shqipëri, por në të gjithë hapësirën shqiptare dhe më gjerë në rajon.